



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive  
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

# Indeksi i Transparencës IV

Hulumtim politikash: Vlerësimi i transparencës së institucioneve të nivelit qendror, lokal dhe ndërmarrjeve publike në Kosovë për vitin 2012

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy

**A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND**

Prishtinë  
Korrik 2013

## PËRMBAJTJA

FALËNDERIME .....	4
RRETH FOL .....	4
I. Hyrje .....	5
1. Përmbledhje ekzekutive .....	5
2. Qëllimi dhe metodologjia e studimit .....	7
3. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për qasje në dokumentet zyrtare .....	8
II. Përmbledhje e të gjeturave .....	10
III. Të gjeturat për secilin institucion dhe ndërmarrje publike .....	11
Institucionet përfaqësuese .....	11
1. Kuvendi i Republikës së Kosovës .....	11
Institucionet ekzekutive të nivelit qendror .....	13
2. Zyra e Kryeministrit (ZKM) .....	13
3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) .....	14
4. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) .....	16
5. Ministria e Diasporës (MeD) .....	17
6. Ministria e Drejtësisë (MD) .....	18
7. Ministria e Financave (MF) .....	20
8. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) .....	21
9. Ministria e Integritetit Evropian (MIE) .....	23
10. Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit (MKK) .....	24
11. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) .....	26
12. Ministria e Shëndetësisë (MSh) .....	27
13. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) .....	29
Institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive .....	32
14. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) .....	32
15. Dogana e Kosovës (DK) .....	34
16. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) .....	37
17. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) .....	39
18. Policia e Kosovës (PK) .....	41
Ndërmarrjet publike .....	45
19. Posta dhe Telekomit i Kosovës (PTK) .....	45
Përfundime dhe rekomandime .....	47
Shtojca 1: Indeksi i Transparencës së Institucioneve dhe Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012 - pasqyrë e hollësishme .....	50
Vlerësimi i transparencës së Komunave .....	69
Hyrje .....	70
Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për qasje në dokumentet zyrtare .....	70
1. Komuna e Drenasit .....	73
2. Komuna e Ferizajt .....	74

3. Komuna e Graçanicës	75
4. Komuna e Gjakovës	76
5. Komuna e Hanit të Elezit	77
6. Komuna e Istogut	78
7. Komuna e Kamenicës	79
8. Komuna e Klinës	80
9. Komuna e Kllkotit	81
10. Komuna e Mitrovicës	82
11. Komuna e Novobërdës	83
12. Komuna e Pejës	85
13. Komuna e Podujevës	86
14. Komuna e Prizrenit	87
15. Komuna e Shtimes	89
16. Komuna e Skenderajt	90
17. Komuna e Vushtrrisë	92
Përfundime dhe rekomandime	94

## FALËNDERIME

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga “BTD - The Balkan Trust for Democracy” në kuadër të projektit “FOL për Qasje ne Dokumente Zyrtare”. Ky Raport, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i Lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti.

## RRETH FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetarë në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t’i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

## I. Hyrje

### Përmbledhje ekzekutive

Ky studim politikash publike është i treti me radhë që fokusohet vetëm në institucionet e nivelit qendror dhe Ndërmarrjet Publike (NP), dhe mbulon periudhën janar - dhjetor 2012. Ashtu sikurse dy vlerësimet e kaluara, ky raport vlerëson transparencën e këtyre dy kategorive të institucioneve publike që veprojnë në Kosovë. Edhe ky raport bazohet në të njëjtën metodologji dhe strukturë të hulumtimit si ai i kaluari, si dhe jep një pasqyrë krahasuese që tregon ecurinë e përparimeve të bëra nga institucionet dhe ndërmarrjet publike të përfshira në fushën e komunikimit dhe informimit publik. Pra, edhe ky vlerësim fokusohet në atë se deri në çfarë niveli institucionet dhe ndërmarrjet publike kanë zhvilluar kapacitetet e strukturave të tyre formale për të siguruar zbatimin e plotë dhe efektiv të dispozitave kushtetuese dhe ligjore që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet publike, pra komunikimit dhe informimit publik, me qëllim të forcimit të transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut.

Ky raport përmbledh gjetjet sa u përket çështjeve relevante nga tri përmasa kryesore të ndërtimit të institucioneve në këtë fushë ‘horizontale’ të politikave publike, përkatësisht në lidhje me infrastrukturën rregullative, atë të politikave (përkatësisht zbatimin e kësaj rregullative në kuadër të kornizave kohore të caktuara dhe në kontekstin e veçantë të fushëveprimit të secilit institucion dhe ndërmarrjeje publike) dhe kapacitetet për implementimin efektiv të kornizës rregullative dhe asaj të politikave. Për dallim nga raportet e kaluara, përveç të dhënave kuantitative që tregojnë rezultatet e vlerësimit (të prezantuara hollësisht në shtojcën 1), ky raport përmban më tepër të dhëna kualitative. Përmes kësaj synohet që të prezantohet më hollësisht gjendja substanciale në kuadër të secilit institucion dhe NP të përfshirë në vlerësim sa u përket politikave të komunikimit dhe informimit publik. Gjithashtu synohet të identifikohen në mënyrë më të hollësishme dhe më gjithëpërfshirëse mangësitë konkrete që duhet adresuar për të përmirësuar më tej gjendjen aktuale në këtë fushë politikash.

Siç mund të vihet re në vijim, gjatë vitit 2012 të gjitha institucionet dhe NP-të që i janë përgjigjur kërkesës për t’u përfshirë në këtë vlerësim të radhës dhe që janë përfshirë në vlerësimin paraprak ose kanë shënuar përmirësime ose e kanë ruajtur të njëjtën nivel në rangim. Marrë në përgjithësi nga vlerësimi i të gjitha institucioneve dhe NP-ve të nivelit qendror të përfshira në këtë raport, rezultatet kanë nxjerrë një Indeks të Transparencës Institucionale (ITI) me vlerë agregate prej 50.81, që nënkupton se marrë në përgjithësi, nga i cili rezulton se gjatë vitit 2012 institucionet dhe NP-të e nivelit qendror kanë qenë të mbyllura. Tabela në vijim paraqet rangimin e të gjitha institucioneve dhe NP-ve që janë përfshirë në vlerësimin për vitin 2012, sipas Indeksit të Transparencës Institucionale (ITI) për vitin 2011 dhe 2012.

## Indeksi i Transparencës së Institucioneve dhe Ndërmarrjeve Publike (rangimi për 2011 dhe 2012 - pasqyrë krahasuese):

Nr.	Institucioni/ndërmarrja publike	Indeksi		Trendi
		2011	2012	
1	Dogana e Kosovës (DK)	93 (JPH)	93 (JPH)	■
2	Ministria e Shëndetësisë (MSH)	55 (PJH)	73 (GJH)	▲
3	Ministria e Drejtësisë (MD)	29.5 (M)	67 (GJH)	▲
4	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)	55 (M)	61 (PJH)	▲
5	Policia e Kosovës (PK)	55.5 (PJH)	57 (PH)	▲
6	Kuvendi i Republikës së Kosovës	50.5 (M)	55.5 (PH)	▲
7	Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK)	48 (M)	53 (M)	▲
8	Ministria e Integritimit Evropian (MIE)	48 (M)	51 (M)	▲
9	Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)	45.5 (M)	49 (M)	▲
10	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit (MKK)	24 (M)	48 (M)	▲
11	Ministria e Financave (MF)*	N/A	47 (M)	
12	Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK)	42.5 (M)	47 (M)	▲
13	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)*	N/A	44 (M)	
14	Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)	39 (M)	42 (M)	▲
15	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)	24.5 (M)	41 (M)	▲
16	Zyra e Kryeministrit (ZKM)	42.5 (M)	39 (M)	▲
17	Ministria e Diasporës (MeD)*		37 (M)	
18	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjia (MASHT)*		35 (M)	
19	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)*		26 (M)	

\* Institucionet dhe NP-të për të cilat nuk mund të paraqitet trendi (për shkak se institucionet përkatëse nuk kanë qenë pjesë e vlerësimit vitin paraprak)

## 1. Qëllimi dhe metodologjia e studimit

Ky studim politikash synon të vlerësojë punën e institucioneve publike dhe ndërmarrjeve publike në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe të aspekteve të tjera të komunikimit dhe informimit publik gjatë periudhës janar - dhjetor 2012. Sikur vlerësimet e kaluara, edhe ky është i bazuar në mbledhjen e të dhënave nga secili institucion dhe vlerësimin e tyre, bazuar në indikatorë të dizajnuar paraprakisht. Pra, bazuar në indikatorët e zhvilluar, të përfshirë në një pyetësor të strukturuar, të dhënat brenda secilës përgjigje të marrë janë vlerësuar sipas Indeksit të Transparencës Institucionale (ITI).

**Indikatorët e vlerësimit** mbulojnë këto çështje specifike: kornizën ligjore dhe rregullative për komunikim dhe informim publik; kornizën e politikave për komunikim dhe informim publik; kornizën institucionale/organizative për komunikim dhe informim publik; kapacitetet institucionale (humane, financiare dhe teknike) për zbatim në fushën e komunikimit dhe informimit publik; dhe çështjet e zbatimit në praktikë.<sup>1</sup>

**Mbledhja e të dhënave** është bërë përmes një pyetësori të përbërë nga 25 komponentë: 24 pyetje dhe një tabelë. Përmes pyetësorit është synuar të mblidhen informata kuantitative dhe kualitative mbi secilën çështje. Pyetësorët u janë dërguar Sekretarëve të Përgjithshëm të Kuvendit dhe Institucioneve përfaqësuese dhe atyre qendrore ekzekutive, përkatësisht Kryeshefave Ekzekutivë dhe/ose Drejtorëve të institucioneve të pavarura, agjencive ekzekutive dhe ndërmarrjeve publike. Prandaj këta zyrtarë, si përgjegjësit më të lartë menaxherialë të tyre, janë përgjegjës për të gjitha gjetjet që përmban ky raport. Në hyrje të secilit pyetësor, respondentët janë udhëzuar në mënyrë të hollësishme dhe të saktë mbi mënyrën e plotësimit të pyetësorit dhe llojin e informatave të kërkuara, përfshirë edhe atë se çfarë lloj zyrtarësh (këta të fundit janë specifikuar në bazë të fushave të përgjegjësisë) brenda strukturave të tyre duhen konsultuar për të marrë informata gjithëpërfshirëse dhe të sakta mbi çështjet për të cilat kërkon informata pyetësori. Të dhënat janë mbledhur nga fundi i majit deri në fund të gushtit 2010.

Pas kthimit të pyetësorëve të plotësuar, është bërë vlerësimi i transparencës së institucioneve dhe NP-ve, sipas indikatorëve të paraqitur më sipër. Varësisht nga sasia dhe cilësia e informatave të dhëna në pyetësor dhe në dokumentet e dërguara si pjesë të përgjigjeve, secili komponent i pyetësorit është vlerësuar me nga 0 deri në 4 pikë. Shuma e pikëve të dhëna përbën Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI), të shprehur me numrin e plotë që pasqyron përqindjen e pikëve, emërtim tekstual dhe kod, si dhe ngjyrë, në përputhje me (SPTI). Së fundmi, rangimi i përfundimtar i secilit institucion dhe NP është bërë siç është paraqitur në tabelën në vijim.

1. <b>'I mbyllur' (M):</b> 0% – 54% nga 100%, shënjuar me të kuqe	Red
2. <b>'Pjesërisht i hapur' (PJH):</b> 55% – 66%, shënjuar me portokalli;	Orange
3. <b>'Gjysmë i hapur' (GJH):</b> 67% – 80%, shënjuar me të verdhë;	Yellow
4. <b>'Jo plotësisht i hapur' (JPH):</b> 81 – 93%, shënjuar me të përhimë 50%	Grey
5. <b>'Plotësisht u hapur' (PLH):</b> 94% – 100%, shënjuar me të gjelbër.	Green

Ndonëse pyetësori për këtë vlerësim u është dërguar 33 institucioneve dhe NP të nivelit qendror<sup>2</sup>, kërkesës për t'u përfshirë në këtë vlerësim të radhës i janë përgjigjur vetëm 19 institucione dhe

<sup>1</sup> Për një përshkrim të hollësishëm të secilit komponent, shih raportin paraprak, në dispozicion në <http://levizjafol.org/al/publikimet/sub/transparencia>

<sup>2</sup> Institucionet dhe NP-të e kontaktuara janë: Presidenca e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Diasporës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Prokuroria e Shtetit, Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, Agjencia për Privatizim e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Institucioni i Avokatit të

ndërmarrje publike të nivelit qendror. Pyetësi u është dërguar atyre në janar 2013 dhe kanë pasur kohë që të përgjigjen deri në fund të marsit 2013.

## 2. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për qasje në dokumente publike

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në Nenin 41, përcakton se “Secili person gëzon të drejtën për qasje në dokumentet zyrtare.” Më tej, ajo përcakton se “Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, përveç informatave që janë të kufizuara me ligj për shkak të privatësisë, sekreteve biznesore tregtare ose klasifikimit të sigurisë.”<sup>3</sup> Përmes kësaj, Kushtetuta krijon të drejta dhe detyrime. Pra, kjo u jep qytetarëve të drejtën për qasje pa pagesë dhe të papenguar në dokumentet e institucioneve dhe NP-ve, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Kjo gjithashtu i detyron institucionet publike dhe NP-të që të krijojnë mekanizmat dhe infrastrukturën mbështetëse si dhe të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kësaj të drejte, duke filluar nga zbatimimi i detyrimeve specifike të tyre përmes legjislacionit zbatues, e cili duhet më pastaj të pasqyrohet dhe të zbatohet në kuadër të kornizës së politikave të secilit institucion dhe NP-je. Megjithatë, Kushtetuta përcakton se kjo e drejtë mund të kufizohet në rastet kur qasja në informatat që përmbajnë dokumentet e caktuara shkel privatësinë, ose kur këto informata paraqesin sekrete biznesore ose duhet të klasifikohen për arsye të sigurisë publike. Më tej, aty përcaktohet se këto kufizime duhet të përcaktohen më në hollësi me ligj. E ky ligj është Ligji për Qasje në Dokumente Publike.

Përveç Kushtetutës, Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) përcakton se zbatimi i tij synon që t'i “[...]garanto[jë] të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.”<sup>4</sup> Ky ligj përcakton parimet, kushtet dhe kufizimet sa i përket qasjes në dokumente publike, dhe rregullat për ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte. Pa hyrë në hollësi të mëtejshme mbi mënyrat dhe procedurat e qasjes në dokumente publike, në përputhje me obligimet kushtetuese që i garantojnë qytetarit këtë të drejtë, me rëndësi parësore është zbatimi i këtyre obligimeve në mënyrë të efektshme nga ana e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike. Kjo shtron nevojën që ato të vendosin dhe vënë në funksion tërë infrastrukturën e nevojshme ligjore e institucionale, si dhe të posedojnë kapacitetet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.

Sa u përket akteve nënligjore për zbatimin e tij, ky ligj e obligon Qeverinë që brenda tre muajsh pas hyrjes së tij në fuqi të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e tij<sup>5</sup>, por megjithatë nuk specifikon as fushëveprimin e as numrin e këtyre akteve. Baza ligjore zbatuese duhet në veçanti të përcaktojë strukturat, resurset dhe obligimet përkatëse specifike brenda secilit institucion/ndërmarrje publike për komunikim dhe informim publik, si dhe mekanizmat e masat zbatuese për të arritur këtë, përfshirë çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga dokumentet publike në të cilat gëzohet e drejta për qasje. Për të përmbushur obligimet përkatëse në kuadër të strukturave e mekanizmave zbatues, secili institucion/ndërmarrje publike nevojitet të vendosë infrastrukturën rregullative e teknike përkatëse: reflektimin e resurseve dhe obligimeve në kuadër të strukturës së tyre organizative/organogramit, ekzistencën e Termave të Referencës (TR) dhe Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP), të cilat përcaktojnë konkretisht përgjegjësitë e strukturës institucionale/organizative për komunikim dhe informim publik dhe detyrat konkrete të stafit përkatës.

Përveç këtyre, zbatimi efektiv i kornizës ligjore e rregullative kërkon ekzistencën e standardeve të brendshme të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të punës së tyre, alokimin e resurseve të

---

Popullit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Korporata Energjetike e Kosovës, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, dhe Posta dhe Telekomit i Kosovës.

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 41, në dispozicion në [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta\\_sh.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf)

<sup>4</sup> Ligji për Qasje në Dokumente Publike, neni 1, në dispozicion në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-215-alb.pdf>

<sup>5</sup> Poaty, neni 26, paragrafi 1 dhe 2



mjaftueshme (humane, financiare e teknike) për funksionimin e këtyre strukturave të brendshme, përfshirë zbatimin e dokumenteve të politikave e planeve relevante të punës. Sa u përket dokumenteve të politikave e planeve të punës për zbatimin e këtyre obligimeve kushtetuese e ligjore, komponenti i komunikimit dhe informimit publik duhet të pasqyrohet në të gjitha dokumentet e politikave, të cilat duhet të përmbajnë objektiva dhe aktivitete specifike për përmbushjen e tyre brenda periudhave të caktuara kohore. Së fundi, por jo vetëm kjo, nevojitet ekzistimi i praktikave administrative në mënyrë që brenda secilit institucioni/ndërmarrjeje publike të krijohet dhe zhvillohet një kulturë që promovon komunikimin e rregullt me dhe përfshirjen e mediave dhe organizatave të shoqërisë civile në punën e rregullt të tyre, në veçanti në hartimin, implementimin dhe monitorimin e vlerësimit e implementimit të kornizës ligjore përkatëse dhe asaj të politikave.

## I. Përmbledhje e të gjeturave

KOMPON- -ENTËT	K1	K2	K3	K4	K5	K6	K7	K8	K9	K10	K11	K12	K13	K14	K15	K16	K17	K18	K19	K20	K21	K22	K23	K24	K25	ITI, KODI DHE NGJYRAT
DK	4	4	4	4	3	4	4	4	4	4	4	3	4	4	4	4	4	3	3	3	3	4	4	3	4	93 (JPH)
MSH	4	2	3	2	2	3	2	2	3	2	3	2	3	3	4	4	4	4	4	2	2	4	4	2	3	73 (GJH)
MD	4	2	3	2	2	3	2	2	3	2	2	2	1	1	4	4	3	4	2	1	4	4	3	4	3	67 (GJH)
MAPL	4	3	3	2	1	2	3	3	2	3	2	2	1	2	2	4	3	2	2	2	1	4	3	4	1	61 (PJH)
PK	3	2	2	2	2	2	2	2	2	2	3	2	1	2	4	4	2	2	2	2	1	4	2	2	3	57 (PJH)
KUVENDI	4	2	3	2	2	3	2	2	1	1	2	1	1	1	4	4	4	2	1	1	1	4	0	4	3.5	55.5 (PJH)
AKK	4	2	2	3	2	2	2	2	1	1	1	1	1	1	3	3	2	4	2	2	0	4	3	3	2	53 (M)
MIE	3	3	3	2	2	3	1	1	2	2	2	2	2	2	2	4	2	0	2	0	0	4	2	2	3	51 (M)
KGJK	2	1	2	2	2	2	1	1	1	1	2	3	2	1	4	4	3	4	2	2	2	4	0	0	1	49 (M)
MKK	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	1	1	1	1	4	2	1	2	2	2	2	4	1	2	2	48 (M)
MF	4	2	4	2	2	1	2	2	2	2	2	2	0	1	2	4	2	3	1	1	1	4	1	0	0	47 (M)
PTK	2	2	3	1	2	3	2	2	2	1	0	1	0	1	2	4	2	4	2	2	1	4	1	0	3	47 (M)
MFSK	2	2	1	2	2	1	1	1	2	2	1	0	0	2	4	3	2	2	2	2	2	4	2	0	2	44 (M)
IAP	3	2	0	0	2	2	2	2	1	2	3	2	2	1	4	4	2	0	0	0	0	4	1	2	2	42 (M)
MZHE	2	2	2	2	2	1	1	1	2	2	1	0	0	1	4	3	1	2	2	2	1	4	1	0	2	41 (M)
ZKM	4	1	1	2	1	2	1	1	1	1	1	1	1	1	2	1	4	2	2	1	1	3	1	3	0	39 (M)
MeD	4	3	1	2	2	2	2	2	0	1	1	0	0	1	2	2	1	1	2	2	0	3	3	0	0	37 (M)
MASHT	1	2	0	0	0	1	2	1	2	4	2	1	0	1	1	1	2	3	0	0	1	4	4	1	1	35 (M)
MPMS	2	1	0	0	0	1	1	1	1	1	1	1	0	0	2	2	0	2	3	0	0	4	1	0	2	26 (M)
<b>INDEKSI I TRANSPARENÇËS INSTITUCIONALE (AGREGAT) : 50.81 (M)</b>																										

## II. Të gjeturat për secilin institucion dhe ndërmarrje publike

### Institucionet përfaqësuese

Nga të dyja institucionet përfaqësuese të kontaktuara, vetëm Kuvendi i Republikës së Kosovës i është përgjigjur kërkesës për informata për qëllim të këtij vlerësimi, kurse Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës nuk e ka bërë këtë.

#### 1. Kuvendi i Republikës së Kosovës

Me qëllim të zbatimit të dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, Kuvendi i Republikës së Kosovës gjithashtu zbaton Rregulloren për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit, e cila përkufizon përgjegjësitë e Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun (DMMP). Më tej, Rregullorja për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe të Publikut në Punën e Kuvendit të Kosovës (rregulla 1) obligon Kuvendin që të jetë transparent në punën e tij dhe të sigurojë qasjen e qytetarëve në dokumente publike, por nga të dhënat e ofruara për qëllim të këtij vlerësimi nuk është e qartë saktësisht çfarë strukturash, resursesh e obligimesh specifike përcakton ajo për të siguruar zbatimin e këtyre dispozitave.

Sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese, rregullorja e fundit obligon DMMP-në që të lehtësojë qasjen e publikut në punën e Kuvendit dhe transparencën e tij, por nuk është e qartë si dhe nëpërmjet çfarë procedurash. Mekanizma të tjerë në dispozicion të këtij institucioni janë dërgimi i komunikatave për shtyp dhe informatave të tjera të kërkuara nga palët e interesuara, por nuk është plotësisht e qartë se si funksionojnë këto mekanizma (përfshirë ato të llogaridhënies) dhe kapacitetet ekzistuese për vënien e tij në zbatim. Më tej, përveç dispozitave të Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare, sipas të dhënave të ofruara, ky institucion nuk ka dispozita zbatuese që rregullojnë klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike senzitive, e as mekanizma e masa të qarta zbatuese. Sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, përveç dispozitave përkatëse të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe Rregullores së Kuvendit, nuk është e qartë se çfarë masa dhe mekanizma zbatues ekzistojnë në kuadër të Kuvendit. Sa u përket strukturave të brendshme, është e qartë përmbajtja e dispozitave të Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit në lidhje me përgjegjësitë e DMMP-së dhe pozita e tij në organogramin e institucionit, por jo plotësisht e qartë mënyra e funksionimit të tij në kuadër të strukturës së përgjithshme të tij. Ngjashëm është gjendja sa u përket Termave të Referencës së këtij departamenti dhe Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP) të stafit të tij (gjithsej 8), pra ekzistojnë dispozitat formale, por nuk dihen saktësisht mekanizmat dhe masat zbatuese.

Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës së zyrtarëve të DMMP-së së Kuvendit dhe mekanizmave e masave për zbatimin e këtyre standardeve, dihet se ka raportim dhe vlerësim të punës çdo vit, por nuk është e qartë se çfarë standardesh janë vendosur dhe si zbatohen ato. Sa u përket resurseve të alokuara DMMP-së gjatë periudhës që

mbulon ky vlerësim, përveç numrit të stafit, nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara këtij departamenti, e as ndonjë shumë e përafërt e planifikuar për vitin në vijim. E njëjta vlen në lidhje me resurset e alokuara për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik. Kur jemi te dokumentet strategjike dhe planifikuese për komunikim dhe informim publik dhe mekanizmat për monitorimin dhe raportimin e rregullt mbi zbatimin e tyre, Kuvendi posedon një strategji për informim dhe marrëdhënie me publikun, por nuk është plotësisht e qartë çfarë objektivash përmban dhe cilat janë masat e mekanizmat për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. E njëjta vlen edhe sa u përket aktiviteteve, qoftë në kuadër të kësaj strategjie, apo të planit vjetor të Kuvendit.

Më tej, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, Kuvendi ka pasur komunikim të rregullt me rreth 50 media (vendore dhe të huaja) dhe me 65 organizata të shoqërisë civile, me mediat me fokus në informimin e qytetarëve mbi punën e Kuvendit, kurse me OSHC-të kryesisht me fokus në monitorimin dhe qasjen në dokumente të tij. Sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me akterët jashtë-qeveritarë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve legjislativë dhe të politikave, dihen cilat janë këto dokumente, por nuk ka fare të dhëna mbi akterët jashtë-qeveritarë të përfshirë. Kuvendi ka të publikuar në ueb-faqen e tij ([www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org)) të gjitha ligjet dhe dokumente të tjera të rëndësishme (përfshirë procesverbalet e seancave plenare dhe të komisioneve). ky institucion gjithashtu ka ndërmarrë aktivitete shitesë për informim dhe komunikim me publikun, si 'ditët e hapura', publikimi i buletinit informativ Kuvendi e i fletëpalosjeve të ndryshme, vizita të grupeve të ndryshme, prodhimi i një dokumentari, e kështu me radhë. Së fundmi, Kuvendi ka dhënë listën e zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik (gjithsej tetë), me kualifikime dhe përvojë të konsiderueshme dhe relevante për punën që bëjnë dhe që kanë ndjekur trajnime me kohëzgjatje 1 - 4 javë.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Kuvendi i Republikës së Kosovës**, me **Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 55,5**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion **pjesërisht i hapur**.

## Institucionet ekzekutive të nivelit qendror

Informatat për qëllim të vlerësimit të këtij viti kanë dhënë vetëm dymbëdhjetë (12) institucione ekzekutive të nivelit qendror: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Diasporës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Forcës së Sigurisë, Ministria e Integritit Evropian, Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Për të përmbledhur, bazuar në informatat e dhëna për qëllime të këtij vlerësimi, të 12 institucionet ekzekutive të nivelit qendror të përfshira në vlerësimin e këtij viti, me mesataren e Indeksit të Transparencës Institucionale (ITI) prej 47.42, rezultojnë se gjatë vitit 2012 kanë qenë institucione të mbyllura.

### 2. Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Me qëllim të zbatimit të dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, Zyra e Kryeministrit gjithashtu zbaton Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun dhe Rregulloren për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike. Rregullorja e Punës përcakton se Kryeministri dhe Zëvendës-Kryeministrat janë përgjegjës për të siguruar që publiku të informohet mbi punën dhe vendimet e Qeverisë, ndërsa Zëdhënësi i Qeverisë dhe Zyra për Komunikim me Publikun (ZKP) në kuadër të Kryeministrit u ndihmojnë atyre në ushtrimin e këtyre përgjegjësi. Megjithatë, përveç dispozitave të cilat përcaktojnë procedurat për pranimin dhe evidentimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe një referimi të përgjithësuar (“[...] themelimi dhe funksionimi i një sistemi koherent dhe të koordinuar për të komunikuar me publikun politikat dhe aktivitetet nga ana e institucioneve publike.”), nuk është plotësisht e qartë se çfarë mekanizmash të tjerë zbatues ka në dispozicion ZKM për të siguruar zbatimin e këtyre dispozitave kushtetuese, e as çfarë strukturash, resursesh e obligimesh specifike përcakton legjislacioni zbatues për të siguruar zbatimin e tyre.

Më tej, përveç dispozitave të nenit 12 të LQDP-së që rregullojnë klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike senzitive në të cilat qasja e publikut është e kufizuar, sipas të dhënave të ofruara, ZKM nuk ka dispozita zbatuese specifike e as mekanizma e masa të qarta zbatuese. E njëjta vlen sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që përveç përmendjes së nenit 18 të LQDP-së dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, nuk është e qartë se çfarë masa dhe mekanizma zbatues ekzistojnë në kuadër të këtij institucioni. Edhe sa u përket strukturave të brendshme, përveç bazës ligjore për themelimin e Zyrës së saj për Komunikim dhe Informim Publik, nuk është e qartë se si duket dhe çfarë parashihet organogrami i kësaj zyre, e as pozita e saj në kuadër të organogramit të ZKM-së dhe mënyra e funksionimit të saj në kuadër të strukturës së përgjithshme të saj. Më pak e qartë është gjendja sa u përket Termave të Referencës (TR) dhe Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP) të stafit të saj, përveç përmendjes së bazës ligjore (në Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me

Publikun), nuk dihet saktësisht përmbajtja e tyre, e as mekanizmat dhe masat zbatuese.

Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës së zyrtarëve të ZKP-së dhe mekanizmave e masave për zbatimin e këtyre standardeve, është e qartë se ka raportim çdo tre muaj dhe vlerësim të punës çdo vit, bazuar në plane individuale të punës, por nuk është e qartë se çfarë standardesh janë vendosur dhe si zbatohen ato. Sa u përket resurseve të alokuara ZKP-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç se nuk ka pasur zvogëlim të numrit të stafit dhe se i janë alokuar të gjitha resurset e kërkuara, nuk është e qartë shuma e saktë e të gjitha kategorive të resurseve të alokuara, e as ndonjë shumë e përafërt e planifikuar për vitin aktual. Edhe më pak qartësi ka në lidhje me resurset e alokuara për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik. Kur jemi te dokumentet strategjike dhe planifikuese për komunikim dhe informim publik dhe mekanizmat për monitorimin dhe raportimin e rregullt mbi zbatimin e tyre, ZKP posedon një plan vjetor të punës, por nuk është plotësisht e qartë çfarë objektivash përmban dhe cilat janë masat e mekanizmat për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. E njëjta vlen edhe sa u përket aktiviteteve të parapara.

Më tej, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, ZKM ka pasur komunikim të rregullt me të gjitha mediat vendore dhe me 82 OShC (pjesë e platformës CiviKos), me mediat me fokus në informimin e qytetarëve mbi aktivitetet e udhëheqësve të Qeverisë dhe të ZKM-së, kurse me OShC-të kryesisht në hartimin e Strategjisë për Bashkëpunim Qeveri - Shoqëri Civile dhe të politikave në fushën e të drejtave të njeriut. Sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me akterët jashtë-qeveritarë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve legjislativë dhe të politikave, janë specifikuar shtatë projektligje dhe Strategjia për Bashkëpunim Qeveri - Shoqëri Civile, por nuk dihen saktë akterët konkretë jashtë-qeveritarë të përfshirë (përveç të dhënave të mësipërme). ZKM ka të publikuar në ueb-faqen e saj ([www.kryeministri-ks.net](http://www.kryeministri-ks.net)) shumë dokumente (vendime të Qeverisë, komunikata shtypi, dokumente ligjore e politikash, etj.). Sipas të dhënave, ZKM nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet shtesë për informim dhe komunikim me publikun gjatë periudhës që mbulon hulumtimi. Së fundmi, ky institucion nuk ka dhënë asnjë të dhënë rreth kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Zyra e Kryeministrit, me Indeks in e Transparencës Institucionale (ITI) prej 39**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

### **3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)**

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, MAPL gjithashtu zbaton Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm që themelon dhe përcakton kompetencat e Zyrës për Informim (ZI, tani e ngritur në nivel Divizioni - DI) dhe Rregulloren për

Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në kuadër të kësaj ministrie. Ashtu siç është përcaktuar me rregulloren e fundit, DI ka tre zyrtarë dhe fushëveprimi i përgjegjësive të saj përfshin si komponentin e qasjes në dokumente zyrtare ashtu edhe atë të komunikimit me publikun, më gjerë. Më tej, përveç procedurave për qasje në dokumente publike, nuk është plotësisht e qartë se çfarë mekanizmash të tjerë zbatues ka në dispozicion kjo ministri për të siguruar zbatimin e këtyre dispozitave kushtetuese, e as çfarë strukturash, resurseve dhe obligimesh të tjera specifike përcakton legjislativi zbatues për të siguruar zbatimin e tyre.

Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar, përveç ligjit përkatës, MAPL gjithashtu ka përmendur një opinion të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por nuk është e qartë nëse ka mekanizma e masa të tjera zbatuese. Ngjashëm, përveç referimit Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, nuk është e qartë se çfarë masa dhe mekanizma zbatues ekzistojnë në kuadër të këtij institucioni sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim. Sa u përket strukturave të brendshme, përveç sqarimeve të mësipërme mbi numrin e stafit të DI-së (Shefi, një zyrtar për informim dhe një zyrtar për ueb-faqe), është e qartë edhe pozita e tij (i raporton drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm). DI i MAPL-së ka Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të saj, kurse mekanizmat zbatues parashohin raportimin dhe vlerësimin, bazuar në planin e punës së Ministrisë, ndonëse nuk është plotësisht e qartë se si vihen në zbatim këto mekanizma.

Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës së zyrtarëve të DI-së së MAPL-së dhe mekanizmave e masave për zbatimin e këtyre standardeve, është e qartë se ka raportim javor, mujor e vjetor, bazuar në Planin vjetor të Punës, çdo tre muaj dhe vlerësim të punës çdo vit, por nuk është plotësisht e qartë se çfarë standardesh janë vendosur dhe si zbatohen ato. Sa u përket resurseve të alokuara këtij departamenti gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (të specifikuar më sipër), gjithashtu janë përmbushur nevojat për resurse financiare, bazuar në pesë dokumente planifikuese të DI-së. Sa u përket resurseve të alokuara për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik, përveç një liste aktivitetesh të financuara, mungon një pasqyrë e plotë e shumës së resurseve të alokuara për zbatimin e dokumenteve planifikuese (ndonëse MAPL ka përmendur pesë dokumente të tillë). Kur jemi te dokumentet strategjike dhe planifikuese për komunikim dhe informim publik dhe mekanizmat për monitorimin dhe raportimin e rregullt mbi zbatimin e tyre, MAPL ka tre të tillë (Planin vjetor të Zyrës për Informim, Planin vjetor për zhvillimin e transparencës në Komuna dhe Planin për zbatimin dhe raportim mbi LQDP), por nuk është e qartë çfarë objektivash përmbajnë dhe cilat janë masat e mekanizmat për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kur jemi te aktivitetet, kjo ministri është fokusuar në katër grupe syresh (publikimi i aktiviteteve të Ministrisë, prezantimi dhe diskutimi i Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2013 - 2016, zbatimi i LQDP-së dhe ofrimi i informatave lidhur me funksionalizmin e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore).

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, MAPL ka pasur komunikim të rregullt me media vendore dhe të huaja, kryesisht me qëllim informimi mbi aktivitetet e saj, dhe me 6 OShC, me fokus në hartimin e Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2013 - 2015, hapjen e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore dhe qasje në dokumente publike. Sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me akterët jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve legislative dhe të politikave, përveç strategjisë së sipërpërmendur, akterë të tillë gjithashtu janë përfshirë në hartimin e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, por nuk ka të dhëna më të hollësishme. E njëjta vlen në lidhje me përfshirjen e këtyre akterëve në zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve të politikave për komunikim dhe informim publik. Ngjashëm me institucionet e tjera, MAPL ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.mapl.rks-gov.net](http://www.mapl.rks-gov.net)) shumë informata dhe dokumente (akte ligjore, vendime, raporte, komunikata shtypi, dokumente politikash, etj.). Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura, MAPL gjatë periudhës që mbulon hulumtimi ka ndërmarrë një numër aktivitete, kryesisht informuese e promovuese dhe për bashkëpunim me OShC-të. Së fundmi, nga tre zyrtarë të DI-së, dy prej tyre kanë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune mesatarisht mbi pesëvjeçare, kurse nuk ka të dhëna mbi numrin e trajnimeve relevante të ndjekura.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me Indeks in e Transparencës Institucionale (ITI) prej 61**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion pjesërisht i hapur.

#### **4. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)**

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, MASHT gjithashtu zbaton Rregulloren për Komunikim Qeveritar me Publikun, por nuk është aspak e qartë çfarë strukturash, resurse e obligime janë përcaktuar, e as çfarë mekanizmesh e masash zbatuese janë në funksion. Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar dhe përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, përveç referimit legjislativ përkatës në përgjithësi, MASHT nuk ka ofruar të dhëna konkrete. Sa u përket strukturave të brendshme, vetëm dihet që në kuadër të kësaj ministrie funksionin një Zyrë e Komunikimit Publik (ZKP), e përbërë nga katër zyrtarë (Drejtori, dy zyrtarë për informim dhe një zyrtar për ueb-faqe). Sipas të dhënave të ofruara, Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të ZKP-së së MASHT-it janë përcaktuar me Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar, nuk është e qartë çfarë mekanizma e masa zbatuese ka, ndërsa raportimi bëhet në baza ditore e deri në vjetore, e vlerësimi i punës çdo gjashtë muaj, por nuk është plotësisht e qartë se çfarë standardesh janë vendosur dhe si zbatohen ato.

Sa u përket resurseve të alokuara ZKP gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (të specifikuar më sipër), gjithashtu dihet shuma e mjeteve buxhetore të alokuara dhe të shpenzuara dhe atyre të planifikuara për periudhën në vijim. Në lidhje me resurset e alokuara për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik, përveç



një liste aktivitete të financuara, mungon një pasqyrë e plotë e shumës së resurseve të alokuara për zbatimin e dokumenteve planifikuese (ndonëse MAPL ka përmendur pesë dokumente të tillë). Ngjashëm me institucionet paraprake, ZKP e MASHT-it ka një plan vjetor, objektivat kryesore të të cilit kanë të bëjnë me informimin e publikut mbi aktivitetet e Ministrisë dhe ofrimi i qasjes në dokumente publike, por nuk janë plotësisht të qartë masat e mekanizmat për monitorimin dhe raportimin e rregullt mbi zbatimin e tij, përveç raportimit të rregullt Sekretarit të Përgjithshëm.

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, kjo ministri ka pasur komunikim të rregullt me mediat, kurse me OShC-të sipas kërkesave, me mediat kryesisht me qëllim të informimit të publikut mbi aktivitetet e ministrisë. Më specifikisht, 15 OShC, si dhe BSPK dhe Oda Ekonomike e Kosovës janë përfshirë në punën e MASHT-it gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, por nuk dihet lloji i saktë i përfshirjes. Sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me akterët jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve legjislativë dhe të politikave, ka pasur gjithsej 8 dokumente ligjore dhe asnjë dokument politikash, por në të cilat janë përfshirë vetëm Asociacioni i Komunave dhe OEK si akterë jashtë-qeveritarë (përfshirë donatorët). E ngjashme ka qenë gjendja në lidhje me përfshirjen e këtyre akterëve në zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve të politikave, pasi që dihet vetëm një OShC (e përfshirë në monitorim). Ngjashëm me institucionet e tjera, MASHT ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.masht-gov.net](http://www.masht-gov.net)) shumë informata dhe dokumente (në shqip, serbisht e anglisht). Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura, kjo ministri gjatë periudhës që mbulon hulumtimi nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet shtesë për komunikim e informim publik. Së fundmi, MASHT ka dhënë vetëm listën e stafit të ZKP-së, por asnjë të dhënë mbi kualifikimet, përvojën e punës dhe trajnimet relevante të ndjekura.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me Indeksën e Transparencës Institucionale (ITI) prej 35, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## 5. Ministria e Diasporës (MeD)

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, MeD gjithashtu zbaton Ligjin për Mërgatën, Rregulloren për Komunikim Qeveritar me Publikun dhe UA për Strukturën Organizative të MeD-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Komunikim Publik (ZKP) të kësaj ministrie dhe të drejtorit të saj janë përcaktuar me dy aktet e fundit nënligjore. Megjithatë, përveç të garantimit formal të së drejtës për qasje në dokumente publike, pa diskriminim, nuk është plotësisht e qartë se çfarë strukturash, resursesh e obligimesh specifike përcakton legjislativoni zbatues në fjalë për të siguruar zbatimin e këtyre dispozitave kushtetuese. Ngjashëm është gjendja sa u përket mekanizmave e masave zbatuese, pasi që nuk ka të dhëna përveç shpjegimit të procedurave bazike për qasje në dokumente publike.

Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar dhe përdorimit të gjuhëve zyrtare

dhe atyre në përdorim, përveç referimit ligjeve përkatës kornizë, nuk është e qartë cilat janë mekanizmat e masat zbatuese. Sa u përket strukturave të brendshme, nuk është e qartë nëse ZKP e kësaj ministrie ka organogram e rrjedhimisht as se si funksionon ajo në këtë aspekt. Ngjashëm me ministri të tjera, kjo Zyrë ka Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të saj (prej tre zyrtarësh), të përcaktuar më UA-në e specifikuar më sipër, kurse nuk është aspak e qartë se si funksion raportimi e vlerësimi i punës së tyre. Sa u përket resurseve të alokuara kësaj ZKP gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (të specifikuara më sipër), nuk ka të dhëna të tjera, por është dhënë shuma e mjeteve financiare për paga dhe pajisje teknike të planifikuara për periudhën në vijim. Në lidhje me resurset e alokuara për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik, përveç resurseve humane, nuk dihet shuma e resurseve të tjera të alokuara. Kjo Zyrë ka një Plan veprimi, por nuk dihen objektivat që përmban ai, kurse aktivitetet kryesore janë ato për monitorimin e mediave dhe për mundësimin e qasjes në dokumente publike, sipas kërkesës. Në anën tjetër, nuk janë plotësisht të qartë mekanizmat për monitorimin dhe raportimin e rregullt mbi zbatimin e këtij plani, përveç referimit raportimit të rregullt të brendshëm Sekretarit të Ministrisë.

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, kjo ministri ka pasur komunikim të rregullt me media të ndryshme vendore dhe nga diaspora, kurse në punën e saj janë përfshirë rreth 35 OShC (përfshirë OJQ lokale dhe nga diaspora), me mediat me qëllim të informimit të publikut mbi aktivitetet e ministrisë, por nuk është i qartë lloji i saktë i përfshirjes së OShC-ve. Sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me akterët jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve legjislative dhe të politikave, ka pasur dy dokumente ligjore, por nuk është përmendur asnjë akter i tillë i përfshirë. Në anën tjetër, në hartimin e një strategjie për diasporën (në proces e sipër) është e përfshirë vetëm një OShC, kurse nuk ka aspak qartësi rreth përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve të politikave. Edhe MeD ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.medrks-gov.net](http://www.medrks-gov.net)) sasi të konsiderueshme informatash e dokumentesh (në shqip, serbisht e anglisht), por gjatë periudhës që mbulon ky hulumtim nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik. Së fundmi, MeD nuk ka dhënë asnjë të dhënë në lidhje me kualifikimet, përvojën dhe trajnimet relevante të ndjekura nga stafi i ZKP-së.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Diasporës, me Indeks in e Transparencës Institucionale (ITI) prej 37**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## 6. Ministria e Drejtësisë (MD)

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, MD gjithashtu zbaton Rregulloren për Komunikim Qeveritar me Publikun dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të saj. Kjo e fundit përcakton kompetencat e Divizionit të saj për Komunikim Publik (DKP). Në lidhje me mekanizmat e masat zbatuese, zbatohen vetëm katër procedura, që prekin vetëm mundësimin e qasjes në dokumente

publike informimin e publikut mbi aktivitetet e Ministrisë, por nuk është plotësisht e qartë si zbatohen ato për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë, e as çfarë strukturash, resursesh e obligimesh specifike përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim.

Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar dhe përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, përveç referimit ligjeve përkatës kornizë, nuk është e qartë cilat janë mekanizmat e masat zbatuese. Sa u përket strukturave të brendshme, sipas organogramit të MD-së, DKP i raporton drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm, por nuk është plotësisht e qartë se si funksionon ai. Më tej, Termat e Referencës (TR) së DKP-së dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të tij (prej dy zyrtarësh) janë përcaktuar me rregulloren e sipërpërmendur, e cila është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Ministria e Administratës Publike. Në anën tjetër, kur jemi te raportimi dhe vlerësimi i punës, vetëm dihet përgjithësisht se ka raportim javor e vlerësim të punës në baza vjetore, bazuar në performancën e stafit, por nuk është plotësisht e qartë se si kryhet kjo dhe në bazë të çfarë kriteresh e procesesh.

Sa u përket resurseve të alokuara këtij DKP gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (të specifikuara më sipër), MD i konsideron resurset e alokuara të mjaftueshme (përfshirë përkrahjen nga struktura të tjera të ministrisë për DKP-në), por nuk dihet shuma e saktë e resurseve të alokuara gjatë periudhës që mbulon vlerësimi e as atyre të planifikuara për periudhën në vijim. E njëjta vlen në lidhje me resurset e alokuara për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik. DPK punon bazuar në Planin Zhvillimor Strategjik dhe Planin Vjetor të MD-së, e objektivi i vetëm relevant për komunikim e informim publik është ai për vetëdijësimin e publikut mbi sistemin e drejtësisë në Kosovë, por nuk është e aspak e qartë se çfarë aktivitetesh janë paraparë. Në anën tjetër aktivitetet kryesore kanë të bëjnë me informimin e qytetarëve mbi punën e MD-së dhe krijimin e institucioneve të reja, si dhe në lidhje me qasjen në dokumente publike, kurse sa u përket mekanizmave për monitorimin dhe raportimin e rregullt mbi zbatimin e pjesëve të këtyre dokumenteve që janë relevante për komunikim dhe informim publik, vetëm dihet se ka raportim në baza tremujore dhe vjetore mbi zbatimin e LQDP-së.

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, kjo ministri ka pasur komunikim të rregullt me 22 media vendore dhe disa media të huaja, kurse në punën e saj janë përfshirë 8 OShC, me mediat me qëllim të informimit të publikut mbi aktivitetet e ministrisë, kurse me këto të fundit në lidhje me qasjen në dokumente publike, pjesëmarrjen në hartimin e ligjeve, monitorimin e procedurave tenderuese dhe punën e dikastereve të veçantë të Ministrisë (përfshirë mbikëqyrjen e Shërbimit Korrektues), ndonëse nuk është plotësisht e qartë kohëzgjatja e saktë dhe lloji i përfshirjes (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet). Sa i përket përfshirjes së akterëve të tillë në hartimin e dokumenteve legjislativë dhe të politikave, ka pasur 7 projektligje, por vetëm 4 akterë të tillë të përfshirë (nga të cilat një OShC, dy shoqata profesionale dhe një institucion akademik). Në anën tjetër, sipas të dhënave të kësaj ministrie, nuk është përfshirë asnjë akter i tillë në hartimin e Planit Zhvillimor Strategjik të saj

(të miratuar vitin e kaluar). E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së këtyre akterëve në zbatimin e dokumenteve të politikave.

Së fundmi sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në nivelin e politikave, monitorimin e zbatimit të planit në fjalë gjatë periudhës që mbulon vlerësimi e kanë bërë vetëm dy OShC. MD ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.md-ks.org](http://www.md-ks.org)) një numër të madh dokumentesh e informatash. Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim janë ndërmarrë një numër aktivitetsesh shpesh për komunikim dhe informim publik, monitorimi i prokurimit publik (përfshirë ftesë OJQ-ve të tjera për të monitoruar prokurimin publik në këtë ministri) dhe vendosja e një kutie ankesash. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i DKP-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune prej një viti, respektivisht pesë vitesh, dhe trajnime me kohëzgjatje tri javë, respektivisht dy muaj, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Drejtësisë**, me Indeks in e **Transparencës Institucionale (ITI) prej 67**, rezulton të jetë institucion **gjysmë i hapur**.

## 7. Ministria e Financave (MF)

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, edhe MF zbaton Rregulloren për Komunikim Qeveritar me Publikun, Rregulloren për Kodin e Etikës për Zyrtarët e Komunikimit me Publikun dhe strukturën organizative të Ministrisë. Rregullorja për Komunikim Qeveritar me Publikun përcakton detyrat e përgjegjësive dhe strukturën organizative të Zyrës së Komunikimit Publik (ZKP) të MF-së, ajo për Kodin e Etikës parimet e përgjithshme të komunikimit me publikun (ligjshmëria, profesionalizmi dhe paanshmëria). Mekanizmat e masat zbatuese përfshijnë zhvillimin e fushatave të informimit publik, komunikimin e përgjithshëm të politikave dhe të aktiviteteve qeveritare për publikun, vlerësimet dhe sondazhet, marrëdhëniet me media dhe analizat mediale, përpunimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, mirëmbajtjen e faqeve zyrtare të internetit, dhe vlerësimin e arkivimit e produkteve të komunikimit. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë si zbatohen ato për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë e çfarë strukturash, resursesh e obligimesh specifike përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim.

Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar dhe përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, përveç referimit ligjeve përkatës kornizë, nuk është e qartë cilat janë mekanizmat e masat zbatuese. Sa u përket strukturave të brendshme, vetëm dihet se ZKP është paraparë në kuadër të organogramit të MF-së, kurse Termat e Referencës (TR) së tij dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të saj (prej katër zyrtarësh) janë përcaktuar me legjislacionin relevant, nuk është dhënë asnjë informatë tjetër. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që vetëm dihet se ka një vlerësim vjetor, por nuk është e qartë se si kryhet kjo dhe në bazë të çfarë standardesh,

kriteresh e procesesh. Sa u përket resurseve të alokuara kësaj ZKP gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (të specifikuar më sipër), kjo zyrë ka deklaruar se ka resurse të mjaftueshme, por nuk dihet shuma e saktë e tyre dhe e atyre të planifikuara për periudhën në vijim dhe për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik. Në anën tjetër, ZKP ka një Plan të Komunikimit dhe një Plan Pune, por nuk është aspak e qartë cilat janë objektivat e përcaktuara, kurse kategoria e vetme e aktiviteteve është ajo për informimin e publikut në mbi aktivitetet e MF-së në kuadër të fushëveprimit të saj.

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, MF ka pasur komunikim të rregullt me 20 media vendore dhe disa të huaja, kurse në punën e saj janë përfshirë 2 OShC, me mediat me qëllim të informimit të publikut mbi aktivitetet e ministrisë dhe shpenzimin e buxhetit të shtetit, por nuk dihet lloji i aktiviteteve e i përfshirjes së OShC-ve (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet). Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve legjislativë dhe të politikave, ka pasur 7 projektligje, në hartimin e të cilave janë përfshirë vetëm asociacionet e komunitetit të biznesit. Në anën tjetër, nuk është specifikuar asnjë dokument politikash i hartuar nga MF gjatë periudhës raportuese, e rrjedhimisht as ndonjë akter i jashtë-qeveritar. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së këtyre akterëve në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të dokumenteve të politikave. MF ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.mf.rks-gov.net](http://www.mf.rks-gov.net)) një numër të madh dokumentesh e informatash, kurse nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet shtesë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. Së fundmi, MF nuk ka dhënë asnjë informatë konkret mbi kualifikimet, përvojën dhe trajnimet relevante të ndjekura nga stafi i ZKP-së.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Financave, me Indeks in e Transparencës Institucionale (ITI) prej 47**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## **8. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)**

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, edhe MFSK zbaton edhe dy akte nënligjore: UA mbi Dhënien e Informatave dhe Komunikimin me Mjetet e Informimit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe UA mbi Misionin, Organizimin dhe Strukturën e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ky i fundit përcakton se Departamenti për Marrëdhënie me Publikun (DMP) është në varësi të Ministrit dhe është përgjegjës për të zhvilluar, udhëhequr dhe drejtuar të gjitha funksionet dhe shërbimet e menaxhimit të komunikimit për MFSK-në dhe për sigurimin e imazhit pozitiv të MFSK-së dhe FSK-së. Ky i fundit gjithashtu përcakton kriteret dhe procedurat për pjesëtarët e MFSK-së dhe FSK-së në raport me dhënien e informatave dhe kontaktin me mjetet e informimit si dhe trajtimi i kërkesave të mjeteve të informimit. Megjithatë, nuk është aspak e qartë cilat janë mekanizmat e masat zbatuese në fuqi, si zbatohen ato për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë e as çfarë strukturash, resursesh e

obligimesh specifike përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim. Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar përveç Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, kjo ministri gjithashtu zbaton aktet nënligjore (rregulloret për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar, standardet për sigurinë e informacionit të klasifikuar për operatorët ekonomikë, zhvillimin e procedurës së verifikimit të sigurisë, klasifikimin dhe deklasifikimin e informacioneve, dhe për shpërndarjen dhe transferimin e informacioneve të klasifikuara). Në anën tjetër, sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, ajo zbaton vetëm ligjin kornizë. Nuk është e qartë cilat janë mekanizmat e masat zbatuese për asnjërën kategori.

Sa u përket strukturave të brendshme, vetëm dihet se DMP është paraparë në kuadër të organogramit të MFSK-së dhe baza ligjore. E njëjta vlen për Termat e Referencës (TR) së tij dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të tij, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë më e hollësishme. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që vetëm dihet se ka një vlerësim vjetor, por nuk është e qartë se si kryhet kjo dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh. Sa u përket resurseve të alokuara DMP-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (4 zyrtarë), vetëm kanë deklaruar se posedojnë resurse të mjaftueshme teknike e financiare (këto të fundit 90% nga ato të kërkuara), por nuk dihet shuma e saktë e tyre dhe e atyre për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik. Në anën tjetër, përderisa resurset humane e teknike të planifikuara për periudhën në vijim mbeten të njëjta, shuma e buxhetit të planifikuar është €82,000 (76% nga sa është kërkuar). Në anën tjetër, MFSK ka një Strategji për Marrëdhënie me Publikun, por nuk është aspak e qartë cilat janë objektivat e përcaktuara, e as lista aktiviteteve të planifikuara për informimin e publikut dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre.

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, MFSK ka pasur komunikim të rregullt me shumicën e mediave vendore e në punën e saj janë përfshirë 7 OShC, me mediat me fokus në informimin e publikut mbi aktivitetet e Ministrisë dhe të FSK-së, kurse me OShC-të në shkëmbimin e informatave për sundimin e ligjit, por nuk dihet plotësisht saktë lloji i përfshirjes së OShC-ve (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet). Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve legjislativë dhe të politikave, janë hartuar 12 dokumente të tilla (përfshirë Strategjinë për Siguri Kombëtare), por nuk dihet numri i akterëve të tillë të përfshirë. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së këtyre akterëve në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të dokumenteve të politikave. MFSK ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.mksf-ks.org](http://www.mksf-ks.org)) një numër të madh dokumentesh e informatash, por nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet shtesë për informim dhe komunikim me publikun gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i DMP-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune të konsiderueshme dhe pjesëmarrje në trajnime me kohëzgjatje mbi tre muaj gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës**, me Indeksën e Transparencës Institucionale (ITI) prej 44, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## 9. **Ministria e Integritit Evropian (MIE)**

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, MIE gjithashtu zbaton Rregulloren për Strukturën Organizative të Ministrisë dhe Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun. Përmbajtja e dispozitave përkatëse përcaktojnë funksionet e Zyrës për Komunikim Publik (ZKP, i avancuar më 2013 në Divizion për Komunikim dhe Informim - DKI) dhe katër mekanizma e masa zbatuese, të cilët prekin kryesisht lehtësimin e qasjes në dokumente zyrtare të MIE-së dhe standardet etike, por nuk është plotësisht e qartë se çfarë strukturash, resursesh e obligimesh specifike ka, dhe si zbaton DKI këto masa, mekanizma e standarde etike për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë e as çfarë përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim. Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar përveç Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, nuk është e qartë se çfarë masash e mekanizmash zbatues përdor MIE për zbatimin duhur të këtyre dispozitave. E njëjta vlen në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim nga kjo ministri.

Sa u përket strukturave të brendshme, në kuadër të organogramit të ri të kësaj ministrie, ZKP është ngritur në nivel të Divizionit për Komunikim dhe Informim (DKI), cili funksionon në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe ka tre zyrtarë, por nuk janë dhënë shpjegime më të hollësishme në lidhje me funksionimin e tij në kuadër të organogramit të Ministrisë. E njëjta vlen për Termat e Referencës (TR) së tij dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të tij, pasi që nuk është e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që vetëm dihet se ka një vlerësim vjetor, bazuar në kryerjen e detyrave të parapara me PVP, por nuk është plotësisht e qartë se si kryhen këto dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh.

Në lidhje me resurset e alokuara DKI-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (4 zyrtarë), MIE posedon resurse të mjaftueshme teknike e financiare, kurse resurset humane janë në kompletim e sipër, por nuk dihet shuma e saktë e tyre dhe e atyre për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik. E njëjta vlen në lidhje me shumën e resurseve të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Në anën tjetër, ky DKI ka një Plan vjetor të Komunikimit dhe është në finalizim e sipër një Strategjie dhe Plani Veprimi katërvjeçar për Komunikim. Në lidhje me objektivat e përcaktuara, kjo strategji parasheh koordinim zyrtarë me të gjitha palët e përfshira në procesin e integritit (siç janë shoqëria civile, mediet, unionet e biznesit dhe oda ekonomike, zyrtarët komunal, dhe përfaqësuesit e sindikatave të punëtorëve), si dhe një komponent të monitorimit dhe vlerësimin e zbatimit të objektivave të saj. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë se çfarë masa për monitorim dhe raportim të rregullt ka dhe si zbatohen ato, përveç koordinimit më të mirë për informim rreth procesit të integritit evropian dhe

resurseve humane (një zyrtari përgjegjës) përgjegjëse për qasje në dokumente publike. Ngjashëm është gjendja në nivelin e aktiviteteve, pasi që përveç aktiviteteve në lidhje me qasjen në dokumente zyrtar sipas kërkesës së palëve, nuk është plotësisht e qartë çfarë aktiviteteve janë paraparë për realizimin e secilit objektiv për informimin e publikut e as në lidhje me mekanizmat e m\*asat zbatuese në këtë drejtim.

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, MIE ka pasur komunikim të rregullt me shumicën e mediave vendore, si dhe me 7 OShC dhe me Platformën CIVIKOS, në kuadër të procesit të integritimit evropian. Sa u përket mediave, aktivitetet kryesore janë fokusuar në informimin e publikut mbi punën e Ministrisë (përfshirë në lidhje me politikat e dokumentet e ndryshme të hartuara), pjesëmarrjen në programe të ndryshme mediale ku janë diskutuar çështje për integritimin evropian, dhe informimin e publikut rreth këtij procesi. Në anën tjetër, aktivitetet me OShC janë fokusuar kryesisht në përfshirjen e tyre në punën e Task Forcës për Integritim Evropian, diskutimet për hartimin e Strategjisë për Komunikim, si dhe diskutime të përbashkëta mbi legjislacionin për shoqëri civile dhe pjesëmarrje qytetare në Kosovë dhe përmirësimin e komunikimit me BE-në. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë se për çfarë lloji të përfshirjes së OShC-ve (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet) bëhet fjalë.

Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve legjislative dhe të politikave, MIE nuk ka sponsorizuar ose hartuar ndonjë akt ligjor, e rrjedhimisht nuk është përfshirë asnjë akter i tillë, kurse në hartimin e Planit Vjetor dhe të Strategjisë për Komunikim janë përfshirë akterët e tillë, por nuk është e qartë sa është numri i tyre dhe cili ka qenë roli i tyre. Në anën tjetër, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim asnjë akter i tillë nuk është përfshirë në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimit të zbatimit të dokumenteve të politikave. MIE ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.mei-ks.net](http://www.mei-ks.net)) rreth 80 dokumente, si dhe lloje të tjera informatash (në dy gjuhët zyrtare dhe në anglisht), kurse sa u përket aktiviteteve shtesë për informim dhe komunikim me publikun gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, MIE ka nisur një fushatë informimi rreth procesit të liberalizimit të vizave. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i DKI-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune të konsiderueshme (nga 5 deri në 12 vjet) dhe pjesëmarrje në trajnime me kohëzgjatje gjithsej nga 5 muaj deri në një vit.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Integritimit Evropian**, me **Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 51**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## **10. Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit (MKK)**

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, MKK gjithashtu zbaton Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun dhe një udhëzues të vitit 2008 për qasje në dokumente publike, por përveç detyrimit për të themeluar një Zyrë për Komunikim me Publikun (ZKP), nuk është aspak e qartë përmbajtja e



dispozitave që rregullojnë strukturat, resurset e obligimet specifike të kësaj ministrie për komunikim e informim publik, e as mekanizmat e masat zbatuese për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë e as çfarë përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim. E njëjta vlen në lidhje me klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar, pasi që vetëm u janë referuar ligjeve përkatës kornizë. Në nivelin e strukturave të brendshme, organogrami i kësaj ministrie parasheh funksionimin e ZKP-së, me tre zyrtarë, por nuk janë dhënë shpjegime më të hollësishme në lidhje me funksionimin e tij në kuadër të organogramit të Ministrisë. E njëjta vlen për Termat e Referencës (TR) së tij dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të tij, pasi që nuk është e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që vetëm dihet se ka një vlerësim vjetor, por nuk është plotësisht e qartë se si kryhen këto dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh.

Në lidhje me resurset e alokuara ZKP-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane, nuk është aspak e qartë shuma e saktë e kategorive të tjera të resurseve, e as shuma e resurseve për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Në anën tjetër, kjo zyrë ka një Strategji të Komunikimit dhe një Plan të Punës, kurse objektivi kryesor i paraparë në kuadër të strategjisë është përmirësimi i komunikimit në mes të Ministrisë dhe partnerëve të saj, Qeverisë, autoriteteve komunale, organizatave ndërkombëtare, medieve, OJQ-ve e posaçërisht të kthyerve. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë se çfarë masa për monitorim dhe raportim të rregullt ka dhe si zbatohen ato, përveç raportimit në baza tremujore për zbatimin e planit në fjalë, kryesisht në kuadër të zbatimit të LQDP-së. Në anën tjetër, në nivelin e aktiviteteve nuk është aspak e qartë se çfarë aktiviteteve janë paraparë, e as në lidhje me mekanizmat e masat zbatuese në këtë drejtim. Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, MKK ka pasur komunikim të rregullt ditor me të gjitha mediat vendore dhe disa media rajonale, kryesisht me qëllim të informimit të publikut mbi punën e Ministrisë. Në anën tjetër, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, në punën e saj janë përfshirë 2 OShC. Megjithatë, nuk është aspak e qartë se çfarë aktiviteteve ka pasur me këto të fundit, e as lloji i përfshirjes së tyre (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet).

Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve legjislative gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim MKK nuk ka sponsorizuar ose hartuar ndonjë akt ligjor, e rrjedhimisht nuk është përfshirë asnjë akter i tillë. Në anën tjetër, në nivelin e politikave, gjatë kësaj periudhe është hartuar Strategjia e MKK-së 2014 - 2017, por nuk është aspak e qartë sa akterë të tillë janë përfshirë dhe cili ka qenë roli i tyre. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në zbatimin e kësaj strategjie, kurse në monitorimin e vlerësimin e zbatimit të saj janë përfshirë disa akterë të tillë (nga të cilët 2 OJQ vendore dhe 6 organizata të huaja dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë). MKK ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.mkk-ks.org](http://www.mkk-ks.org)) një numër të konsiderueshëm dokumentesh dhe informata të tjera (në dy gjuhët zyrtare dhe në anglisht), kurse sa u përket aktiviteteve shtesë për informim dhe komunikim me publikun gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, MKK ka publikuar një buletin informativ

periodik. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i DKI-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale pak relevante, përvojë pune të konsiderueshme (nga 2 deri në 26 vjet, ndonëse nuk dihet sa është relevante) dhe pjesëmarrje në trajnime me kohëzgjatje gjithsej dhjetë ditë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, me Indeks in e Transparencës Institucionale (ITI) prej 48**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## **11. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)**

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, MPMS gjithashtu zbaton Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por përveç referimit në dispozitën që përcakton strukturën organizative të të gjitha Zyrave për Komunikim me Publikun (ZKP) nëpër ministri, nuk është aspak e qartë përmbajtja e dispozitave të tjera që rregullojnë strukturat, resurset e obligimet specifike të kësaj ministrie për komunikim e informim publik, e as mekanizmat e masat zbatuese për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë e as çfarë përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim. Në anën tjetër, nuk është aspak e qartë se si rregullohet çështja e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar dhe ajo e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë. Në nivelin e strukturave të brendshme, organogrami i kësaj ministrie parasheh funksionimin e ZKP-së, në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, por nuk janë dhënë shpjegime më të hollësishme në lidhje me funksionimin e saj në kuadër të organogramit të Ministrisë. E njëjta vlen për Termat e Referencës (TR) së tij dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të saj, pasi që nuk është aspak e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që vetëm është thënë se kjo bëhet konform legjislacionit në fuqi, por nuk është aspak e qartë se si kryhen këto dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh.

Në lidhje me resurset e alokuara ZKP-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (tre zyrtarë), nuk është aspak e qartë shuma e saktë e tyre, e as shuma e resurseve për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Në anën tjetër, kjo zyrë ka një Plan Vjetor të Punës (i cili është pjesë e Planit Vjetor të Ministrisë), por nuk është aspak e qartë çfarë objektivash parashihen për komunikim dhe informim publik (përveç kërkesave për qasje në dokumente publike), e as çfarë masa për monitorim dhe raportim të rregullt ka dhe si zbatohen ato. E njëjta vlen sa u përket aktiviteteve për komunikim dhe informim publik. Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, MPMS ka pasur komunikim të rregullt ditor me të gjitha mediat vendore që kanë pasur interesim për të ndjekur aktivitetet e saj, kryesisht me qëllim të informimit të publikut mbi punën e Ministrisë. Në anën tjetër, sipas të dhënave të tyre, gjatë kësaj periudhe në punën e saj nuk është përfshirë asnjë OShC.

Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve legjislativë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim MPMS ka sponsorizuar dhe hartuar 7 projektligje, por në hartimin e tyre nuk është përfshirë asnjë akter i tillë. Në anën tjetër, në nivelin e politikave, gjatë kësaj periudhe janë hartuar 5 dokumente të tilla, ku janë përfshirë 2 akterë nga komuniteti i biznesit, si dhe sindikatat dhe OJQ-të (ndonëse nuk dihet numri i akterëve nga këto dy kategori të fundit. Në anën tjetër, asnjë akter i tillë nuk është përfshirë në zbatimin e dokumenteve të politikave të kësaj ministrie, e as në monitorimin e vlerësimitin e zbatimit të tyre. MPMS ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.mpms.rks-gov.net](http://www.mpms.rks-gov.net)) një numër të konsiderueshëm dokumentesh dhe informata të tjera (në dy gjuhët zyrtare dhe në anglisht), kurse nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet shtesë për informim dhe komunikim me publikun gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i ZKP-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune të konsiderueshme (nga 6 deri në 9 vjet, ndonëse nuk dihet sa është relevante) dhe pjesëmarrje në trajnime me kohëzgjatje gjithsej deri në 4 javë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me Indeks in e Transparencës Institucionale (ITI) prej 26**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## 12. Ministria e Shëndetësisë (MSh)

Me qëllim të zbatimit të dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, MSh gjithashtu zbaton Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, e cila përkufizon përgjegjësitë e ZKP-ve në të gjitha ministrinë (kjo ministri e ka avancuar këtë zyrë në Departament të Informimit). Më tej, kjo rregullore përcakton funksionin e këtij departamenti (të sigurojë që politikat e Ministrisë të diskutohen dhe t'u komunikohen në mënyrë të qartë dhe efektive grupeve të synuara apo palëve të interesuara), por përtej dispozitave ligjore formale, nuk është plotësisht e qartë çfarë strukturash, resursesh e obligimesh specifike përcakton ajo për të siguruar zbatimin e këtyre dispozitave. Sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese, rregullorja e sipërpërmendur e obligon MSh-në që të vendosë strukturat përgjegjëse për komunikim dhe informim të publikut, por përtej kësaj nuk është plotësisht e qartë si çfarë mekanizma të tjerë zbaton kjo zyrë, si dhe nëpërmjet çfarë procedurash. Më tej, përveç dispozitave formale të Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare, nuk është e qartë se çfarë dispozitash zbatuese specifike ka vënë në fuqi kjo ministri me qëllim të rregullimit të klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive, e as mekanizma e masa të qarta zbatuese. Sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, përveç dispozitave kryesore të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, kjo Ministri gjithashtu ka zhvilluar katër lloj mekanizmash zbatues (përkthimi i legjisllacionit, dokumenteve strategjike, informatave dhe konkurseve në të dy gjuhët zyrtare dhe në anglisht, por megjithatë, nuk është e qartë në hollësi deri në çfarë mase zbatohen këto mekanizma dhe të tjerë që mundësojnë qasjen në dokumente dhe informata zyrtare në të gjitha gjuhët zyrtare dhe ato në përdorim zyrtar në vend.

Sa u përket strukturave të brendshme, kjo ministri ka një Departament të Informimit (DI) që nga viti 2007, me i përbërë nga tre zyrtarë dhe i udhëhequr nga Drejtori, i cili i raporton drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm. DI është përgjegjës që t'i ofrojë publikut informata mbi veprimtarinë e Ministrisë, agjendën e saj, shpjegime për çështje të ndryshme me rëndësi për publikun, si dhe të vendosë marrëdhënie të dyanshme me publikun dhe me palët e tjera të interesuara. Me organogramin e ri të Ministrisë, që pritet të miratohet së shpejti, ky departament do të jetë i organizuar në formë të një Divizioni të Komunikimit Publik (DKP). Rrjedhimisht, është pak a shumë i qartë roli dhe pozita e tij në kuadër të organogramit të institucionit, por jo plotësisht e qartë mënyra e funksionimit të tij në kuadër të strukturës së përgjithshme të tij. Sa u përket Termave të Referencës së DI-së dhe Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP) të stafit të tij, dihet përmbajtja e dispozitave formale, por nuk dihen saktësisht mekanizmat dhe masat zbatuese.

Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës së zyrtarëve të DI-së së MSh-së dhe mekanizmave e masave për zbatimin e këtyre standardeve, DI raporton dhe monitorohet në bazë të raporteve mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore, ndërsa vlerësimi i performancës së zyrtarëve kryhet nga Drejtori i Departamentit, bazuar në nivelin e zbatimit të Planit individual të punës dhe të Departamentit, kurse puna e Drejtorit vlerësohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Më tej, gjithashtu ka një proces vetëvlerësimi për secilin zyrtar. Sipas MSh-së, këto vlerësime bëhen në mënyrë transparente dhe në konsultime brenda departamentit, kurse dokumentet përkatëse mbahen në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm dhe atë të Personelit të Administratës. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë se si konkretisht bëhet vlerësimi në bazë të planeve individuale të punës dhe në çfarë standardesh bazohet ky proces në aspektin cilësor. Në lidhje me resurset e alokuara DI-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç numrit të stafit, nuk është e qartë shumica e kategorive të tjera të resurseve të alokuara, e as ndonjë shumë e përafërt e planifikuar për vitin në vijim. Sa u përket resurseve të alokuara për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik, buxheti alokohet në baza vjetore. Bazuar në këtë, Plani njëvjeçar i Veprimit 2013 për zbatimin e Strategjisë së Komunikimit 2012 - 2015 (shih më poshtë) është i buxhetuar, me një kosto të vlerësuar prej rreth €74,000, kurse për zbatimin e planit të vitit 2012 janë alokuar gjithsej €24,900.

Kur jemi te dokumentet strategjike dhe planifikuese për komunikim dhe informim publik dhe mekanizmat për monitorimin dhe raportimin e rregullt mbi zbatimin e tyre, MSh ka një Strategji të Komunikimit 2012 - 2015 dhe harton Plane njëvjeçare të Veprimit për zbatimin e saj. Strategjia përmban 5 objektiva të përgjithshme dhe gjithsej 11 objektiva specifike. Objektivat e përgjithshme fokusohen në komunikimin e brendshëm, bashkëpunimin ndërinstitutional, marrëdhëniet me publikun, buxhetimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit. Në anën tjetër, Plani i Veprimit për 2013 përmban gjithsej 41 aktivitete, të cilat janë të buxhetuara dhe përmbajnë indikatorë, institucione përgjegjëse dhe përkrahëse për realizimin e tyre, ndërlidhen me dokumente të tjera strategjike dhe afate kohore. Megjithatë, shikuar nga aspekti cilësor, vetëm njëri objektiv prek drejtpërdrejt marrëdhëniet me publikun, kurse objektivat specifike dhe

aktivitetet e synuara për zbatimin e tij janë formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk bazohen në caqe që duhet arrirë, e as nuk duket se prekin fusha dhe çështje specifike me prioritet në kuadër të fushëveprimit të kësaj ministrie, e rrjedhimisht edhe indikatorët nuk duket se lehtësojnë mjaftueshëm procesin e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë dhe planit të veprimit në fjalë.

Më tej, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, Kuvendi ka pasur komunikim të rregullt me rreth 22 media (kryesisht vendore, përfshirë të shtypura dhe elektronike, si në nivelin qendror, ashtu edhe atë lokal), si dhe me 29 organizata të shoqërisë civile dhe 9 asociacione profesionale të fushës së shëndetësisë. Komunikimi me mediat ka përfshirë konferencat për media, takimet joformale, dhënien e informatave në baza ditore, komunikatat për media, intervistat e drejtpërdrejta, forume e debate të ndryshme dhe emisione tematike. Në anën tjetër, sa i përket bashkëpunimit me OShC-të, ai ka qenë kryesisht në formë shkëmbimi informatash, konsultimesh dhe partneriteti, me fokus në vetëdijesimin e publikut, hartimin e legjislacionit dhe kornizës tjetër rregullative, zbatimin e politikave, menaxhimin shëndetësor, furnizimin me barna dhe trajtimin e pacientëve jashtë vendit, zbatimin e standardeve shëndetësore, hulumtimin e politikave shëndetësore, prokurimin publik, ngritje të fondeve, si dhe sigurim të pajisjeve dhe trajnimeve në fushën e shëndetësisë publike. Sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me akterët jashtë-qeveritarë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve legjislative, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim MSh ka hartuar 4 projektligje, në hartimin e të cilëve kanë qenë të përfshirë gjithsej 8 akterë të tillë (OShC dhe asociacione profesionale). Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe, MSh ka hartuar 6 dokumente politikash, në hartimin e të cilëve kanë qenë të përfshirë 10 akterë jashtë-qeveritarë dhe disa media (por nuk dihet numri i këtyre të fundit).

Ministria e Shëndetësisë ka të publikuar në ueb-faqen e saj ([www.msh-ks.org](http://www.msh-ks.org)) një numër të madh dokumentesh dhe informatash të tjera (përfshirë dokumente ligjore dhe të politikave, përkrahje të detyrave e përgjegjësi të strukturave të ndryshme në kuadër të ministrisë, informata për kontakt, udhëzime të ndryshme për sektorin e shëndetësisë, etj.). Sa u përket aktiviteteve shitesë për komunikim dhe informim publik, ky institucion nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet shitesë përtej procesit të qasjes në dokumente zyrtare dhe aspekteve të ndërlidhura me këtë. Së fundmi, Kuvendi ka dhënë listën e zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik (gjithsej tre), me kualifikime relativisht relevante, përvojë të konsiderueshme pune (nga 5 deri në 13 vjet) dhe që kanë ndjekur trajnime me kohëzgjatje nga 1 javë deri në 2 muaj në përgjithësi.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Shëndetësisë**, me **Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 73**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion **gjysmë i hapur**.

### **13. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE)**

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, MZhE gjithashtu zbaton Rregulloren

për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun dhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, por përveç referimit dispozitive që përcaktojnë funksionet e Zyrës për Komunikim Publik (ZKP), nuk është aspak e qartë përmbajtja e dispozitive që rregullojnë strukturat, resurset e obligimet specifike të kësaj ministrie për komunikim e informim publik, kurse si mekanizma e masa zbatuese është vetëm një zyrtar për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtar dhe procedura për mirëmbajtjen e ueb-faqes së këtij institucioni, por nuk është plotësisht e qartë nëse ka mekanizma e masa zbatuese për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitive kushtetuese në fjalë e as çfarë përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim. E njëjta vlen në lidhje me klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike senzitive nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar, dhe ajo e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që vetëm u janë referuar ligjeve përkatës kornizë. Në nivelin e strukturave të brendshme, organogrami i kësaj ministrie parasheh funksionimin e ZKP-së, me tre zyrtarë, por nuk është dhënë asnjë lloj shpjegimi rreth funksionimit të saj në kuadër të organogramit të Ministrisë. E njëjta vlen për Termat e Referencës (TR) së tij dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të tij (prej katër zyrtarësh), pasi që nuk është e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që vetëm dihet se ka raportim javor dhe vlerësim vjetor, por nuk është plotësisht e qartë se si kryhen këto dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh.

Në lidhje me resurset e alokuara ZKP-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane, nuk është aspak e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve, e as shuma e resurseve për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe atyre të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Në anën tjetër, MZHE ka një Plan vjetor të Komunikimit, kurse nuk është aspak e qartë se çfarë objektivash e aktiviteteve përmban ai plan. Posaçërisht të kthyer. Më tej, gjithashtu nuk është aspak e qartë çfarë masa për monitorim dhe raportim të rregullt ka dhe si zbatohen ato, përveç raportimit për zbatimin e LQDP-së. Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, MKK ka pasur komunikim të rregullt ditor me 13 media vendore (përfshirë shtypin dhe mediat elektronike), kryesisht me qëllim të informimit të publikut mbi punën e Ministrisë. Në anën tjetër, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, në punën e saj janë përfshirë gjithsej 3 OShC. Megjithatë, nuk është aspak e qartë se çfarë aktiviteteve ka pasur me këto të fundit, e as lloji i përfshirjes së tyre (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet).

Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve legjislative gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, sipas të dhënave të ofruara, MZHE nuk ka sponsorizuar ose hartuar ndonjë akt ligjor, e rrjedhimisht nuk është përfshirë asnjë akter i tillë. E njëjta vlen në lidhje me përfshirjen e këtyre akterëve në hartimin e dokumenteve të politikave gjatë kësaj periudhe. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në hartimin dhe zbatimin e kësaj strategjie, kurse në monitorimin e vlerësimit të zbatimit të këtyre lloj dokumentesh, vetëm i janë referuar shoqërisë civile, por nuk është e qartë se sa akterë të tillë janë përfshirë dhe në lidhje me cilat dokumente politikash. MZHE ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.mzhe.rks-gov.net](http://www.mzhe.rks-gov.net)) një numër të konsiderueshëm dokumentesh dhe informata të tjera (në dy gjuhët zyrtare dhe në

anglisht), kurse kjo ministri gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim nuk ka kryer asnjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i ZKP-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune të konsiderueshme (nga 5 deri në 8 vjet, ndonëse nuk dihet sa është relevante) dhe pjesëmarrje në trajnime me kohëzgjatje nga 1 deri në 4 javë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Ministria e Zhvillimit Ekonomik, me Indeksën e Transparencës Institucionale (ITI) prej 41**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## Institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive

Në vlerësimin e këtij viti janë përfshirë pesë (5) institucione të kësaj kategorie: Agjencia Kundër Korrupsionit, Dogana e Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Policia Kosovës.

Për të përmbledhur, bazuar në informatat e dhëna për qëllime të këtij vlerësimi, të pesë institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive të përfshira në këtë raund të vlerësimit, me mesataren e Indeksit të Transparencës Institucionale (ITI) prej 58.8, rezultojnë se gjatë vitit 2012 kanë qenë institucione pjesërisht të hapura.

### 14. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK)

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, AKK zbaton UA për Zbatimin e LQDP-së, Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe rregullat procedurale të saj. Këto të fundit përcaktojnë se AKK funksionon bazuar në parimin e transparencës dhe çështjet nga veprimtaria e saj i bën publike brenda suazave të përcaktuara me ligjet përkatëse. Megjithatë, nuk është e qartë përmbajtja e dispozitave të tjera që rregullojnë strukturat, resurset e obligimet specifike të këtij institucioni për komunikim e informim publik. Në anën tjetër, në lidhje me mekanizmat e masat zbatuese për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë, është e qartë se cilat dispozita përcaktojnë të drejtën për qasje në dokumente publike të këtij institucioni, por nuk është plotësisht e qartë se cilat janë të gjithë mekanizmat e masat zbatuese për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë e as çfarë përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim.

Sa i përket çështjes së klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të AKK-së nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar, kjo është e rregulluar me Ligjin për AKK-në, Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, UA për Zbatimin e LQDP-së dhe Rregullat Procedurale të AKK-së. Sipas Ligjit për AKK-në, sekret zyrtar konsiderohen të dhënat personale të individëve që janë ose kanë qenë objekt i hetimit nga AKK, të dhënat personale të raportuesve të korrupsionit, nëse një gjë e tillë kërkohet nga raportuesit, si dhe informata të tjera publikimi i të cilave mund të dëmtojë procesin e hetimeve. Megjithatë, përtej dispozitave formale ligjore, nuk është plotësisht e qartë se cilat janë masat dhe mekanizmat zbatuese dhe si funksionojnë ato. Në anën tjetër, sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, është e qartë se Rregullat Procedurale të AKK-së parashohin këtë obligim, por nuk është e qartë se cilat janë masat dhe mekanizmat zbatuese dhe si funksionojnë ato.

Në nivelin e strukturave të brendshme, Vendimi për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të AKK-së parasheh që në kuadër të saj të funksionojë Zyra për Mbështetje Profesionale dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (ZMPBN), e përbërë nga një zyrtar, e cila mbulon edhe fushën e komunikimit dhe informimit publik, por nuk janë dhënë shpjegime më të hollësishme në lidhje me funksionimin e saj në kuadër të organogramit të Agjencisë, përveç se shefi i kësaj



zyre të kryejë detyrat e zyrtarit për informim. E njëjta vlen për Termat e Referencës (TR) së tij dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të saj, pasi që nuk është e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që dihet se ka raportim mujor dhe vlerësim vjetor, por nuk është e qartë se si kryhen këto dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh. Në lidhje me resurset e alokuara ZMPBN-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (të specifikuara më sipër), nuk është aspak e qartë shuma e saktë e tyre. E njëjta vlen edhe në lidhje me shumën e resurseve për zbatimin e dokumenteve të politikave, ndërsa sa i përket shumës së resurseve të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim, dihet vetëm një vlerësim i përafërt prej rreth €10,000.

Në anën tjetër, kjo zyrë e bazon punën e saj në Planin e Punës së AKK-së, i cili si objektiv të përgjithshëm në fushën e komunikimit dhe informimit publik parashihet forcimin e transparencës dhe kultivimin e bashkëpunimit më të ngushtë në mes AKK-së dhe publikut. Në anën tjetër, aktivitetet për përmbushjen e kësaj objektiviteti kanë të bëjnë vetëm me publikimin e dokumenteve dhe informatave të AKK-së në të cilat lejohet qasja e publikut. Megjithatë, nuk është e qartë çfarë masash për monitorim dhe raportim të rregullt ka dhe si zbatohen ato. Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, AKK ka pasur komunikim të rregullt ditore me të gjitha mediat vendore që kanë pasur interesim për të ndjekur aktivitetet e saj, kryesisht me qëllim të informimit të publikut mbi punën e saj. Në anën tjetër, sipas të dhënave të tyre, gjatë kësaj periudhe në punën e saj është përfshirë vetëm një OShC, kjo e fundit në rolin e partnerit zbatues për vetëdijësimin e publikut mbi politikën kundër korrupsionit. AKK nuk ka mandat ligjor që të sponsorizojë dokumente legjislative, e rrjedhimisht nuk ka hartuar asnjë dokument të tillë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, e as nuk ka ndonjë aktor jashtë-qeveritar të përfshirë. Në anën tjetër, në nivelin e politikave, gjatë kësaj periudhe AKK ka hartuar Strategjinë dhe PV kundër Korrupsionit, në hartimin e të cilit janë përfshirë edhe mediat, OShC-të dhe asociacionet e biznesit, por megjithatë nuk është e qartë se sa ka qenë numri dhe roli i tyre në këtë proces. Së fundmi, asnjë aktor i tillë nuk është përfshirë në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të kësaj strategjie dhe PV.

AKK ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.akk-ks.org](http://www.akk-ks.org)) një numër të konsiderueshëm dokumentesh dhe informata të tjera (në dy gjuhët zyrtare dhe në anglisht), kurse sa u përket aktiviteteve shtesë për komunikim dhe informim publik, ky institucion ka publikuar një analiza mbi ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit në Kosovë gjatë vitit 2011, i cili ka kontribuar që puna e saj dhe e institucioneve të tjera relevante në luftimin e korrupsionit të pasqyrohet në mënyrë transparente dhe objektive. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i ZMPBN-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune të konsiderueshme (prej 4 vitesh, ndonëse nuk dihet sa është relevante) dhe pjesëmarrje në trajnime me kohëzgjatje prej gjithsej 2 muajsh gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Agjencia Kundër Korrupsionit, me Indeks in e Transparencës Institucionale (ITI) prej 53**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## 15. Dogana e Kosovës (DK)

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, DK gjithashtu zbaton Kodin Doganor dhe të Akcizave dhe UA mbi Procedurat e Informimit, Publikimet dhe Komunikimin në Doganë. Kodi mbulon komunikimin dhe informimin publik në kuadër të “çfarëdo çështje[je] tjetër të nevojshme për funksionimin efikas të Doganës”. Më tej, UA në fjalë përcakton mekanizmat në bazë të të cilëve mund të ofrohen informata për publikun nëpërmjet instrumenteve të jashtme dhe të brendshme komunikuese, si ueb-faqja, Zëdhënësi i Doganës, Revista informatori, etj., me qëllim që të arrihet te një publiku i interesuar dhe të informohet lidhur me legjislacionin e zbatueshëm punën e DK-së, por edhe nëpërmjet publikimit të të gjitha dispozitave që zbaton ky institucion. Në anën tjetër, përveç mekanizmave të sipërpërmendur, DK gjithashtu përcakton mekanizma për forcimin e transparencës dhe besimit publik dhe shpërndarjen e informatave të palët e interesit, ndonëse nuk kanë saktësuar për çfarë mekanizmash bëhet fjalë në ndërlidhje me këto dy qëllime të fundit.

Sa i përket çështjes së klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të DK-së nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar, UA në fjalë parasheh që të shkresat konfidenciale të jenë në pajtim me nenin 8 të LQDP-së. Shkresa të natyrës konfidenciale brenda DK-së konsiderohen të dhënat lidhur me personelin e Doganës, dosjet disiplinore, të dhënat lidhur me kompanitë dhe informatat që do të dëmtonte imazhin e kompanive, ankesat e palëve të jashtme, shkresat që hartohen në pajtim me dispozitat përkatëse të Kodit të Mirësjelljes së Oficerëve Doganorë, dokumentet që janë në proces të vendimmarrjes, informata që mund të paragjykojnë vendimet e DK-së, dhe çfarëdo dokumenti tjetër që Drejtori i Përgjithshëm, në pajtim me nenin 4 të LQDZ, e përcakton se një dokument që nuk mund t’u jepet palëve të treta. Më tej, hyrjen në fuqi të Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, DK ka përpiluar listën e dokumenteve senzitive dhe ka caktuar një zyrtar doganor përgjegjës për të siguruar zbatimin e këtij ligji. Në anën tjetër, sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, DK a ka rregulluar këtë çështje me udhëzim të brendshëm, që parasheh që çdo dokument zyrtar duhet të respektojë rregullat për përdorimin e gjuhëve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë se cilat janë masat dhe mekanizmat zbatuese dhe si funksionojnë ato.

Në nivelin e strukturave të brendshme, Zyra për Komunikim dhe informim (ZKI) e DK-së (e përbërë nga 3 zyrtarë) është e vendosur lart në hierarkinë e Doganës, në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, dhe i raporton drejtpërdrejt atij. Funkcionet e ZKI-së janë të rregulluara me UA mbi Procedurat e Informimit, Publikimet dhe Komunikimin në Doganë. Më tej, Termat e Referencës (TR) së ZKI-së përcaktojnë se kjo zyrë ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore: zbatimin e strategjisë informative dhe identifikimin e mundësive për ta ngritur imazhin e Doganës së Kosovës; dhënien e kontributit në zhvillimin e strategjisë së

promovimit të vlerave evropiane në këtë fushë, menaxhimin dhe përditësimin e rregullt të ueb-faqe së DK-së; përpilimin, botimit dhe redaktimin e informatave e dokumenteve të DK-së, duke u kujdesur që të njëjtat të përkthehen edhe në gjuhët zyrtare; organizimin e takimeve informuese me mediat; dhe monitorimin e shkrimeve të mediave lidhur me DK-në. ZKI gjithashtu posedon Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të saj, por që nuk është plotësisht e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese.

Më tej, sa i përket raportimit e vlerësimit të punës së stafit, janë në fuqi standardet përkatëse. Puna e secilit zyrtar vlerësohet çdo gjashtë muaj, kundrejt strategjive që zbatohen në këtë fushë TR-ve dhe PVP-ve. Si mekanizëm kryesor edhe matja e performancës, përmes indikatorëve të saktë. Sipas këtyre indikatorëve, vlerësimi i performancës bazohet në: (1) numrin e kërkesave për qasje në informata (të nën-ndara më tej në ato në të cilat qasja është lejuar, refuzuar, kufizuar, pa përgjigje, kur janë kërkuar shpjegime shtesë dhe arsye të tjera); (2) mënyrat e dhënies së përgjigjeve (në mënyrë elektronike, kopje të shtypur, elektronike dhe kopje, dhe CD); (3) përgjigjet e dërguara (të nën-ndara më tej në përgjigje të dërguara me afat, sipas ligjit, kërkesa të rishqyrtuara, dhe vërejtje); (4) profili i kërkuesve të informatave (gazetarë, shoqëri civile, organizata buxhetore, individë, studentë, parti politike dhe të tjera) dhe (5) llojet e dokumenteve të kërkuara (të nën-ndara më tej në buxhet dhe shpenzime, vendime, projektligje, statistika, kontrata, projekte, konkurse dhe të tjera). DK gjithashtu zbaton Blueprintin ('Modelin') e BE-së për Dogana, i cili përcakton se si duhet të funksionojnë zyrat për media brenda doganës. Ky dokument gjithashtu përcakton indikatorë të saktë për matjen e performancës për komunikim dhe informim publik (gjithsej 17 indikatorë, të ndarë në 5 kategori: të përgjithshme, rekomandimet që vlejné për informatat, informatat specifike, audiencia e synuar dhe aktivitetet konkrete për marrëdhënie me publikun). Së fundmi, DK përpilon raporte vjetore të brendshme për matjen e performancës, bazuar në kriteret e sipërpërmendura, kurse edhe projekti i Blueprint rregullisht vlerëson performancën në raport me kriteret që përcakton ky dokument. Sipas raportit të brendshëm të DK-së për vitin 2012, ajo ka pranuar gjithsej 293 kërkesa dhe në të gjitha rastet është lejuar qasja, si dhe janë adresuar me sukses 12 kërkesa për shpjegime shtesë.

Në lidhje me resurset e alokuara ZKI-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (të specifikuara më sipër), gjithashtu është e qartë se buxheti për këtë zyrë planifikohet në baza katërvjeçare (aktuali përfshin periudhën 2010 - 2013). Sipas këtij planifikimi, buxheti total për vitin 2012 ka qenë €19,000, kurse për vitin 2013 është €22,500 (i ndarë në tri nënkategori: reklama dhe konkurse, publikime, dhe shpenzime për informim publik). Së dyti, sa i përket shumës së resurseve për zbatimin e dokumenteve të politikave, është e qartë se gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim DK ka pasur resurse të mjaftueshme (të bazuar në planifikim trevjeçar). Më specifikisht, buxheti i saj për komunikim dhe informim ka lëvizur në mes të €20,000 dhe €30,000, varësisht nga projektet. Më tej, gjatë kësaj periudhe është rritur numri i stafit përgjegës për komunikim dhe informim me publikun nga një në tre zyrtarë dhe gjithashtu janë përpiluar TR dhe PVP të përditësuar, si dhe resurset humane gjithashtu janë shfrytëzuar për të punuar me udhëheqësit e degëve doganore, të cilët flasin për media apo japin deklarata lidhur me aktivitetet në rajonet e tyre. Për të

përmbledhur në lidhje me resurset për komunikim dhe informim publik, numri i stafit përbën 0,5% të numrit të përgjithshëm të stafit të institucionit dhe 0,2% të shumës së përgjithshme të buxhetit të tij.

Sa u përket dokumenteve të politikave dhe atyre planifikues, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim ZKI ka punuar bazuar në Planin për Marrëdhënie me Publikun 2011 - 2013, i cili është në pajtueshmëri me Kornizën trevjeçare të Strategjisë Operative 2011 - 2013 dhe përditësohet në fillim të çdo viti. Ky plan është i detajuar dhe përbëhet nga nëntë pjesë: qëllimet strategjike, objektivat dhe qëllimet e komunikimit, identifikimi i audiencës dhe mesazhet, pika të veçanta dhe taktika e komunikimit, trajnimi i stafit, ndryshimi i ueb-faqes, përmirësimi i imazhit, marketingu i Doganës dhe buxheti për periudhën trevjeçare që mbulon ai. Më specifikisht, ky dokument përmban një vlerësim të gjendjes aktuale sa i përket komunikimit dhe informimit të publikut dhe përcakton se shërbimet doganore ofrohen bazuar në parimet e: besimit e respektit të ndërsjellë, barazisë e drejtësisë, integritetit e ndershmërisë, transparencës e sinqeritetit, dhe mirësjelljes e përkushtimit. Më tej, qëllimet strategjike fokusohen në tri fusha kryesore: sstrategjia për biznese/klientë, strategjia e zbatimit të ligjit dhe strategjia e burimeve. Së fundmi, ka një numër të konsiderueshëm masash e aktiviteteve specifike për realizimin e objektivave dhe qëllimit të përcaktuar, e ndër më kryesoret përfshijnë shpjegimin e llojeve të taksave dhe procedurave me ndikim ekonomik; promovimin e aktiviteteve të DK-së nëpërmes paraqitjeve të rregullta në media; rritjen e nivelit të edukimit të tregtarëve; publikimin e artikujve në gazeta ditore (një herë në muaj); programe speciale që pasqyrojnë më mirë punën e institucionit; ngritjen e vetëdijes së institucioneve mbi DK-në dhe transparencën e saj; përmirësimin e komunikimit të DK-së me media; përmirësimin e transparencës ndaj publikut, në përgjithësi; promovimin e vlerave të DK-së; takime të shkurtra informuese me media; menaxhimi dhe përditësimi i rregullt i ueb-faqes; monitorimi i shkrimeve në media lidhur me DK-në; përgjigja ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike; hartimi dhe shpërndarja e broshurave të ndryshme informuese; fushata informuese (përfshirë kundër korrupsionit), etj. Së fundmi, ZKI i nënshtrohet auditimit të brendshëm me qëllimit të verifikimit nëse procedurat standarde dhe afatet kohore janë duke u respektuar, përmes së cilës gjithashtu synohet të mbahet balanca në mes të kërkesave të publikut dhe obligimeve të DK-së, si dhe gjithashtu publikohen raporte mujore që vlerësojnë të arriturat e këtij institucioni sa i përket komunikimit dhe informimit të publikut.

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, DK ka pasur komunikim të rregullt, kryesisht në baza javore dhe sipas nevojës, me rreth 20 media vendore dhe të huaja, me fokus tek redaksitë ekonomike, pasi që aty është pjesa më e madhe e palëve të interesit. Në anën tjetër, DK gjatë kësaj periudhe ka përfshirë në punën e saj të paktën 9 akterë jashtë-qeveritarë (OShC dhe asociacione të biznesit). Kjo përfshirje është fokusuar në bashkëpunim nëpërmjet shkëmbimit të informatave, ofrimit të këshillave, dërgimit të ekspertëve në konferenca të ndryshme etj., kurse çështjet specifike përfshijnë analiza ekonomike, anti-korrupsioni, Marrëveshjen CEFTA, punësim të përkohshëm të peronave me nevoja të veçanta, veprimtari humanitare, dhe nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit këto të fundit me asociacionet e biznesit).

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, DK, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ka sponsorizuar tri projektligje. Në nivelin e politikave, gjatë kësaj periudhe ka rishikuar Kornizën e Strategjisë Operative të Doganës 2011 - 2013 dhe Planin e Veprimit. Së fundmi, asnjë akter jashtë-qeveritar nuk është përfshirë në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjeve dhe dokumenteve të politikave në këtë fushë. DK ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)) një numër të konsiderueshëm dokumentesh dhe informata të tjera (në dy gjuhët zyrtare dhe në anglisht). Këto dokumente e informata përfshijnë nevojat e publikut sipas analizave paraprake dhe bazohen në përgatitjen dhe renditjen e njohurive të fituara në bazë profesionale në këtë shërbim. DK gjithashtu zbaton sistemin e ri operativ të përpunimit e të dhënave (ASYCUDA), i cili ndikon në përmirësimin e transparencës dhe efikasitetit duke u mundësuar biznese deklarimin e dokumenteve doganore nga çdo vend me qasje në internet. Sa u përket aktiviteteve shtesë për komunikim dhe informim publik, ky institucion shpesh ka publikuar dhe shpërndarë broshura, statistika e doracakë të ndryshëm, dhe ka ofruar informata të shpejta dhe të sakta me qëllim të rritjes së transparencës. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i ZKI-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relevante, përvojë pune relevante të konsiderueshme (prej 4 deri në 7 vjet) dhe pjesëmarrje në trajnime me kohëzgjatje prej gjithsej 1 deri në 2 muaj gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Dogana e Kosovës, me Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 93**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion jo plotësisht i hapur.

## **16. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)**

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, IAP zbaton edhe Ligjin për Avokatin e Popullit, i cili përcakton se ky institucion është përgjegjës, mes tjerash, që të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijes, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave; të publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; dhe të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Kosovë. Ky ligj gjithashtu përcakton procedurën e shqyrtimit të ankesave, sipas së cilës Avokati i Popullit mund të publikojë raporte të veçanta edhe përmes mediave për shkeljet e bëra nga një institucion publik, nëse ky i fundit, pas kërkesave të përsëritura nuk i është përgjigjur në mënyrë përkatëse propozimeve dhe rekomandimeve të tij. Si strukturë përgjegjëse për komunikim dhe informim publik është themeluar Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun (ZMMP), e përbërë nga një zyrtar, në pozitën e Zëdhënësit. Megjithatë, nuk është e qartë përbajtja e plotë e dispozitave të tjera që rregullojnë strukturat, resurset e obligimet specifike të këtij institucioni për komunikim e informim publik. Në anën tjetër, nuk është plotësisht e qartë se cilat janë të gjithë mekanizmat e masat zbatuese për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë e as çfarë përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim.

Sa i përket çështjes së klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të IAP-së nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar, nuk është aspak e qartë se çfarë dispozita ligjore zbaton ky institucion e as cilat janë mekanizmat e masat zbatuese. Në anën tjetër, sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, është e qartë se Ligji për Avokatin e Popullit parasheh se “gjuha e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit janë gjuhët zyrtare të parapara me Kushtetutë dhe ligj”, por nuk është e qartë se cilat janë masat dhe mekanizmat zbatuese dhe si funksionojnë ato. Në nivelin e strukturave të brendshme, organogrami i IAP-së ka parasheh ZMMP-në si pjesë përbërëse të institucionit, por nuk janë dhënë shpjegime më të hollësishme në lidhje me funksionimin e saj në kuadër të institucionit. E njëjta vlen në lidhje me Termat e Referencës (TR) së tij dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të saj, pasi që nuk është e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që dihet se ka raportim e vlerësim të punës në baza javore, mujore e vjetore, por nuk është e qartë se si kryhen këto dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh. Në lidhje me resurset e alokuara ZMMP-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (të specifikuar më sipër), nuk është aspak e qartë shumta e saktë e tyre. E njëjta vlen edhe në lidhje me shumën e resurseve për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe shumën e resurseve të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim.

Në anën tjetër, kjo zyrë punon në bazë të një plani pune, i cili përmban katër objektiva: mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut, si bërthama e misionit të IAP-së; presioni medial për të ndikuar në zgjidhjen e rasteve; ofrimi i informatave publikut siç kërkohet nga LQDP; dhe fuqizimi në publik i rolit dhe imazhit të IAP-së si mbrojtës dhe avokues i të drejtave të njeriut). Më tej, masat kryesore që ka ndërmarrë dhe ndërmerr ky institucion për përmbushjen e këtyre objektivave janë përgjigja ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike që posedon, trajtimi i ankesave në lidhje me këtë, si dhe autorizimin e zyrtarëve përgjegjës për të dyja këto masa zbatuese. Në nivelin e aktiviteteve, ky plan pune parasheh organizimin e një fushate informuese nëpër qendrat komunale, botimi i një fletëpalosjeje me informata rreth qasjes në dokumente publike, mbajtjen e tryezave të rrumbullakëta me shoqërinë civile dhe mediat që kanë trajtuar qasjen në dokumente publike. Megjithatë, nuk është e qartë çfarë masash për monitorim dhe raportim të rregullt ka dhe si zbatohen ato.

Sipas të dhënave të tij, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, IAP ka pasur komunikim të rregullt ditor me rreth 100 media të ndryshme vendore dhe të huaja, por gjithashtu ka mbajtur 11 tryeza të rrumbullakëta në prezencë të mediave, u ka dërguar mediave 60 komunikata për shtyp dhe ka publikuar tri raporte dhe dy buletine informuese mbi punën e tij, të cilat u janë dërguar të gjitha këtyre mediave. Në anën tjetër, sipas të dhënave të tyre, gjatë kësaj periudhe në punën e saj janë përfshirë 20 OShC, por megjithatë nuk është e qartë se çfarë aktiviteteve ka pasur me këto të fundit, e as lloji i përfshirjes së tyre (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet), përveç dy raporteve të publikuar në bashkëpunim me dy OShC (por nuk është e qartë me cilat). IAP nuk ka mandat ligjor që të sponsorizojë dokumente legjislativë, e rrjedhimisht nuk ka hartuar asnjë dokument të tillë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, e as nuk ka ndonjë akter jashtë-qeveritar të përfshirë. Në

anën tjetër, sipas të dhënave të ofruara, ky institucion gjatë kësaj periudhe nuk ka hartuar asnjë dokument politikash ose planifikues, e rrjedhimisht nuk pasur asnjë akter të tillë të përfshirë. E njëjta vlen në lidhje me përfshirjen e akterëve të tillë në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të këtyre lloj dokumentesh.

IAP ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org)) një numër të konsiderueshëm dokumentesh dhe informata të tjera (në dy gjuhët zyrtare dhe në anglisht), kurse IAP nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim (përveç aktiviteteve të përmendura më sipër). Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i ZMPBN-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune të konsiderueshme (prej mbi 4 vitesh, ndonëse nuk dihet sa është relevante) dhe pjesëmarrje në trajnime me kohëzgjatje prej 1 deri në 2 javë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Institucioni Avokatit të Popullit**, me **Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI)** prej 42, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i mbyllur.

## 17. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, KGJK dhe i tërë sistemi i gjykatave në vend zbatojnë edhe Ligjin mbi KGJK-në, Ligjin mbi Gjykatat, Rregulloren mbi Organizimin e KGJK-së, Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm të Gjykatave, Doracakun për Menaxhimin e Gjykatave, Rregulloren mbi Caktimin e Normave të Punës së Gjyqtarëve, Rregulloren për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, dhe UA për Zbatimin e LQDP-së. Megjithatë, nuk është e qartë përmbajtja e dispozitave specifike për komunikim dhe informim publik dhe se çfarë parimesh e rregullash vendosin ato dispozita për të siguruar zbatimin e dispozitave përkatëse kushtetuese e ligjore. Sa i përket çështjes së klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të KGJK-së nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar, përtej referimit LQDP-së nuk është aspak e qartë se çfarë dispozitash konkrete ligjore zbaton ky institucion e as cilat janë mekanizmat e masat zbatuese. E njëjta vlen sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që vetëm i janë referuar Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, por nuk është e qartë se cilat janë masat dhe mekanizmat zbatuese dhe si funksionojnë ato.

As u përket strukturave të brendshme, në nivelin qendror (në KGJK), në kuadër të Organogramit të Sekretariatit (SKGJK) është paraparë funksionimi i Zyrës për Informim dhe Protokoll (ZIP). Sa u përket mekanizmave zbatues në nivel të secilës gjykatë, Doracaku për Menaxhimin e Gjykatave përcakton rolin dhe detyrat e Koordinatorit për Informim Publik, protokollet dhe formularët për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm, qasjen e publikut në materiale informuese, dhe përgjithësisht një qasje më të koordinuar në komunikim me publikun, me synim përmirësimin e komunikimit të gjykatave me publikun. Gjithashtu janë paraparë 9

zyrtarë për informim në nivel të gjykatave: 1 në Gjykatën Supreme, 1 në Gjykatën e Apelit dhe 7 nëpër Gjykata Themelore. Megjithatë, sipas të dhënave të paraqitura nga KGJK, nuk është e qartë nëse këta mekanizma janë funksionalizuar dhe çfarë masash zbatuese janë në fuqi, për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë e as çfarë përcakton legjislacioni zbatues në këtë drejtim. Sa u përket Termave të Referencës (TR) së ZIP-së së SKGJK-së, sipas të dhënave të këtij institucioni, ato akoma nuk janë miratuar. Në anën tjetër, Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) të stafit të saj janë përcaktuar me Rregulloren e KGJK-së për Përshkrimin e Detyrave të Punës. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që vetëm i janë referuar Ligjit për Shërbimin Civil, i cili rregullon çështjen e vlerësimit dhe rezultateve në punë, por megjithatë nuk është e qartë se si kryhen këto dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh. Në lidhje me resurset e alokuara ZPI-së gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, përveç resurseve humane (të specifikuara më sipër), nuk është aspak e qartë shuma e saktë e tyre, përveç se është thënë se janë të pamjaftueshme. E njëjta vlen edhe në lidhje me shumën e resurseve për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe shumën e resurseve të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim.

Në anën tjetër, aktualisht nuk ka ndonjë dokument politikash në bazë të të cilit funksionon kjo zyrë, por është në hartim e sipër Planit Strategjik për Gjyqësorin e Kosovës 2013 - 2018, i cili pritet të përcaktojë mekanizma të veçantë në komunikim me publikun, si zhvillimi i aftësive për informim publik në SKGJK dhe gjykata, zhvillimi i planit për sigurimin e informatave të rregullta e të sakta për publikun në lidhje me punën dhe përmbushjen e detyrave nga ana e sistemit gjyqësor, dhe zhvillimi i një ueb-faqeje për tërë gjyqësorin e vendit, për të lehtësuar shpërndarjen e informatave të nevojshme. Gjithashtu pritet të hartohet një Strategji e KGJK-së për Marrëdhënie me Publikun. Më tej, bazuar në vizionin për “një sistem gjyqësor të pavarur, me qasje për të gjithë, i drejtë dhe efikas në funksionimin e tij, përgjegjës në përmbushjen e detyrave dhe funksionim sipas standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës”, parashihen një varg masash zbatuese dhe aktiviteteve në nivel të gjykatave, si publikimi i broshurave, përpilimi i formularëve për t’i ndihmuar në parashkrimin e kërkesave më të shpeshta në gjykatë dhe vendosja e tyre në hapësira publike. Në anën tjetër, masat zbatuese të parapara në nivel të KGJK-së përfshijnë publikimin e orareve të seanceve, komunikimeve të gjykatës dhe listave të përditësuara të stafit dhe të gjyqtarëve; mirëmbajtjen e publikimeve të gjykatave, broshurave, formularëve në numër të mjaftueshëm dhe të disponueshme për publikun; publikimin e raporteve statistikore dhe të dhënave të tjera numerike për të prezantuar punën e sistemit gjyqësor (posaçërisht në lidhje me zvogëlimin e numrit të lëndëve të grumbulluara); shpalljen e vendeve të lira të punës dhe dhënien e informatave shtesë dhe formularëve për aplikim publikut; koordinimin e aktiviteteve rreth ngritjes së vetëdijes së publikut dhe aktiviteteve tjera të jashtme; udhëzimin e publikut, në veçanti të palëve, në lidhje me shërbimet e procedurat gjyqësore dhe statusin e lëndëve; si dhe publikimin e vendimeve të Kolegjiumit dhe konkluzioneve të tjera relevante. Megjithatë, nuk është e qartë çfarë masash për monitorim dhe raportim të rregullt ka dhe si zbatohen ato.



Sipas të dhënave të KGJK-së, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, KGJK ka pasur komunikim të rregullt me të gjitha mediat vendore të interesuara në punën e tij dhe të sistemit gjyqësor në përgjithësi, dhe atë në dy mënyra: me iniciativë të zyrtarëve për informim, me qëllim të shpërndarjes së informatave, dhe sipas kërkesës së mediave, në parim duke pasur parasysh konfidencialitetin e institucionit. Në anën tjetër, sipas të dhënave të tyre, gjatë kësaj periudhe në punën e KGJK-së janë përfshirë 7 OShC, kryesisht sipas kërkesave të këtyre të fundit dhe me aktivitete të fokusuara në statistikat e gjyqësorit. Megjithatë, nuk është e qartë se për çfarë lloji të saktë të përfshirjes së tyre (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet) bëhet fjalë. KGJK nuk ka mandat ligjor që të sponsorizojë dokumente legislative, e rrjedhimisht nuk ka hartuar asnjë dokument të tillë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, e as nuk ka ndonjë akter jashtë-qeveritar të përfshirë. Në nivelin e dokumenteve të politikave, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim KGJK ka hartuar një Strategji për Teknologji Informative dhe Komunikim, por në hartimin e saj nuk është përfshirë asnjë akter i tillë. E njëjta vlen në lidhje me përfshirjen e akterëve të tillë në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimit të zbatimit të këtyre lloj dokumentesh. KGJK ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org)) një numër të konsiderueshëm dokumentesh dhe informata të tjera (në dy gjuhët zyrtare dhe në anglisht), por nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim (përveç aktiviteteve të sipërpërmendura). Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i ZMPBN-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune të konsiderueshme (prej rreth 18 vitesh, ndonëse nuk dihet sa është relevante), por asnjë trajnim të ndjekur gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**, me Indeksën e Transparencës Institucionale (ITI) prej 49, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion i **mbyllur**.

## **18. Policia e Kosovës (PK)**

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, PK gjithashtu zbaton Ligin për Policinë, dhe Parimet dhe Procedurat e PK-së. Ligji përcakton se transparenca, respektivisht ofrimi i informatave për qytetarët dhe të qenit të hapur ndaj publikut, është njëri nga pesë parimet udhëzuese të punës së saj. Në anën tjetër, Parimet dhe Procedurat përcaktojnë se ky institucion, drejtpërdrejt apo përmes mediave, informon opinionin publik për çështjet që i trajton, përveç nëse kjo do të ishte në dëm të punës së saj apo interesave legjitime të të tjerëve. Në praktikë, PK i mundëson publikut që të ketë qasje në informata dhe të dhëna mbi veprimtarinë e saj dhe njeh të drejtën e mediave për të raportuar në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me opinionin si dhe publikimin e informatave, deri në kufijtë ku nuk cenohet e drejta e individit, nuk pengohet ndjekja dhe hetimi i kryerësit të veprës inkriminuese. PK gjithashtu bashkëpunon me mjetet e informimit publik për çështjet që janë me interes të përgjithshëm shoqëror, gjë që ndikon në ngritjen e prestigjit, autoritetit dhe besueshmërisë në punën e saj. Më konkretisht, në nivelin e mekanizmave e masave zbatuese, PK

informon opinionin për veprat penale që janë kryer, aksidentet në komunikacion si dhe për incidentet tjera, nëpërmjet konferencave për media, lëshimit të komunikatave për shtyp dhe komunikimin e drejtpërdrejtë me mediat. Megjithatë, nuk plotësisht e qartë se si saktësisht zbatohen këta dhe mekanizma e masa të tjera zbatuese për të siguruar zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik.

Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të PK-së nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar, është e qartë se PK ka miratuar një vendim që rregullon këtë çështje dhe i cili përcakton rregulla standarde të klasifikimit të dokumenteve zyrtare dhe kodeve administrative që aplikohen në shkresat zyrtare të hartuara nga nivelet organizative të PK-së. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë se çfarë dispozitash konkrete ligjore zbaton ky institucion e as cilat janë mekanizmat e masat zbatuese. Në anën tjetër, sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, sipas të dhënave të ofruara, ky institucion zbaton dispozitat kushtetuese, por nuk është e qartë se cilat janë masat dhe mekanizmat zbatuese dhe si funksionojnë ato.

Sa u përket strukturave të brendshme, organogrami i PK-së parashih funksionimin e Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP), në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të saj, PK-së dhe në nivelin e secilës Drejtorie Rajonale (shtatë prej tyre). Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë përmbajtja e plotë e dispozitave të tjera që rregullojnë strukturat, resurset e obligimet specifike të PK-së për komunikim e informim publik. E njëjta vlen në lidhje me mekanizmat e masat zbatuese për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave kushtetuese në fjalë e as çfarë përcakton legjislati zbatues në këtë drejtim. Më tej, sa u përket Termave të Referencës (TR) së ZIMP-së, është e qartë se kompetencat e saj përcaktohen nga Parimet dhe Procedurat e PK-së (specifikisht parimi 3.15), por megjithatë nuk është plotësisht e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që është e qartë se Ligji i Policisë, udhëzimet administrative dhe parimet e procedurat e PK-së rregullojnë standardet e monitorimit të brendshëm dhe vlerësimit të punës, i cili realizohet rregullisht (në baza periodike dhe vjetore), por megjithatë nuk është e qartë se si kryhen këto dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh.

Në lidhje me resurset e alokuara ZIMP-ve gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, dihet se i janë ka pasur resurse të mjaftueshme njerëzore (me dy zyrtarë të shtesë të rekrutuar), gjë që ka përmbushur të gjitha kërkesat për resurse humane. Në Policinë e Kosovës funksionojnë shtatë zyra për informim (gjashtë janë në nivelin e drejtorive rajonale dhe një në drejtorinë e përgjithshme). Në total, të shtatë ZIMP-të kanë të punësuar 11 zyrtarë policorë dhe 10 zyrtarë civilë (pra gjithsej 21 prej tyre). Gjithashtu ato posedojnë pajisje teknike, përfshirë programe specifike për komunikim. Megjithatë, përveç resurseve humane, nuk është aspak e qartë shumica e saktë e kategorive të tjera të tyre. E njëjta vlen edhe në lidhje me shumën e resurseve për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe shumën e resurseve të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim.

Në anën tjetër, puna e PK-së në fushën e komunikimit dhe informimit publik bazohet në një një Strategji dhe Plan të Veprimit për Komunikim 2013 - 2015 të

MPB-së (i cili dokument nuk është e qartë nëse është miratuar dhe ka filluar së zbatuari). Ky dokument përmban një objektiv strategjik dhe gjashtë objektiva specifike. Në nivelin strategjik, synohet ngritja e mbështetjes dhe e besueshmërisë së qytetarëve në punën e MPB-së përmes fuqizimit të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Në anën tjetër, objektivat specifike synojnë: (1) vënien në funksion të zyrave për informim në ato agjenci ku ka nevojë për komunikim me publikun; (2) aftësimin profesional të zyrtarëve për informim; (3) strukturimin e komunikimit të brendshëm, me qëllim të informimit më efikas të publikut; (4) ofrimin e qasjes së shpejtë dhe efikase në informatat me interes për publikun; (5) thellimin e komunikimit me qytetarët, për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie; dhe (6) realizimin e aktiviteteve në procesin e integritit evropian, e që ndërlidhen me fushën e marrëdhënieve me publikun. Sa u përket masave konkrete për arritjen e këtyre objektivave, përveç caktimit të një zyrtari përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe raportimit të rregullt për këtë qëllim, nuk është e qartë çfarë masash për monitorim dhe raportim të rregullt ka dhe si zbatohen ato. Në nivelin e aktiviteteve, nuk është aspak e qartë çfarë aktiviteteve janë planifikuar, e as çfarë masash e mekanizmash janë vendosur për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të tyre.

Sipas të dhënave të PK-së, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, PK ka pasur komunikim të rregullt me të gjitha mediat vendore të interesuara në punën e saj. Në anën tjetër, sipas të dhënave të tyre, gjatë kësaj periudhe në punën e PK-së janë përfshirë mbi 30 OShC, por megjithatë, nuk është e qartë se për çfarë lloji të saktë të përfshirjes së tyre (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet) bëhet fjalë. Vet PK nuk ka mandat ligjor që të sponsorizojë dokumente legjislative, por në kuadër të rishikimit të Ligjit të Policisë (të sponsorizuar nga MPB), të kryer gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, në hartimin e tij nuk është përfshirë asnjë akter jashtë-qeveritar. E njëjta vlen edhe për dokumentet e politikave, pasi që asnjë akter i tillë nuk është përfshirë në hartimin e Planit Zhvillimor Strategjik dhe të 12 dokumenteve të tjera të politikave në kuadër të fushëveprimit të PK-së, të cilët janë hartuar gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim (nën udhëheqjen e MPB-së). E njëjta vlen në lidhje me përfshirjen e akterëve të tillë në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të këtyre lloj dokumentesh.

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, PK ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.kosovopolice.com](http://www.kosovopolice.com)) 285 dokumente të ndryshme, dhjetëra dosje të formatit video dhe audio duke përfshirë edhe spote për fushata të ndryshme mediave, fotografi të personave të shpallur në kërkim, si dhe mbi 1,500 komunikata dhe njoftime për media. Pothuajse të gjitha janë publikuar në shqip dhe serbisht, e një pjesë e tyre edhe në anglisht. Në lidhje me aktivitetet shtesë për komunikim dhe informim publik, përveç atyre të sipërpërmendur, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim PK është fokusuar në njoftimin e të gjitha stacioneve policore dhe drejtorive rajonale për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave për qasje në dokumente zyrtare. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i ZMPBN-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune të konsiderueshme (prej 9 deri në 12 vjet), dhe pjesëmarrje në trajnime prej gjithsej 1 deri në 6 muaj gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Policia e Kosovës**, me **Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 57**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë institucion pjesërisht i hapur.

## Ndërmarrjet publike

Nga tri (3) ndërmarrjet publike të nivelit qendror të kontaktuara për qëllim të këtij vlerësimi (ANP, KEK dhe PTK), vetëm PTK i është përgjigjur kërkesës për informata në kuadër të këtij vlerësimi.

### 19. Posta dhe Telekomimi i Kosovës (PTK)

Për zbatimin e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përveç LQDP-së, PTK gjithashtu zbaton Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike, të cilat përcaktojnë bazat e funksionimit të korporatës, si dhe obligimet e saj për komunikim dhe informim publik. Gjithashtu zbatohen disa udhëzime dhe vendime të posaçme, por nuk është plotësisht e qartë për çfarë aktesh të tilla nënligjore bëhet fjalë, e as përmbajtja e dispozitave të tyre. Gjithashtu është e qartë se ka bazë ligjore për funksionimin e Departamentit për Komunikim dhe Informim me Publikun (DKIP), struktura e të cilit është e përcaktuar me aktet dhe rregullore të brendshme. Sipas të dhënave të ofruara, ky departament merret vetëm me dimensionin e qasjes në dokumente publike të kësaj NP-je. Më tej, sipas të dhënave të PTK-së, aktet nënligjore të saj parashohin që të gjitha kërkesat të përpunohen konform afateve ligjore, në mbrojtje të interesit të saj dhe të sigurojnë që puna e saj të zhvillohet në përputhje me standardet më të larta të transparencës së institucioneve publike. Përveç DKIP-së, masa të tjera përfshijnë raportimin dhe kufizimet përkatëse, ueb-faqen, buletin informues të Korporatës, dhe komunikimin e brendshëm dhe me publikun. Megjithatë, nuk është e qartë përmbajtja e dispozitave për komunikim dhe informim publik. Gjithashtu nuk është plotësisht e qartë se cilat janë të gjitha mekanizmat e masat zbatuese për të siguruar zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik. Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të PTK-së nga ato në të cilat qasja e publikut është e lejuar dhe përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, nuk është aspak e qartë as çfarë rregulla ligjore e procedurale janë vendosur e as mekanizmat e masat zbatuese.

Sa u përket strukturave të brendshme, organogrami i PTK-së parashihet funksionimin e DKIP-së, në kuadër të Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv. Ai është në shërbim të çdo njësie biznesi në kuadër të PTK-së, me qëllim të promovimit dhe komunikimit të rezultateve të punës së tyre, dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv të Korporatës. Më tej, sa u përket Termave të Referencës (TR) së DKIP-së dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) së stafit të tij, ato janë vënë në fuqi, por megjithatë nuk është plotësisht e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese përveç raportimit Menaxherit për Informim. Ngjashëm është gjendja sa i përket raportimit e vlerësimit të punës, pasi që vetëm është thënë se kryhet çdo gjashtë muaj, por nuk është plotësisht e qartë se si kryhen këto dhe në bazë të çfarë standardesh, kriteresh e procesesh. Në lidhje me resurset e alokuara DKIP-ve gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, dihet numri i të punësuarve (gjithsej 8), por nuk është aspak e qartë shumica e kategorive të tjera të resurseve të alokuara. E njëjta vlen edhe në lidhje me shumën e resurseve për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe shumën e resurseve të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim.

Në anën tjetër, PTK ka hartuar Planin e Biznesit 2010 - 2015 gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, por asnjë akter jashtë-qeveritar nuk është përfshirë në hartimin e tij. Sa i përket monitorim dhe raportimit të rregullt për zbatimin e dokumenteve të tilla për komunikim dhe informim publik, përveç auditimit të brendshëm nuk është e qartë si çfarë mekanizmesh e masash të tjera janë vendosur dhe si zbatohen ato. Në nivelin e aktiviteteve, nuk është aspak e qartë çfarë aktivitete janë planifikuar, e as çfarë masash e mekanizmesh janë vendosur për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Sipas të dhënave të PTK-së, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, PTK ka pasur komunikim të rregullt me rreth 20 media të interesuara në punën e saj. Në anën tjetër, sipas të dhënave të tyre, gjatë kësaj periudhe në punën e PTK-së janë përfshirë gjithsej 5 akterë jashtë-qeveritarë (OShC dhe asociacione të biznesit), por megjithatë, nuk është e qartë se për çfarë lloji të saktë të përfshirjes së tyre (përgjatë linjës shkëmbim informatash - konsultim - bashkëpunim - partneritet) bëhet fjalë. E njëjta vlen në lidhje me përfshirjen e akterëve të tillë në monitorimin e vlerësimin e zbatimit të këtyre lloj dokumentesh.

Gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim (kur PTK ka qenë në proces të privatizimit), ajo ka publikuar në ueb-faqen e saj ([www.ptkonline.com](http://www.ptkonline.com)) rreth 1,000 dokumente, përfshirë vjetarin dhe buletinin e saj, tenderë të ndryshëm, mundësi punësimi, etj. Në lidhje me aktivitetet shtesë për komunikim dhe informim publik, sipas të dhënave të ofruara, PTK nuk ka mbajtur asnjë aktivitet të tillë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. Së fundmi, sa u përket kualifikimeve, përvojës dhe trajnimeve relevante të ndjekura nga stafi i DKIP-së, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune të konsiderueshme (deri në 14 vjet), dhe asnjë trajnim të ndjekur gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij vlerësimi, **Posta dhe Telekom i Kosovës**, me **Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 47**, rezulton se gjatë vitit 2012 ka qenë ndërmarrje publike e mbyllur.

## Përfundime dhe rekomandime

Bazuar në informatat e ofruara nga institucionet dhe ndërmarrjet publike të nivelit qendror të përfshira në vlerësimin e këtij viti, ky raport tregon se ndonëse janë shënuar përparime në kompletimin e mëtejshëm të legjislacionit kornizë dhe atij zbatues për komunikim dhe informim publik, akoma mungon një koherencë e plotë dhe gjithëpërfshirëse rreth asaj se çfarë aktesh konkrete të legjislacionit janë në fuqi dhe duhet të zbatohen. Në këtë kontekst, gjithashtu ka paqartësi rreth asaj se çfarë masash e mekanizmash konkrete të zbatimit janë përcaktuar përmes këtij legjislacioni. Paqartësitë e këtij lloji janë edhe pasojë e të kuptuarit të ndryshëm të natyrës dhe fushëveprimit të legjislacionit dhe të politikave për komunikim dhe informim publik, si dhe interpretimit të ndryshëm të tyre nga ana e strukturave institucionale përgjegjëse për komunikim dhe informim publik.

Sa i përket fushëveprimit të politikave për komunikim dhe informim publik në kuadër të institucioneve dhe NP-ve të veçanta, duket se shumicës dërrmuese të strukturave të tyre përgjegjëse për komunikim dhe informim publik u mungon një qasje horizontale dhe e ndërthurur, e bazuar në sektorë, e kësaj fushe politikash. Rrjedhimisht, këto politika vazhdojnë të konceptohen thjesht si të tilla që të mundësojnë qasjen e publikut në dokumente publike. Më konkretisht, këto politika nuk kanë si pjesë të tyre esenciale përfshirjen e akterëve të ndryshëm në zhvillimin, zbatimin, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit dhe të politikave në të gjithë sektorët dhe fushat specifike që janë pjesë e funksionit të një institucioni dhe NP specifike.

Nga ana tjetër, kjo kërkon që akterët jashtë-qeveritarë të përfaqësojnë në formë të organizuar dhe të përnjëmendtë nevojat dhe interesat e kategorive të ndryshme të qytetarëve. Në lidhje me këtë të fundit, akoma mungon një ndërlidhje e qartë në mes të fushëveprimit të akterëve jashtë-qeveritarë dhe secilës fushë të veçanta të politikave në kuadër të fushëveprimit të secilit institucion publik. Prandaj shumica e strukturave përgjegjëse për komunikim dhe informim publik në kuadër të institucioneve përballen me vështirësi në kuptimin e ushtrimit të një roli më proaktiv në përmirësimin e përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të legjislacionit dhe politikave në të gjithë sektorët. Këto vështirësi reflektohen më pas në të gjitha nivelet dhe aspektet e zbatimit të politikave për komunikim dhe informim publik, të cilat duhet të përdoren nga institucionet dhe ndërmarrjet publike jo vetëm si mjet për ofrimin e informatave publikut mbi aktivitetet e tyre, por të kenë si synim orientues përmirësimin e vazhdueshëm dhe substancial të transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Bazuar në këto dhe mangësi të tjera të identifikuara në kuadër të këtij vlerësimi të zbatimit të politikave të komunikimit dhe informimit publik, ky raport jep disa rekomandime për institucionet dhe ndërmarrjet publike të nivelit qendror.

Së pari, rekomandohet që institucionet qendrore të ndërmarrin përpjekje të përbashkëta në përkufizimin e saktë të natyrës dhe fushëveprimit të politikave për komunikim dhe informim publik. Ky përkufizim duhet të marrë parasysh jo thjesht qasjen e qytetarëve në dokumente publike, por edhe aspekte të nevojshme për përfshirjen efektive të akterëve jashtë-qeveritarë, që

përfaqësojnë interesat e qytetarëve, në tërë ciklin e politikave publike, monitorimin e performancës së institucioneve, informimin mbi resurseve që u alokohen e shpenzohen, e kështu me radhë).

Së dyti, bazuar në këtë përkufizim uniform, secili institucion duhet të qartësojë, në nivel operativ, grupet kryesore të synuara të qytetarëve të cilëve është i obliguar t'u ofrojë shërbime dhe të mira të tjera.

Së treti, bazuar në një vlerësim të përafërt të nevojave të grupeve të synuara dhe nivelit të zhvillimit të politikave në të gjithë sektorët dhe fushat që bien në kuadër të fushëveprimit të institucionit përkatës, secila strukturë në kuadër të tyre ka nevojë të zhvillojë misionin, vizionin dhe objektivat e saj sa i përket komunikimit dhe informimit publik.

Së katërti, bazuar në nevojat dhe interesat e grupeve të synuara, si dhe në misionin, vizionin dhe objektivat kyçe të komunikimit dhe informimit publik, si dhe në legjislacionin kornizë dhe atë zbatues, secili institucion duhet të përshtatë Termat e Referencës dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës së strukturave dhe zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik, në mënyrë që të jenë në harmoni dhe të ndihmojnë në realizimin e vizionit, misionit dhe objektivave kyçe të identifikuara nga secili institucion për komunikim dhe informim publik.

Së pesti, bazuar në natyrën e politikave të cilat secili institucion është i mandatuara t'i zbatojë, si dhe në natyrën, kapacitetet dhe ekspertizën e akterëve jashtë-qeveritarë (në veçanti OShC-ve), secili institucion duhet ta ketë të qartë ndërlidhjen e secilit prej këtyre akterëve me secilin sektor dhe fushë të politikave në kuadër të fushëveprimit të tij (përfshirë ndërlidhjen e këtyre akterëve me proceset konkrete të zhvillimit dhe zbatimit të tërë legjislacionit dhe politikave përgjatë tërë ciklit specifik).

Së pesti, ka nevojë të kryhet një analizë e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse e legjislacionit në fuqi për komunikim dhe informim publik dhe e zbatimit të tij. Një analizë e tillë duhet të përfshijë tërë legjislacionin kornizë dhe atë zbatues relevant dhe të fokusohet në zbatimin e deritanishëm të këtij legjislacioni dhe zbatueshmërinë e tij, por gjithashtu në identifikimin e mospërputhjeve të mundshme, përmirësimin e cilësisë së legjislacionit zbatues dhe të politikave për komunikim dhe informim publik, si dhe përmes këtij procesi të përmirësohet të kuptuarit dhe kapacitetet e zyrtarëve përgjegjës që merren me këtë fushë politikash.

Së gjashti, ka nevojë të kryhet një analizë e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse e politikave në fuqi për komunikim dhe informim publik dhe e zbatimit të tyre. Një analizë e tillë duhet të përfshijë të gjitha dokumentet ekzistuese të politikave për komunikim dhe informim publik në nivelin qendror, si dhe aspektet e komunikimit dhe informimit publik në kuadër të të gjitha dokumenteve të politikave të sektorëve të ndryshëm. Ngjashëm më të mësipërmen, kjo do të ndihmonte në identifikimin e vështirësive në zbatimin e këtyre politikave dhe të mospërputhjeve e duplifikimeve të mundshme, përmirësimin e cilësisë së politikave e mekanizmave e masave zbatuese për komunikim dhe informim publik



dhe përmirësimin e të kuptuarit dhe ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës që merren me këtë fushë politikash.

Së fundmi, por jo me më pak rëndësi, nevojitet zhvillimi i një baze të dhënash të legjislacionit dhe politikave për komunikim dhe informim publik. Ky lloj instrumenti do të bënte një lidhje logjike hierarkike dhe funksionale në mes të legjislacionit dhe politikave të të gjitha niveleve dhe sektorëve që janë në kuadër të fushëveprimit të të gjitha institucioneve të nivelit qendror. Si i tillë, ai do të ndihmonte në qartësimin e fushëveprimit të politikave për komunikim dhe informim, identifikimin e masave dhe mekanizmave zbatues, si dhe gjithashtu në përmirësimin e të kuptuarit dhe ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës që merren me këtë fushë politikash.

## Shtojca 1: Indeksi i Transparencës së Institucioneve dhe Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012 - pasqyrë e hollësishme

### Kuvendi i Republikës së Kosovës

1. Baza ligjore e përcaktuar nga akti nënligjor që rregullon funksionimin e institucionit	4 / 4
2. Strukturat, resurset dhe obligimet e përcaktuara nga akti nënligjor që rregullon funksionimin e institucionit	2 / 4
3. Mekanizmat dhe masat zbatuese të përcaktuara nga akti nënligjor që rregullon funksionimin e institucionit	3 / 4
4. Klasifikimi dhe seleksionimi i dokumenteve zyrtare (përfshirë mekanizmat e masat zbatuese)	2 / 4
5. Përdorimi i gjuhëve zyrtare (përfshirë mekanizmat e masat zbatuese)	2 / 4
6. Struktura organizative / organogrami	3 / 4
7. Termat e Referencës	2 / 4
8. Përshkrimet e vendeve të punës	2 / 4
9. Standardet e raportimit, monitorimit dhe vlerësimit të punës	1 / 4
10. Resurset njerëzore, financiare dhe teknike të alokuara gjatë periudhës së mbuluar	1 / 4
11. Dokumentet e politikave për komunikim dhe informim publik (përfshirë objektivat, si dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të tyre)	2 / 4
14. Resurset e alokuara për zbatimin e dokumenteve të politikave për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës së mbuluar	1 / 4
15. Komunikimi i drejtpërdrejtë e i rregullt me mediat dhe OSHC-të gjatë periudhës së mbuluar	2 / 4
16. Mediat me të cilat është komunikuar rregullisht gjatë periudhës së mbuluar, dhe llojet e aktiviteteve	4 / 4
17. OSHC-të e përfshira në punën e institucionit gjatë periudhës së mbuluar, dhe llojet e aktiviteteve	2 / 4
18. Përfshirja e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit gjatë periudhës së mbuluar	4 / 4
19. Përfshirja e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të politikave gjatë periudhës së mbuluar	2 / 4
20. Përfshirja e akterëve jashtë-qeveritarë në zbatimin e dokumenteve të politikave gjatë periudhës së mbuluar	2 / 4
21. Përfshirja e akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve të politikave gjatë periudhës së mbuluar	1 / 4
22. Ueb-faqja zyrtare dhe përmbajtja e saj	4 / 4
23. Resurset e alokuara për komunikim dhe informim publik për periudhën njëvjeçare në vijim për komunikim dhe informim publik	1 / 4
24. Aktivitetet shtesë për komunikim dhe informim publik të ndërmarra gjatë periudhës së mbuluar	0 / 4
25. Kualifikimet e stafit përgjegjës për komunikim dhe informim publik	3 / 4
<b>Gjithsej</b>	<b>47 / 100</b>

# Vlerësimi i transparencës së Komunave

## Hyrje

Ky vlerësim është i dyti me radhë i këtij lloji që fokusohet në Komuna. Sikur studimi i mëparshëm, ai synon të vlerësojë punën e Komunave në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe të aspekteve të tjera të komunikimit dhe informimit publik gjatë periudhës janar - dhjetor 2012. Sikur vlerësimet e kaluara, edhe ky është i bazuar në mbledhjen e të dhënave nga secila Komunë, përmes një pyetësi të strukturuar, të përbërë nga 25 komponentë: 24 pyetje dhe një tabelë. Ky vlerësim fokusohet në këto çështje specifike në nivelin komunal: kornizën ligjore dhe rregullative për komunikim dhe informim publik, kornizën e politikave për komunikim dhe informim publik, kornizën institucionale/organizative për komunikim dhe informim publik, kapacitetet institucionale për zbatim në fushën e komunikimit dhe informimit publik, dhe çështjet e zbatimit në praktikë.<sup>6</sup>

Përmes këtij pyetësi është bërë mbledhja e informatave dhe të dhënave kuantitative dhe kualitative mbi secilën çështje. Pyetësit u janë dërguar Drejtorëve të Administratës dhe zyrtarëve komunalë përgjegjës për marrëdhënie me publikun, kurse Kryetarët e Komunës gjithashtu kanë qenë të informuar. Prandaj këta zyrtarë janë përgjegjës për të gjitha gjetjet që përmban ky raport. Në hyrje të pyetësit respondentët janë udhëzuar hollësisht dhe të saktësisht mbi mënyrën e plotësimit të pyetësit dhe llojin e informatave të kërkuara për të mundësuar një vlerësim sa më të saktë dhe gjithëpërfshirës. Ndonëse pyetësi për këtë vlerësim u është dërguar 32 Komunave<sup>7</sup>, kërkesës për t'u përfshirë në këtë vlerësim të radhës i janë përgjigjur vetëm 17 prej tyre, përkatësisht Komunitat e Drenasit, Ferizajt, Graçanicës, Gjakovës, Hanit të Elezit, Istogut, Kamenicës, Klinës, Kllokotit, Mitrovicës, Novobërdës, Pejës, Podujevës, Prizrenit, Shtimes, Skënderajt dhe Vushtrrisë. Pyetësi u është dërguar atyre në janar 2013 dhe kanë pasur kohë që të përgjigjen deri në fund të marsit 2013.

## Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për qasje në dokumente publike

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 41, përcakton se “Secili person gëzon të drejtën për qasje në dokumentet zyrtare.” Më tej, ajo përcakton se “Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, përveç informatave që janë të kufizuara me ligj për shkak të privatësisë, sekreteve biznesore tregtare ose klasifikimit të sigurisë.”<sup>8</sup> Përmes kësaj, Kushtetuta krijon të drejta dhe detyrime. Nga njëra anë, ajo qytetarëve u jep të drejtën për qasje pa pagesë dhe të papenguar në dokumentet e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë

<sup>6</sup> Për një përshkrim të hollësishtëm të secilit komponent, shih raportin paraprak, në dispozicion në [http://levizjafol.org/images/uploads/files/Transparenca\\_e\\_Komunave\\_2012\\_Raport\\_FINAL.pdf](http://levizjafol.org/images/uploads/files/Transparenca_e_Komunave_2012_Raport_FINAL.pdf)

<sup>7</sup> Komunitat e kontaktuara janë ato të Deçanit, Dragashit, Ferizajt, Fushë-Kosovës, Gjakovës, Gjilanit, Glogocit, Graçanicës, Hanit të Elezit, Istogut, Junikut, Kamenicës, Kaçanikut, Klinës, Kllokotit, Lipjanit, Malishevës, Mitrovicës, Novobërdës, Obiliqit, Podujevës, Pejës, Prishtinës, Prizrenit, Rahovecit, Ranillugut, Shtërpçës, Shtimes, Skënderajt, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë.

<sup>8</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 41, në dispozicion në [http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta\\_sh.pdf](http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf)

lokal. Nga ana tjetër, ajo i detyron institucionet publike që të krijojnë të gjitha mekanizmat dhe infrastrukturën mbështetëse, si dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kësaj të drejte, duke filluar nga zberthimi i detyrimeve specifike të tyre përmes legjislationit zbatues, e cili duhet më pastaj të pasqyrohet dhe të zbatohet në kuadër të kornizës së politikave të secilit institucion. Kushtetuta gjithashtu përcakton se kjo e drejtë mund të kufizohet në rastet kur qasja në informatat që përmbajnë dokumentet e caktuara shkel privatësinë, ose kur këto informata paraqesin sekrete biznesore ose duhet të klasifikohen për arsye të sigurisë publike. Më tej, aty përcaktohet se këto kufizime duhet të përcaktohen më në hollësi me ligj.

E ky ligj është Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP). Ky ligj përcakton se zbatimi i tij synon që t'i "[...]garanto[jë] të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike."<sup>9</sup> Ai gjithashtu vendos parimet, kushtet e kufizimet për qasje në dokumente publike dhe rregullat për ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte. Më tej, sa u përket specifikisht Komunave, neni 123(4) i Kushtetutës përcakton se "Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.", kurse neni 124(1) përcakton se "Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale." Së treti, Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale<sup>10</sup>, në nenin 68, përcakton parimet themelore dhe obligimet e Komunave sa i përket transparencës, informimit e konsultimit të publikut dhe sigurimit të pjesëmarrjes së publikut në vetëqeverisje lokale. Pa hyrë në hollësi të mëtejshme mbi mënyrat dhe procedurat e qasjes në dokumente publike, me rëndësi parësore është zbatimi i këtyre obligimeve në mënyrë të efektshme nga ana e institucioneve publike. Kjo i obligon ato që të vendosin dhe vënë në funksion tërë infrastrukturën e nevojshme ligjore e institucionale dhe kapacitetet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.

Sa u përket akteve nënligjore për zbatimin e LQDP, ky ligj e obligon Qeverinë që brenda tre muajsh pas hyrjes së tij në fuqi të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e tij<sup>11</sup>, por megjithatë nuk specifikon as fushëveprimin e as numrin e këtyre akteve. Baza ligjore zbatuese duhet në veçanti të përcaktojnë strukturat, resurset dhe obligimet përkatëse specifike brenda secilit institucion për komunikim dhe informim publik, si dhe mekanizmat e masat zbatuese për të arritur këtë, përfshirë çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga dokumentet publike në të cilat gëzohet e drejta për qasje. Për të përmbushur obligimet përkatëse në kuadër të strukturave e mekanizmave zbatues, secili institucion nevojitet të vendosë infrastrukturën rregullative e teknike përkatëse: reflektimin e resurseve dhe obligimeve në kuadër të strukturës

---

<sup>9</sup> Ligji për Qasje në Dokumente Publike, neni 1, në dispozicion në

<http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-215-alb.pdf>

<sup>10</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, [http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L040\\_al.pdf](http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf)

<sup>11</sup> Poaty, neni 26, paragrafi 1 dhe 2

së tyre organizative/organogramit, ekzistencën e Termave të Referencës (TR) dhe Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP), të cilat përcaktojnë konkretisht përgjegjësitë e strukturave institucionale për komunikim dhe informim publik dhe detyrat konkrete të stafit përkatës.

Përveç këtyre, zbatimi efektiv i kornizës ligjore e rregullative kërkon ekzistencën e standardeve të brendshme të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të punës së tyre, alokimin e resurseve të mjaftueshme (humane, financiare e teknike) për funksionimin e këtyre strukturave të brendshme, përfshirë zbatimin e dokumenteve të politikave e planeve relevante të punës. Sa u përket këtyre të fundit, komponenti i komunikimit dhe informimit publik duhet të pasqyrohet në të gjitha, në formë objektivash e aktiviteteve specifike, në kuadër të afateve kohore. Së fundi, por jo vetëm kjo, nevojiten praktika administrative në mënyrë që brenda secilit institucioni/ndërmarrjeje publike të krijohet dhe zhvillohet një kulturë që promovon komunikimin e rregullt me dhe përfshirjen e mediave dhe organizatave të shoqërisë civile në punën e rregullt të tyre, në veçanti në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të kornizës ligjore përkatëse dhe asaj të politikave.

Pjesa në vijim e raportit paraqet gjetjet nga secila Komunë e përfshirë në këtë vlerësim (sipas renditjes alfabetike).



## 1. Komuna e Drenasit

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, janë të qarta **dispozitat e Statutit** që synojnë zbatimin e dispozitave kushtetuese për komunikim dhe informim publik, përfshirë ato që rregullojnë mekanizmat e realizimit të kërkesave për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen e Komunës, konsultimet publike, tubimet publike me qytetarë, anketa të ndryshme, kontaktet me grupet e interesit, dhe studimet për vlerësim të ndikimit. Kjo Komunë gjithashtu ka miratuar Rregulloren Komonale për Transparencë e cila përcakton obligimet, strukturat dhe resurset brenda strukturave komunale për përmbushjen e obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. E njëjta vlen sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese të parapara me këtë akt, përfshirë mënyrën e rregullimit të klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të Komunës nga ato dokumente publike të Komunës në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën për qasje. Në anën tjetër, kjo Komunë zbaton Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare, dhe rregullorja në fjalë nuk parasheh mekanizma e masa zbatuese për të rregulluar çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë.

Sipas të dhënave të ofruara, **organogrami** i Komunës së Drenasit parasheh funksionimin e një Zyre për Marrëdhënie me Publikun (ZMP), por nuk është plotësisht e qartë struktura e kësaj zyre, përfshirë në kuadër të strukturës së gjithëmbarshme hierarkike të Komunës, dhe funksionimi i saj në këtë kontekst. Ndërkaq sa u përket Termave të Referencës (TR) së kësaj zyre, ato gjenden në fazën e përcaktimit të qartë për përgjegjësive dhe numrit të zyrtarëve. Sidoqoftë, sipas të dhënave të ofruara, thuhet se ekzistojnë Përshkrimet e Vendeve të Punës së zyrtarëve të saj, por nuk janë dhënë sqarime për to. Në nivelin e **kornizës së politikave dhe planeve zbatuese**, Komuna e Drenasit ka vetëm planin vjetor të punës, i cili prek edhe fushën e komunikimit dhe informimit publik. Përveç caktimit të zyrtarit përgjegjës për t'u përgjigjur në kërkesat për qasje në dokumente publike, gjithashtu është pohuar se në kuadër të planit vjetor të Komunës janë paraparë aktivitete për komunikim dhe informim publik si fushata vetëdijesimi, fletëpalosje, bashkëpunimi me media dhe tubimet publike.

Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, sipas të dhënave të ofruara, ZMP vë në zbatim standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës, raportime këto që bëhen çdo tre muaj në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe në Zyrën e Kryeministrit, por nuk kanë shpjeguar më shumë. Sa u përket resurseve njerëzore, të dhënat tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune mbi nëntëvjeçare dhe asnjë trajnim të ndjekur gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. Por, përveç resurseve humane, nuk është e qartë shuma kategorive të tjera të resurseve të alokuara për komunikim dhe informim publik. E njëjta vlen sa i përket resurseve për zbatimin e aktiviteteve për komunikimin dhe informimin publik me rastin e miratimit të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese dhe atyre për komunikim dhe informim publik për periudhën njëvjeçare në vijim.

Sa u përket **çështjeve të zbatimit**, kjo Komunë ka komunikuar në baza ditore me 3 media lokale dhe 6 media qendrore, por nuk dihen saktësisht llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së organizatave lokale të shoqërisë civile në punën e saj, pasi që vetëm kanë përmendur 5 prej tyre, por nuk kanë specifikuar kohëzgjatjen dhe rolin e përfshirjes së secilës prej tyre. Kur jemi te përfshirja e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave, asnjë akter i tillë nuk është përfshirë në këtë proces gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së këtyre akterëve në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve të politikave të kësaj Komune. Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet, por nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse tubimet me publikun, njoftimi i medieve, takimet e Kryetarit të Komunës, aktivitetet ditore e javore për të informuar qytetarët për të drejtën e tyre për qasje në dokumente komunale janë përmendur si aktivitete shtesë për komunikim dhe informim publik.

## 2. Komuna e Ferizajt

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal**, janë të qarta dispozitat e Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik, me synim të zbatimit të dispozitave përkatëse kushtetuese e ligjore. Kjo Komunë gjithashtu ka miratuar një Rregullore Komunale për Transparencë, por nuk është plotësisht e qartë se çfarë obligimesh, strukturash dhe resursesh specifike brenda strukturave komunale parasheh ajo me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. E njëjta vlen sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese. E njëjta vlen edhe në lidhje me mënyrën e rregullimit të klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të Komunës nga ato dokumente në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën për qasje, pasi që vetëm u janë referuar dispozitave përkatëse të LQDP-së. Më tej, sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë, kjo çështje është e rregulluar me Rregulloren Komunale për Përdorimin e Gjuhëve, por nuk është e qartë cilat janë mekanizmat e masat zbatuese. Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Ferizajt, një Njësi për Informim Publik është pjesë e **organogramit** të saj, por nuk është e qartë nëse ka Termat e Referencës (TR), kurse sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP), kanë deklaruar se ekzistojnë, por nuk është e qartë se si funksionon. E njëjta vlen në lidhje me standardet e raportimit e monitorimit të brendshëm dhe vlerësimin të punës.

Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, të dhënat e ofruara nga kjo Komunë në lidhje me kapacitetet njerëzore tregojnë kualifikime formale relativisht relevante, përvojë pune prej 2 vitesh dhe pjesëmarrje në trajnime prej 3 ditësh, kurse nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara. E njëjta vlen në lidhje me shumën e resurseve të alokuara për zbatimin e aktiviteteve për komunikim dhe informim publik në kuadër të planeve të tyre dhe shumës së resurseve të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Në nivelin e **kornizës së politikave dhe planeve zbatuese**, Komuna e Ferizajt nuk ka një plan të tillë, e nuk kanë përmendur as

ndonjë komponent të komunikimit dhe informimit publik në kuadër të Planit Vjetor të Komunës. Rrjedhimisht, nuk ka një listë specifike objektivash për këtë fushë, e as një listë të qartë aktiviteteve të planifikuara, por vetëm kanë përmendur punën në një udhërrëfyes të qytetit dhe një buletin informues që publikohet çdo vit.

Sa u përket **çështjeve të zbatimit**, kjo Komunë ka pasur komunikim të rregullt me 3 media lokale (përfshirë transmetimin e mbledhjeve të Kuvendit Komunal nga njëra prej tyre), por nuk është e qartë se për çfarë lloje aktiviteteve bëhet fjalë. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së OShC-ve lokale në punën e kësaj Komune, pasi që vetëm kanë përmendur 3 prej tyre, por nuk është plotësisht e qartë se për çfarë lloje aktiviteteve bëhet fjalë dhe kohëzgjatja e përfshirjes së tyre (përveç një bashkëpunimi me njërin prej OShC-ve lokale në zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe vendbanimeve dhe zonave urbane të qytetit gjatë vitit 2012). Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave, asnjë akter i trill nuk është përfshirë, kurse vetëm një prej tyre në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit dhe politikave, por nuk kanë dhënë asnjë hollësi të mëtejshme. Së fundmi, në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet zyrtare të Komunës (si buxheti komunal, rregulloret, vendimet, njoftimet, konkurset, shpalljet e tenderët) por nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse si aktivitetet shtesë për komunikim dhe informim publik kanë përmendur debatet publike (mbi projekt-buxhetin, draft-rregulloret e ndryshme dhe planet urbane e rregullative).

### 3. Komuna e Graçanicës

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, në kohën e mbledhjes së të dhënave, Statuti i kësaj Komune nuk ka paraparë përgjegjësi ligjore për struktura institucionale për komunikim dhe informim publik, por ky dokument ka qenë në proces të rishikimit, dhe është paraparë që pas hyrjes së Statutit të ri në fuqi (në mars 2013), një zyrë e tillë të parashihet edhe me organogramin e ri të Komunës. Kjo Komunë gjithashtu ka një Rregullore Komonale për Transparencë dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Administratës Komonale, dhe kjo e fundit (e cila ka në fuqi më 2012) ka paraparë pozitën e një zyrtari për komunikim me publikun (sipas të dhënave të ofruara, aktualisht dy zyrtarë me një pozitë të tillë), por në kohën e mbledhjes së të dhënave për këtë vlerësim kjo pozitë nuk ka qenë në funksion. Rrjedhimisht, nuk është plotësisht e qartë se çfarë obligimesh, strukturash dhe resursesh specifike brenda strukturave komunale parasheh ky legjislacion zbatues me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. E njëjta vlen sa u përket mekanizmeve dhe masave zbatuese. E njëjta vlen në lidhje me klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike senzitive të Komunës nga ato dokumente në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën për qasje. Më tej, sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë, kjo çështje është e rregulluar me Rregulloren Komonale për Përdorimin e Gjuhëve, por nuk është e qartë cilat janë mekanizmat e masat zbatuese. Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Graçanicës, në kuadër të **organogramit** të saj nuk është paraparë një zyrë për komunikim me publikun, por një zyrtar për informim publik, dhe se me

rishikimin e Statutit një strukturë e tillë do të parashihet në organogramin e ri të Komunës. Më tej, është thënë se ka Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrimet e Vendit të Punës (PVP) për zyrtarin në fjalë janë paraparë në kuadër të Rregullores Komunale për Transparencë, por nuk është e qartë përmbajtja e tyre. E njëjta vlen në lidhje me standardet e raportimit e monitorimit të brendshëm dhe vlerësimit të punës.

Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, të dhënat e ofruara nga kjo Komunë në lidhje me kapacitetet njerëzore tregojnë kualifikime formale jo aq relevante, përvojë pune prej 3 deri në mbi 5 vjet dhe se nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim, kurse nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara. E njëjta vlen në lidhje me shumën e resurseve të alokuara për zbatimin e aktiviteteve për komunikim dhe informim publik në kuadër të planeve të tyre dhe shumës së resurseve të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Në nivelin e kornizës së politikave dhe planeve zbatuese, Komuna e Graçanicës nuk ka një dokument të tillë, e rrjedhimisht nuk ka një listë specifike objektivash për këtë fushë, e as një listë të qartë aktiviteteve të planifikuara, e as mekanizma e masa zbatuese të politikave komunale për komunikim dhe informim publik. Sa u përket **çështjeve të zbatimit**, kjo Komunë nuk ka dhënë asnjë informatë në lidhje me mediat me të cilat ka pasur komunikim dhe OShC-të e përfshira në punën e saj gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e vlerësimit të zbatimit të legjislacionit dhe të politikave. Kjo Komunë gjithashtu nuk ka dhënë ndonjë informatë në lidhje me përmbajtjen e ueb-faqes së saj, e as mbi aktivitetet shtesë për komunikim dhe informim publik.

#### 4. Komuna e Gjakovës

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, nuk është plotësisht e qartë cila është përmbajtja e dispozitave të Statutit për zbatimin e dispozitave kushtetuese e ligjore për komunikim dhe informim publik. Më tej, kjo Komunë ka Rregulloren Komunale për Transparencë, por nuk është e qartë çfarë obligimesh, strukturash dhe resursesh specifike brenda strukturave komunale parasheh ajo për të siguruar përmbushjen e obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. E njëjta vlen në lidhje me mekanizmat e masat zbatuese të parapara me këtë akt, si dhe në lidhje me klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve dhe përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim. Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Gjakovës, Zyra për Informim Publik (ZIP) është pjesë e **organogramit** të Komunës dhe funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, por nuk është e qartë nëse kjo zyrë ka Termat e Referencës (TR), ndërsa Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) për tre zyrtarë të saj janë në hartim e sipër.

Në nivelin e **kornizës së politikave dhe planeve zbatuese**, Komuna e Gjakovës ka deklaruar se ZIP punon në bazë të një strategjie dhe plani veprimi për komunikim dhe informim publik, por dihet përmbajtja e këtyre dokumenteve. E njëjta vlen në lidhje me objektivat dhe aktivitetet në këtë fushë politikash, si dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të

politikave në këtë fushë. Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, sipas të dhënave të ofruara nga kjo Komunë, vlerësimi i punës kryhet në baza gjashtë mujore dhe vjetore, por megjithatë nuk është e qartë se çfarë standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës ka. Sa u përket resurseve njerëzore, të dhënat tregojnë kualifikime formale të larta, përvojë pune prej 10 deri në 30 vite dhe pjesëmarrje në trajnime prej 1 deri në 3 muaj (ndonëse nuk është e qartë relevanca e tyre për të tri kategoritë). Megjithatë, nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të kësaj zyre, për zbatimin e politikave dhe shuma e atyre të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim.

Sa u përket **çështjeve të zbatimit**, kjo Komunë ka pasur komunikim të rregullt me 14 media lokale dhe nacionale, por nuk është e qartë se për çfarë lloje aktivitete behet fjalë. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së OShC-ve lokale në punën e saj gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim, pasi që vetëm kanë përmendur dy prej tyre por kanë përmendur ngjarje politike në përgjithësi e as kanë shpjeguar kohëzgjatjen dhe llojin përfshirjes së secilës prej tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe të politikave lokale, asnjë akter i tillë nuk është përfshirë, kurse vetëm një i tillë në monitorimin dhe vlerësimit të zbatimit të legjislacionit dhe politikave lokale, por nuk kanë dhënë asnjë hollësi të mëtejshme. Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet zyrtare të Komunes, por nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse nuk kanë kryer ndonjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik.

## 5. Komuna e Hanit të Elezit

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal**, është e qartë përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Kjo Komunë gjithashtu ka vënë në fuqi Rregulloren Komunale për Transparencë dhe Rregulloren për Qasje në Dokumente Publike (të miratuara më 2011), e të cilat përcaktojnë obligimet, strukturat e resurset specifike brenda strukturave komunale e qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë se çfarë mekanizma e masa zbatuese janë në funksion përtej qëllimit dhe fushëveprimit të rregullores së fundit. Në anën tjetër, përveç ligjeve kornizë dhe Rregullores Komunale për Përdorimin e Gjuhëve, nuk është e qartë se çfarë dispozitash, mekanizmash e masash zbatuese janë vendosur dhe janë në funksion në këtë Komunë për klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim. Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Hanit të Elezit, Zyra e saj për Komunikim dhe Informim me Publikun (ZKIP) është paraparë në kuadër të **organogramit** të saj, si dhe ka Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) për një zyrtar për informim.

Në nivelin e **kornizës së politikave dhe planeve zbatuese**, Komuna e Hanit të Elezit ka miratuar Planin e Punës, pjesë e të cilit është edhe plani i punës i ZKIP-së, i cili përmban objektivat dhe 8 aktivitete të planifikuara dhe të buxhetuara. Aktivitetet përfshijnë përdorimin e ueb-faqes së Komunes, tabelave publike në fshatra, mediave lokale, konferencave periodike për shtyp e takimeve të rregullta

me qytetarë të Kryetarit të Komunës, shpalljet publike në vendet më të frekuentuara në komunë, si dhe shtypja dhe shpërndarja e broshurave, posterëve dhe fletëpalosjeve të ndryshme. Kur jemi te korniza dhe kapacitetet institucionale për komunikim dhe informim publik, të dhënat (një anëtar personeli) tregojnë kualifikime formale të larta, përvojë pune prej 4 vitesh (ndonëse nuk dihet relevanca për të dyja kategoritë) dhe asnjë trajnim të ndjekur. Në anën tjetër, në përputhje me Planin e Punës, ZKIP-së i është ndarë një buxhet prej €1,250 për zbatimin e aktiviteteve për komunikim dhe informim publik. Sipas të dhënave të ofruara, vlerësimi i punës së stafit kryhet në baza gjashtëmujore dhe vjetore, por megjithatë nuk është e qartë se çfarë standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës mund të ketë.

Sa u përket **çështjeve të zbatimit**, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim kjo Komunë ka komunikuar sipas nevojës me 1 media lokale dhe 7 media qendrore, por nuk është e qartë për çfarë lloje aktivitete bëhet fjalë. Një problem specifik për këtë komunë është se nuk vepron asnjë media lokale, nuk mbulohet me sinjal të medieve kombëtare dhe nuk ka ndonjë korrespondent nga këto të fundit që mbulon këtë komunë. Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe në punën e saj janë përfshirë 5 OShC (të nivelit lokal dhe qendror), por nuk është e qartë për çfarë lloji përfshirjeje dhe çfarë aktivitete bëhet fjalë. Më tej, gjatë kësaj periudhe, akterët jashtë-qeveritarë janë përfshirë në hartimin e rregulloreve dhe 3 planeve, por nuk është e qartë për cilat rregullore dhe akterë të tillë bëhet fjalë. Në anën tjetër, asnjë akter i tillë nuk është përfshirë në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të legjislacionit e të politikave për komunikim dhe informim publik. Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara një numër i madh dokumentesh, dhe janë prezantuar të gjitha ato, por kjo Komunë nuk ka kryer asnjë aktivitetet shtesë për komunikim dhe informim publik.

## 6. Komuna e Istogut

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal**, është e qartë përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Kjo Komunë gjithashtu ka vënë në fuqi Rregulloren Komunale për Transparencë, e cila përcakton obligimet, strukturat dhe resurset specifike për komunikim dhe informim publik, si dhe mekanizmat e masat zbatuese. Sipas tyre, kjo rregullore rregullon çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të Komunës, ndërsa Rregullorja Komunale për Përdorimin e Gjuhëve çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, por megjithatë nuk është e qartë përmbajtja e dispozitave specifike, e as mekanizmat e masat zbatuese. **Organogrami** i Komunës së Istogut ka paraparë funksionimin e Zyrës për Komunikim dhe Informim me Publikun (ZKIP), si dhe Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) për një zyrtar për informim, por përveç se dihet se ZKIP funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës, nuk kanë dhënë ndonjë sqarim shtesë.

Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, të dhënat e ofruara nga kjo Komunë tregojnë kualifikime formale të larta,

përvojë pune 31 vitesh (ndonëse nuk është e qartë se sa relevante janë) dhe një trajnim të ndjekur me kohëzgjatje prej një jave, por nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara, përfshirë shumën e resurseve për zbatimin e politikave aktuale dhe për periudhën njëvjeçare në vijim. Në anën tjetër, vlerësimi i punës së stafit kryhet në bazë Rregullores së Ministrisë së Administratës Publike, megjithatë nuk është e qartë se çfarë standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës vihen në zbatim. Në nivelin e kornizës së politikave dhe planeve zbatuese, Komuna e Istogut nuk ka hartuar ndonjë dokument politikash ose plan zbatues për komunikim dhe informim publik. Rrjedhimisht, ajo nuk ka vendosur objektiva për të arritur në këtë fushë, e as aktivitete për arritjen e tyre dhe mekanizma e masa për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre (përveç caktimit të nëpunësit përgjegjës për pranimin e kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente publike).

Në lidhje me **çështjet e zbatimit**, kjo Komunë ka pasur komunikim ditor, javor e mujor me 8 media lokale e nacionale, por nuk është plotësisht e qartë se për çfarë aktivitete konkrete bëhet fjalë (përveç përmendjes, në përgjithësi, të njoftimeve dhe komunikatave dhe debateve në studio me zyrtarë të Komunës). Në anën tjetër, sipas të dhënave të tyre, 7 OShC lokale janë përfshirë në punën e Komunës (nëpërmjet zbatimit të disa projekteve të përbashkëta), por megjithatë nuk është e qartë se për çfarë lloj aktivitete bëhet fjalë dhe kohëzgjatja e tyre. E njëjta vlen në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e legjislacionit dhe të politikave të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Në ueb faqen e Komunës janë të publikuara gjitha materialet të cilat i dërgohen Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe trupave të tij (përfshirë procesverbalet, projekt-rregulloret, vendimet e planet e ndryshme të politikave, konkurset, tenderët etj.), dhe se të gjithë dokumentet publikohen në dy gjuhë zyrtare, mirëpo nuk kanë listuar asnjë, por nuk ka pasur ndonjë aktivitet shtesë përveç atyre të përmendur më sipër.

## 7. Komuna e Kamenicës

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal**, dihet se Statuti përmban dispozita për komunikim dhe informim publik, por nuk është plotësisht e qartë përmbajtja e plotë e tyre. Më tej, Komuna e Kamenicës ka miratuar Rregulloren për Transparencë, sipas të cilës edhe është caktuar zyrtari për qasje në dokumente publike, ndërkaq mekanizmat e masat zbatuese përfshijnë ueb-faqen, buletinin komunal dhe njoftimet për takimet e Kryetarit dhe të drejtorëve komunalë. Në anën tjetër, asnjë akt nënligjor komunal nuk rregullon çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive, ndërsa Rregullorja Komunale për Përdorimin e Gjuhëve çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, por megjithatë nuk është e qartë përmbajtja e dispozitave specifike, e as mekanizmat e masat zbatuese. Zyra për Marrëdhënie me Publikun (ZMP), me numër personeli prej 3, është paraparë në kuadër të **organogramit** të kësaj Komune, por nuk është plotësisht i qartë funksionimi i saj në kuadër të strukturës së gjithëmbarshme hierarkike të Komunës. E njëjta vlen në lidhje me Termat e Referencës (TR) së kësaj zyre dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës, pasi që është thënë se janë vënë në fuqi, por nuk është dhënë asnjë hollësi e mëtejshme.



Në nivelin e **kornizës së politikave dhe planeve zbatuese**, ZMP ka hartuar planin e vet vjetor, por nuk është dhënë asnjë hollësi shtesë. Rrjedhimisht, e njëjta vlen sa u përket objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara për komunikim dhe informim publik dhe reflektimit të tyre në kuadër të planit vjetor të Komunës. Kur jemi te korniza dhe kapacitetet institucionale për komunikim dhe informim publik, të dhënat rreth personelit tregojnë kualifiko formale të mesme dhe të larta, përvojë pune deri në 31 vjet dhe pjesëmarrje në trajnime në kohëzgjatje deri në 15 ditë në përgjithësi (ndonëse nuk dihet relevanca e saktë për të tri kategoritë). Në anën tjetër, shuma e buxhetit vjetor të alokuar është nga €10,000 për të dy vitet (2012 dhe 2013), përfshirë për zbatimin e politikave komunale për komunikim dhe informim publik, por nuk është plotësisht e qartë për çfarë aktiviteteve. Sipas të dhënave të ofruara, vihen në zbatim standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës dhe ka raportime vjetore, por nuk është plotësisht e qartë se çfarë standardesh aplikohen.

Kur jemi tek **çështjet e zbatimit**, kjo Komunë ka pasur komunikim sipas nevojës me 10 media lokale dhe qendrore, ndërsa si aktivitete kanë listuar debatet, njoftimet, urimet, botime informatash nga komuna, shpallje e konkurse. Më tej, përveç donatorëve, asnjë akter jashtë-qeveritar nuk është përfshirë në punën e kësaj Komune gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. E njëjta vlen sa i përket hartimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve të politikave për komunikim dhe informim publik dhe monitorimit e vlerësimit të zbatimit të tyre. Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet komunale, në dy gjuhët zyrtare. Në anën tjetër, përveç aktiviteteve të sipërpërmendura, nuk ka pasur aktivitete shtesë për komunikim dhe informim publik.

## 8. Komuna e Klinës

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, është e qartë përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik, përfshirë konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e Komunës, takimet me publikun, petitionet, referendumin lokal, komitetet konsultative dhe iniciativat e qytetarëve. Kjo Komunë gjithashtu ka vënë në fuqi Rregulloren Komunale për Transparencë, e cila përcakton obligimet, strukturat dhe resurset specifike për komunikim dhe informim publik, si dhe mekanizmat e masat zbatuese. E njëjta vlen sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese të parapara me këtë akt, pra kjo Komunë. Sipas tyre, ligji kornizë rregullon çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të Komunës, ndërsa Rregullorja Komunale për Përdorimin e Gjuhëve atë të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, por megjithatë nuk është e qartë përmbajtja e dispozitave specifike, e as mekanizmat e masat zbatuese. Sipas të dhënave të ofruara, Zyra për Marrëdhënie me Publikun (ZMP), e përbërë nga një zyrtar, funksionon në kuadër të kësaj Komune, por nuk është e qartë nëse është paraparë shprehimisht në kuadër të **organogramit** të Komunës. E njëjta vlen në lidhje me Termat e Referencës dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës së stafit të saj.



Sa i përket **kornizës dhe kapaciteteve institucionale** për komunikim dhe informim publik, të dhënat për stafin e ZMP-së tregojnë kualifikime formale të larta, përvojë pune prej 6 vitesh dhe pjesëmarrje në trajnime me kohëzgjatje prej 4 ditësh gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim (ndonëse nuk është plotësisht e qartë relevanca e të tri komponentëve). Megjithatë, nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara për funksionimin e ZMP-së, për zbatimin e politikave dhe ajo e planifikuar për periudhën njëvjeçare në vijim. Ngjashëm është gjendja në lidhje me standardet e raportimit e vlerësimit të punës së stafit, pasi që nuk është e qartë se sa shpesh kryhen dhe në çfarë standarde bazohen. Në nivelin e **kornizës së politikave dhe planeve zbatuese**, ZMP e Komunës së Kamenicës nuk ka hartuar ndonjë plan politikash për komunikim dhe informim publik, e rrjedhimisht nuk ka objektiva e aktivitete të qarta në këtë drejtim (përfshirë aktivitetet në kuadër të planit vjetor të Komunës).

Kur jemi të **çështjet e zbatimit**, kjo Komunë ka pasur komunikim me 7 media, por nuk është e qartë se për çfarë kanë komunikuar me to. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së OSHC-ve lokale dhe qendrore në punën e kësaj Komune, pasi që vetëm kanë përmendur 7 prej tyre, por nuk kanë shpjeguar kohëzgjatjen dhe rolin e përfshirjes së tyre. Në anën tjetër, asnjë akter i tillë nuk është përfshirë në hartimin e legjislacionit dhe të politikave lokale. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së këtyre akterëve në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimit e zbatimit të legjislacionit dhe të politikave lokale. Në fund, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet komunale dhe janë të qasshme për publikun (vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa gjatë këtij viti pritet të jenë edhe në gjuhën serbe), kurse përveç aktiviteteve të lartpërmendura gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim nuk është ndërmarrë ndonjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik.

## 9. Komuna e Kllokotit

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal**, është e qartë përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Kjo Komunë gjithashtu miratuar Rregulloren Komunale për Transparencë, e cila thuhet se përcakton obligimet, strukturat dhe resurset specifike për komunikim dhe informim publik, si dhe mekanizmat e masat zbatuese, por megjithatë konkretisht nuk dihet për çfarë obligime, resurse, dhe mekanizma e masa zbatuese bëhet fjalë. Sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të Komunës, nuk është e qartë çfarë dispozitash ligjore janë në fuqi, kurse Rregullorja Komunale për Përdorimin e Gjuhëve rregullon çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, por megjithatë nuk është e qartë përmbajtja e dispozitave specifike, e as mekanizmat e masat zbatuese për këto dy çështje. Sipas të dhënave të ofruara, **organogrami** i Komunës së Kllokotit parasheh funksionimin e një Zyre Komunale për Marrëdhënie me Publikun (ZKMP), në kuadër Zyrës së Kryetarit të Komunës, e cila përbëhet vetëm nga një Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun. Kjo Komunë akoma nuk ka miratuar Terma të Referencës së ZKMP-së, në ndërkohë që, sipas tyre, Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) janë përcaktuar me Rregulloren e

Komunës për Sistematizimin e Vendeve të Punës. Megjithatë, nuk dihet përmbajtja e tyre, dhe nuk është plotësisht e qartë çfarë mekanizma masa e zbatuese ka, përfshirë ato për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e punës së zyrtarit në fjalë, dhe në çfarë standarde bazohen këto të fundit (përveç që kanë përmendur monitorimin ditor, javor, mujor dhe vjetor).

Sa i përket **kornizës dhe kapaciteteve institucionale** për komunikim dhe informim publik, të dhënat për stafin e ZKMP-së tregojnë kualifikime formale jo aq relevante, përvojë pune prej 28 vitesh (ndonëse nuk është plotësisht e qartë relevanca e saj) dhe se nuk ka marrë pjesë në ndonjë trajnim gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. Megjithatë, nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara për funksionimin e ZMP-së, për zbatimin e politikave dhe ajo e planifikuar për periudhën njëvjeçare në vijim. Sipas të dhënave të ofruara në lidhje me kornizën e politikave dhe planet zbatuese, ZKMP e Komunës së Kllokotit punon në bazë të një plani vjetor pune. Megjithatë, nuk është e qartë çfarë objektivash e aktiviteteve parasheh ky plan, e as çfarë mekanizma e masa për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tij ka dhe sa shpesh vihen në zbatim ato.

Kur jemi të **çështjet e zbatimit**, kjo Komunë ka pasur komunikim me 7 media lokale dhe të nivelit qendror, kryesisht me fokus në informimin e qytetarëve mbi aktivitetet e Komunës. e për çfarë kanë komunikuar me to. Në anën tjetër, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim në punën e saj është përfshirë 1 OShC lokale, por është e qartë kohëzgjatja e saktë dhe lloji i përfshirjes së saj. Më tej, gjatë kësaj periudhe asnjë akter jashtë-qeveritar i tillë nuk është përfshirë në hartimin, zbatimin, dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të legjislacionit dhe të politikave lokale. Së fundmi, sipas të dhënave të kësaj Komune, në ueb-faqen e saj janë të publikuara të gjitha vendimet, rregulloret, aktivitetet dhe informatat mbi funksionimin e administratës komunale që nga viti 2011, kurse përveç aktiviteteve të lartpërmendura (kryesisht informimin e qytetarëve mbi punën e Komunës) gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim nuk është ndërmarrë ndonjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik.

## 10. Komuna e Mitrovicës

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, është e qartë përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Më tej, kjo Komunë ka vënë në fuqi Rregulloren Komunale për Transparencë, por është plotësisht e qartë se çfarë obligimesh, strukturash dhe resurseth specifike brenda strukturave komunale parasheh ajo me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. Në anën tjetër, mekanizmat e masat zbatuese të parapara me këtë akt përfshijnë publikimin e të gjitha aktiviteteve të Komunës nëpërmjet tabelës së shpalljeve në Komunë, shpalljeve publike në vende të frekuentuara, medieve dhe ueb-faqes së Komunës. Në lidhje me klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike senzitive të Komunës nga ato dokumente në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën për qasje, kjo është e rregulluar me një dispozite të Rregullores Komunale për Transparencë. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë çfarë masash e mekanizmash zbatues janë vendosur për këtë qëllim, e as në lidhje me çështjen e

përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë. Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Mitrovicës, **organogrami** i saj parasheh funksionimin e Zyrës për Komunikim dhe Informim Publik (ZKIP), e cila ka Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP), por megjithatë nuk është dhënë përmbajtja e këtyre dokumenteve e as ndonjë shpjegim mbi këtë.

Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, të dhënat për resurset njerëzore tregojnë kualifikime formale të larta, përvoja pune nga 2 deri në 12 vite dhe pjesëmarrje në trajnime prej gjithsej pesë muajsh që nga fillimi (ndonëse nuk është plotësisht e qartë relevanca e të tre komponentëve). Më tej, ZKP posedon buxhet të veçantë, me €30,000 të alokuar për vitin 2013 (që në krahasim me vitin e kaluar i bie rreth 75% më shumë), të cilat janë në dispozicion për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave lokale për komunikim dhe informim publik. Së fundmi në lidhje me kornizën dhe kapacitetet institucionale, vlerësimi i punës së stafit kryhet në baza vjetore, por megjithatë nuk është e qartë se çfarë standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës vihen në zbatim. Në nivelin e **kornizës së politikave dhe planeve zbatuese**, Komuna e Mitrovicës ka një plan veprimi për komunikim dhe informim publik, por që nuk është e qartë përmbajtja e tij. Rrjedhimisht, ajo nuk ka vendosur objektiva për të arritur në këtë fushë, e as aktivitete për arritjen e tyre dhe mekanizma e masa për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre. E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin që mbulon ky vlerësim.

Sa u përket **çështjeve të zbatimit**, kjo Komunë ka pasur komunikim ditor me një numër të madh mediesh lokale e nacionale, por nuk është e qartë sa prej tyre dhe për çfarë aktivitete bëhet fjalë. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së OSHC-ve lokale në punën e saj, pasi që kanë përmendur 3 prej tyre, por nuk është e qartë kohëzgjatja e përfshirjes së secilës prej tyre dhe roli që kanë pasur. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave, nuk është e qartë konkretisht cilët akterë janë përfshirë në çfarë legjislacioni e politikash. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së akterëve të tillë në zbatimin e tyre, kurse sa i përket monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të legjislacionit dhe politikave lokale, kanë përmendur një akter të tillë, por nuk kanë dhënë asnjë hollësi të mëtejshme. Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara një numër i madh dokumentesh, por nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse botimi i fletushkave dhe udhëzuesve për qytetarët, këndi i informacionit në hollin e komunës dhe një monitor me njoftime kanë qenë aktivitetet shtesë për komunikim dhe informim publik.

## 11. Komuna e Novobërdës

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, është e qartë përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Më tej, kjo Komunë ka vënë në fuqi Rregulloren Komonale për Transparencë, e cila synon forcimin e transparencës së organeve të komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe krijimin e rregullave që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të së drejtës së qytetarëve

për pjesëmarrje në vendimmarrje, si dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumente zyrtare komunale. Megjithatë, nuk është e qartë çfarë obligime, struktura dhe resurse konkrete vendos ajo për të mundësuar zbatimin e obligimeve kushtetuese e ligjore për komunikim dhe informim publik. Sa u përket mekanizmave e masave zbatuese, kjo rregullore rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të komunës dhe Komiteteve të tij, mbledhjet publike të Komunës, obligimin për njoftime publike, konsultimet në hartimin e akteve komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe buxhetimin e Komunës, dhe qasjen në dokumente zyrtare të Komunës. Në lidhje me klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike senzitive të Komunës nga ato dokumente në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën për qasje, të dhënat e ofruara tregojnë vetëm se cilat janë dokumente publike të Komunës, por nuk prekin çështjen e klasifikimit të dokumenteve senzitive, dhe është e qartë çfarë masash e mekanizmash zbatues janë vendosur për këtë qëllim, e as në lidhje me çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë.

Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Novobërdës, **organogrami** i saj parasheh funksionimin e Zyrës për Informim (ZI), të përbërë nga një zyrtar për informim, por nuk është e qartë përmbajtja e tij dhe funksionimi i kësaj zyre në kuadër të strukturës së gjithëmbarshme hierarkike të Komunës. Më tej, ZI ka Termat e Referencës (TR), të cilat përcaktojnë se ajo është përgjegjëse për: përcjelljen dhe publikimi i informatave rreth aktiviteteve dhe vendimeve, rregulloreve e dokumenteve të tjera të nxjerra nga Komuna; informimin e qytetarëve mbi seancat e Kuvendit Komunal; organizimin dhe informimin e qytetarëve mbi takimet e tjera publike të Komunës (përfshirë takimet e obligueshme publike, si dhe dëgjimet e debatet publike mbi buxhetin dhe planin zhvillimore urban të Komunës); mirëmbajtjen e tabelave publike informative të Komunës; organizimin e konferencave për shtyp të Kryetarit të Komunës dhe përgatitjen e shpërndarjen e buletinit informativ të Komunës. Përveç këtyre, kjo Zyrë gjithashtu kryen detyra të tjera që kanë që lidhen me informimin e publikut, përfshirë pjesëmarrjen në trajnime, seminare e punëtori të ndryshme, takime me përfaqësues të shoqërisë civile, etj. Sipas tyre, zyrtari i ZI-së gjithashtu ka Përshkrimin e Vendit të Punës (PVP), të përfshirë në kuadër të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Komunës, por megjithatë nuk është e qartë përmbajtja e këtij përshkrimi.

Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, të dhënat për resurset njerëzore tregojnë kualifikime formale të larta relativisht relevante, përvoje pune prej 4 vitesh dhe pjesëmarrje në trajnime (ndonëse nuk është plotësisht e qartë relevanca e përvojës së punës dhe trajnimeve të ndjekura). Përveç resurseve njerëzore dhe teknike (si kompjuterë, aparat fotografik e diktafon), nuk është e qartë shuma e saktë e kategorive të tjera të resurseve të alokuara kësaj zyre. E njëjta vlen sa u përket resurseve të alokuara për zbatimin e dokumenteve për komunikim dhe informim gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim dhe atyre të planifikuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Së fundmi në lidhje me kornizën dhe kapacitetet institucionale, raportimi dhe vlerësimi i punës së stafit vlerësimi bëhet çdo gjashtë muaj, por megjithatë nuk është e qartë se çfarë standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës vihen në zbatim.

Në nivelin e kornizës së politikave dhe planeve zbatuese, ZI e Komunës së Novobërdës punon në bazë të një Plani Pune, por ato që Komuna e cilëson si objektiva janë identike me përshkrimin e fushëveprimit të kësaj zyre (të paraqitur më sipër), kurse në nivel të aktiviteteve kanë përmendur vetëm në përgjithësi bashkëpunimin me media dhe debatet me publike (pa listuar ndonjë aktivitet konkret të organizuar gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim). Sa u përket mekanizma e masa për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të politikave për komunikim dhe informim publik, kanë përmendur vetëm raportet tremujore dërguar MAPL-së. E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin që mbulon ky vlerësim.

Sa u përket çështjeve të zbatimit, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim kjo Komunë ka pasur komunikim me 5 media (lokale e qendrore), me fokus kryesisht në informimin e publikut mbi aktivitetet e komunës (përfshirë takimet publike dhe dëgjimet buxhetore dhe për planin urban të komunës). Në anën tjetër, sipas informatave të ofruara, gjatë kësaj periudhe në punën e saj janë përfshirë 5 OSHC lokale, por nuk është e qartë kohëzgjatja e përfshirjes së secilës prej tyre dhe roli që kanë pasur (pasi që vetëm kanë përmendur në përgjithësi shkëmbimin e informatave, bashkëpunimin dhe partneritetin). Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin, zbatimin, dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të legjislacionit e politikave komunale, kjo Komunë ka listuar një numër të madh vendimesh e rregulloresh, por asnjë akter të tillë të përfshirë. Së fundmi, në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara Statuti, rregulloret e vendimet e Komunës, raportet e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive të saj, strategjitë e planet e Komunës, si dhe njoftime, konkurse e shpallje të ndryshme të Komunës, kurse pjesëmarrja në trajnime, seminare apo punëtori të ndryshme, takimet me përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizime të aktiviteteve për festa të ndryshme shtetërore, etj., janë përmendur si aktivitete shitesë për komunikim dhe informim publik të mbajtura gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim (ndonëse nuk është e qartë se për çfarë aktivitete konkrete bëhet fjalë).

## 12. Komuna e Pejës

Sa i përket kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal, është e qartë përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Më tej, kjo Komunë ka miratuar Rregulloren Komunale për Transparencë, e cila përcakton obligon Komunën që të jetë transparente në punën e saj duke bërë publike vendimet e marra nga të gjitha strukturat e saj, si dhe nëpërmjet takimeve dhe mundësimin të qasjes në dokumente të saj publike. Ajo gjithashtu përcakton Drejtorinë e Administratës dhe një zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike si struktura përgjegjëse për përmbushjen e obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore për komunikim dhe informim publik. Megjithatë, nuk është e plotësisht e qartë se cilat janë mekanizmat dhe masat konkrete të parapara me këtë akt. E njëjta vlen sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive dhe përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë, pasi që vetëm u janë referuar ligjeve përkatëse kornizë, por nuk është plotësisht e qartë se cilat janë masat dhe mekanizmat zbatuese në fuqi. Sipas organogramit të kësaj Komune, Zyra për

Informim Publik (ZIP) funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës, por nuk kanë dhënë shpjegime më të hollësishme. Më tej, sipas të dhënave të ofruara posedojnë Terma të Referencës (TR) së kësaj zyre dhe Përshkrime të Vendeve të Punës (PVP) së stafit të saj, por nuk është e qartë përmbajtja e tyre.

Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, ZMPI përbëhet nga tre zyrtarë, të gjithë me kualifikime formale të larta dhe relativisht relevante, përvojë pune prej 5 deri në 6 vjet dhe trajnime të ndjekura me kohëzgjatje prej një muaji (ndonëse nuk kanë është plotësisht e qartë relevanca e dy komponentëve të fundit). Megjithatë, nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara kësaj zyre, dhe e njëjta vlen sa u përket resurseve të alokuara për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave konkrete lokale dhe atyre të alokuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Së fundmi në lidhje me kornizën dhe kapacitetet institucionale, është e qartë se ka vlerësim gjashtëmuor dhe vjetor, por jo plotësisht e qartë se si kryhet vlerësimi i punës së zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik, e as çfarë standardesh bazohet kjo. Në nivelin e **kornizës së politikave** dhe planeve zbatuese, ZIP e Komunës së Pejës funksionon në bazë të një Plani vjetor Veprimi për komunikim dhe informim publik, por nuk është e qartë çfarë objektivash e aktiviteteve ka paraparë një dokument i tillë për periudhën që mbulon ky vlerësim. E njëjta vlen në lidhje me reflektimin e kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin që mbulon ky vlerësim dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të këtyre politikave

Kur jemi te **çështjet e zbatimit**, kjo Komunë ka deklaruar se ka pasur komunikim të rregullt me rreth 10 media lokale dhe nacionale, kryesisht me qëllim të informimit të qytetarëve mbi punën e Komunës. Në anën tjetër, rreth 5 6 OShC (lokale dhe qendrore) janë përfshirë në punën e saj, me fokus kryesisht në fushën e kulturës dhe atë të turizmit, por nuk është i qartë lloji dhe kohëzgjatja e përfshirjes së tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave, si dhe zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e zbatimit të tyre, asnjë akter i tillë nuk është përfshirë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara një numër i konsiderueshëm dokumentesh, po nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik (përveç atyre të sipërpërmendur) gjatë kësaj periudhe.

### 13. Komuna e Podujevës

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, është e qartë, ndonëse jo plotësisht, përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Më tej, kjo Komunë ka miratuar Rregulloren Komonale për Transparencë, e cila përcakton obligimet, strukturat dhe resurset specifike brenda strukturave komunale të parapara me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. Megjithatë, nuk është e qartë se cilat janë mekanizmat dhe masat zbatuese të parapara me këtë akt. E njëjta vlen sa i përket klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive. Sa i

përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë, është në fuqi Rregullorja Komunale për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare, por nuk është plotësisht e qartë se cilat janë masat dhe mekanizmat zbatuese në fuqi. Sipas **organogramit** të kësaj Komune, Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim (ZMPI) funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës. Më tej, ndonëse kanë deklaruar se kanë vënë në fuqi Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) së kësaj zyre, nuk është e qartë përmbajtja e tyre.

Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, ZMPI përbëhet nga tre zyrtarë, të gjithë me kualifikime formale të larta, përvojë pune prej 10 deri në 20 vjet dhe trajnime të ndjekura me kohëzgjatje prej një deri në tre muaj (ndonëse nuk kanë është plotësisht e qartë relevanca për të tre komponentët). Megjithatë, nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara kësaj zyre, dhe e njëjta vlen sa u përket resurseve të alokuara për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave konkrete lokale dhe atyre të alokuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Së fundmi në lidhje me kornizën dhe kapacitetet institucionale, nuk është plotësisht e qartë se si kryhet vlerësimi i punës së zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik, e as çfarë standardesh bazohet kjo. Në nivelin e kornizës së politikave dhe planeve zbatuese, Komuna e Podujevës, përveç obligimeve që dalin nga legjislacioni, të dhënat tregojnë se kjo Komunë nuk posedon dokumente politikash për komunikim e informim publik, e rrjedhimisht as objektiva e aktivitete të qarta të planifikuara për zbatimin e legjislacionit për komunikim dhe informim publik. E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin që mbulon ky vlerësim.

Kur jemi te **çështjet e zbatimit**, kjo Komunë ka deklaruar se ka pasur komunikim të rregullt me të paktën 5 media lokale dhe nacionale, kryesisht me qëllim të informimit të qytetarëve mbi punën e Komunës. Në anën tjetër, 6 OShC (lokale dhe qendrore) janë përfshirë në punën e saj, me fokus kryesisht në të drejtat e njeriut e barazinë gjinore dhe mbrojtjen e mjedisit, por nuk është i qartë lloji dhe kohëzgjatja e përfshirjes së tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim janë përfshirë 4 OShC, lokale dhe qendrore (në hartimin e Planit Lokal të Verimit për Mjedis), kurse vetëm një akter i tillë është përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave (por nuk është e qartë se për çfarë politikash bëhet fjalë). Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet zyrtare të saj, por nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse sa u përket aktiviteteve shtesë për komunikim dhe informim publik kanë përmendur vetëdijësimin e publikut, përmes radiove lokale, lidhur me qasjen në dokumente publike.

## 14. Komuna e Prizrenit

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në Komunën e Prizrenit, ky vlerësim ka treguar se Statuti i saj reflekton, ndonëse jo në nivel plotësisht të kënaqshëm, dispozitat kushtetuese e ligjore për komunikim dhe informim publik. Kjo pasi që janë të qarta vetëm ato dispozita të Statutit që rregullojnë mekanizmat e realizimit të kërkesave për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen e

Komunës, konsultimet publike, dhe tubimet publike me qytetarë. Më tej, kjo Komunë ka Rregulloren Komunale për Transparencë, por nuk është plotësisht e qartë se çfarë obligimesh, strukturash dhe resursesh specifike brenda strukturave komunale parasheh ajo me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. E njëjta vlen sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese të parapara me këtë akt, pra kjo Komunë nuk ka dhënë asnjë sqarim mbi to, përfshirë mënyrën e rregullimit të klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të saj nga ato dokumente publike në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën e qasjes. Në anën tjetër, nuk është plotësisht e qartë se cilët janë mekanizmat e masat zbatuese që parasheh ky akt për të rregulluar çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë, pasi që sipas të dhënave të ofruara është i qartë vetëm aspekti i dokumenteve të shkruara, e jo i në lidhje me formatet e tjera të dokumenteve dhe materialeve të Komunës në të cilat kanë të drejtë qasje të gjithë qytetarët që flasin katër gjuhët e specifikuar në rregullore (shqipen, serbishten, boshnjakishten dhe turqishten).

Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Prizrenit, nuk është e qartë nëse Zyra e saj për Marrëdhënie me Publikun (ZMP) ka **strukturën organizative/organogramin** e saj, pasi që mungojnë shpjegime plotësisht të qarta rreth strukturës së kësaj zyre, përfshirë në kuadër të strukturës së gjithëmbarshme hierarkike të Komunës, dhe funksionimin e saj në këtë kontekst. Sa u përket Termave të Referencës (TR) së kësaj zyre, ndonëse është pohuar se ato ekzistojnë dhe janë të publikuara në ueb-faqen e Komunës, teksti i publikuar është i paqartë, pasi që pamundëson dallimin në mes të shpjegimeve kronologjike që kanë qar në themelimin e kësaj zyre dhe strukturës së supozuar të saj, në njërin anë, dhe pjesës substanciale të TR që pohohet se përmban, në anën tjetër. Së fundmi sa i përket kësaj, pjesa përfundimtare e kësaj rubrike të ueb-faqes së Komunës është faktikisht një përshkrim i shkurtër i detyrave të Shefit të kësaj zyre, ndërkohë që në kuadër të hulumtimit në terren kjo Komunë ka deklaruar se kanë një plan (siç duket, për shtimin e numrit të zyrtarëve në kuadër të kësaj zyre), por se një gjë e tillë nuk është e mundur për shkak të kufizimeve ligjore në rritjen e numrit të të punësuarve në Komunë.

Në nivelin e kornizës së politikave dhe planeve zbatuese, Komuna e Prizrenit nuk ka hartuar ndonjë dokument politikash, plan zbatues ose plan vjetor të punës që prek fushën e komunikimit dhe informimit publik, prandaj nuk ka ndonjë objektiv e as aktivitete në këtë aspekt. Gjithashtu të dhënat e ofruara tregojnë se mungojnë mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të politikave për komunikim dhe informim publik. E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin që mbulon ky vlerësim. Kur jemi te korniza dhe kapacitetet institucionale për komunikim dhe informim publik, përveç vështirësive të përmendura më sipër që kanë të bëjnë me kornizën që rregullon funksionimin e saj, sipas të dhënave të ofruara nga kjo Komunë, në kuadër të ZMP-së (të përbërë vetëm nga Shefi i saj) ekzistojnë dhe vihen në zbatim standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës, raportime këto që, siç duket kryhen “sa herë që kërkojnë qytetarët dhe kryetari i komunës e që mund të ndodh në çdo javë”. Sa u përket resurseve njerëzore, të dhënat tregojnë kualifikime formale jo aq relevante, përvojë pune mbi 5 vjet dh ka ndjekur



trajtime relevante me kohëzgjatje gjithsej rreth 5 muaj (ndonëse dihet se sa kanë qenë relevante), por nuk është aspak e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara për të mundësuar funksionimin e kësaj zyre. E njëjta vlen në lidhje me resurset e alokuara për zbatimin e aktiviteteve për komunikim dhe informim publik me rastin e miratimit të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim.

Sa u përket **çështjeve të zbatimit**, kjo Komunë ka pasur komunikim ditor me 6 media lokale, por nuk është e qartë se për çfarë lloj aktiviteteve bëhet fjalë. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së OShC-ve lokale në punën e kësaj Komune, pasi që vetëm dihet se janë përfshirë 6 pre tyre, por nuk dihet kohëzgjatja dhe roli i përfshirjes së secilës prej tyre. Kur jemi te përfshirja e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave, sipas të dhënave të ofruara, kjo Komunë gjatë vitit 2012 ka miratuar gjithsej 81 vendime, 5 rregullore komunale dhe 1 strategji për politikat rinore, por nuk asnjë akter jashtë-qeveritar nuk është përfshirë në hartimin e tyre. E njëjta vlen në lidhje me zbatimin e legjislacionit dhe dokumenteve lokale të politikave dhe me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet (në shqip, serbisht, boshnjakisht dhe turqisht), por nuk janë dhënë hollësi të mëtjshme, e në anën tjetër konferenca shtypi e debate publike mbi të drejtën e qytetareve për qasje në dokumente komunale vetëm janë përmendur si aktivitete shpesh për komunikim dhe informim publik.

## 15. Komuna e Shtimes

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, është e qartë, përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Kjo Komunë gjithashtu ka miratuar Rregulloren Komunale për Transparencë, e cila rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij, mbledhjet e publikut, obligimin për njoftim publik, konsultimi i akteve komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, dhe qasjen e publikut në dokumentet zyrtare të Komunës. Ajo synon forcimin e transparencës të organeve të administratës komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, vendosjen e rregullave që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të kësaj të drejte dhe nxitjen e praktikave të mira administrative për qasje në dokumente zyrtare. Sa u përket mekanizmave zbatues, ajo vendos pesë lloje syresh: njoftimin e publikut, tubimet publike, konsultimin publik të akteve komunale, qasjen në dokumente zyrtare dhe një plan veprimi të Kryetarit të Komunës dhe të Kuvendit Komunal. Megjithatë, nuk është plotësisht e qartë strukturash e resursesh specifike brenda strukturave komunale përcakton me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. Në anën tjetër, kjo Komunë akoma nuk e ka rregulluar me akt nënligjor çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike sensitive dhe atë të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, e rrjedhimisht nuk ka një tërësi masash e mekanizmash zbatuese. Në kuadër të **organogramit** të kësaj Komune është paraparë funksionimi i Zyrës për Informim (ZI), në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës. Kjo zyrë përbëhet nga një zyrtar, i cili ka Përshkrimin e

Vendit të Punës (PVP). Përveç kësaj të fundit, gjithashtu është e qartë përmbajtja e Termave të Referencës (TR) së ZI-së.

Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, kjo Komunë nuk ka ofruar asnjë të dhënë në lidhje me kualifikimet, përvojën e punës dhe trajnimet e ndjekura nga zyrtari përgjegjës për informim. Në anën tjetër, nuk dihet shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara kësaj zyre gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim e as ajo për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave konkrete lokale, por dihet shuma e buxhetit të alokuar për vitin në vijim (€22,00). Së fundmi në lidhje me kornizën dhe kapacitetet institucionale, nuk është plotësisht e qartë se si kryhet vlerësimi i punës së zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik, e as çfarë standardesh bazohet kjo. Në nivelin e kornizës së politikave dhe planeve zbatuese, ZI e Komunës së Shtimes funksionon në bazë të Planit vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës, por nuk është plotësisht e qartë çfarë objektivash dhe aktiviteteve konkrete për komunikim dhe informim publik ka paraparë ai gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim (përveç përmendjes në përgjithësi të shpërndarjes së afisheve dhe debateve në një radiostacion lokal). E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin që mbulon ky vlerësim.

Kur jemi te **çështjet e zbatimit**, kjo Komunë ka deklaruar se ka pasur komunikim ditor dhe javor me 12 media lokale dhe nacionale, kryesisht me qëllim të informimit të qytetarëve mbi punën e Komunës. Në anën tjetër, 6 OShC (lokale dhe qendrore) janë përfshirë në punën e saj, kryesisht në formë partneriteti, por megjithatë nuk është plotësisht e qartë fokusi dhe kohëzgjatja e përfshirjes së tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave, gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim janë përfshirë 3 OShC (në hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Siguri në Bashkësi dhe të Strategjisë Komunale për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas), asnjë e tillë në zbatimin e tyre, dhe 2 të tjera në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave (por nuk është e qartë se për çfarë politikash bëhet fjalë). Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet zyrtare të saj (përfshirë informata mbi strukturat institucionale dhe personelin e Komunës, vendime, rregullore, buxhetin komunal, dokumente politikash e plane rregullative, raporte financiare e të tjera, etj.). Në anën tjetër, sa u përket aktiviteteve shtesë për komunikim dhe informim publik kanë përmendur debate në përgjithësi dhe publikimin e një raporti për qasje në dokumente zyrtare.

## 16. Komuna e Skënderajt

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, është e qartë, përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Kjo Komunë gjithashtu ka miratuar Rregulloren Komunale për Transparencë, e cila përcakton të drejtën e qytetarëve, OShC-ve, grupeve të interesit dhe palëve të tjera të interesuara në informata dhe dokumente publike të Komunës, pastaj qasjen e tyre në mbledhje të Kuvendit Komunal dhe të komiteteve të tij dhe në dokumentet përkatëse, detyrimin e organeve komunale

për të informuar qytetarët dhe subjektet e tjera mbi punën e tyre, për njoftim publik, për konsultimin e akteve komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, etj. Ajo synon forcimin e transparencës të organeve të administratës komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, vendosjen e rregullave që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të kësaj të drejte dhe nxitjen e praktikave të mira administrative për qasje në dokumente zyrtare. Kjo rregullore parashih realizimin e këtyre detyrave e obligimeve kryesisht përmes komunikatave për media, konferencave për shtyp, ueb-faqes zyrtare të Komunës, mjeteve lokale të informimit, tabelës së shpalljeve në Komunë, shpalljeve në vendet më të frekuentuara në territorin e Komunës, buletineve të rregullta dhe periodike, mbledhjeve publike, fletëpalosjeve, katalogut komunal, dhe komunikimit të përditshëm. Megjithatë, përtej dispozitave formale të kësaj rregulloreje, nuk është plotësisht e qartë strukturash e resursesh specifike brenda strukturave komunale përcaktan me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore.

Në anën tjetër, rregullorja e sipërpërmendur komunale rregullon çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive, kurse Rregullorja Komunale për Përdorimin e Gjuhëve atë të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, por megjithatë përtej dispozitave ligjore formale, nuk është plotësisht e qartë çfarë mekanizma dhe masa zbatuese janë në përdorim. Në kuadër të organogramit të Komunës së Skënderajt është paraparë funksionimi i Zyrës për Komunikim dhe Informim Publik (ZKIP), në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës. Kjo zyrë përbëhet nga dy zyrtarë, por gjithashtu kjo Komunë ka një zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike. ZKIP ka Termat e Referencës dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) së zyrtarëve të saj, por megjithatë nuk është plotësisht e qartë se si zbatohen ato. Kur jemi te korniza dhe kapacitetet institucionale për komunikim dhe informim publik, të dhënat për resurset njerëzore tregojnë kualifikime formale të larta relativisht relevante, përvoje pune prej 3 dhe 12 vitesh (jo plotësisht relevante) dhe asnjë trajnim të ndjekur (ndonëse nuk është plotësisht e qartë relevanca e përvojës së punës dhe trajnimeve të ndjekura). Megjithatë, nuk është e qartë shuma e kategorive të tjera të resurseve të alokuara kësaj zyre, dhe e njëjta vlen sa u përket resurseve të alokuara për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave konkrete lokale dhe atyre të alokuara për periudhën njëvjeçare në vijim. Së fundmi në lidhje me kornizën dhe kapacitetet institucionale, është e qartë se ka vlerësim periodik, por jo plotësisht e qartë se si kryhet vlerësimi i punës së zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik, e as çfarë standardesh bazohet kjo.

Sipas të dhënave të ofruara nga kjo Komunë, **korniza e politikave dhe planeve zbatuese** që prek fushën e komunikimit dhe informimit publik përfshin Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2013 - 2015 dhe Strategjinë për Shërbim me Qytetarë, por megjithatë nuk është plotësisht e qartë çfarë objektivash dhe aktiviteteve konkrete për komunikim dhe informim publik janë paraparë në kuadër të tyre gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim (përveç të dhënave në lidhje me qasjen në dokumente publike të Komunës). E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin që mbulon ky vlerësim.

Kur jemi te **çështjet e zbatimit**, kjo Komunë ka deklaruar se ka pasur komunikim ditor me 10 media lokale dhe qendrore, kryesisht me qëllim të informimit të qytetarëve mbi punën e Komunës. Në anën tjetër, të paktën 5 OShC lokale janë përfshirë në punën e saj, kryesisht në formë të bashkëpunimit dhe konsultimeve, por megjithatë nuk është plotësisht e qartë fokusi dhe kohëzgjatja e përfshirjes së tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave, si dhe zbatimin dhe monitorimin e vlerësimit e zbatimit të tyre, asnjë akter i tillë nuk është përfshirë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet zyrtare të saj (përfshirë informata mbi strukturat institucionale dhe personelin e Komunës, vendime, rregullore, plane e raporte të ndryshme, etj.). Në anën tjetër, sa u përket aktiviteteve shpesh për komunikim dhe informim publik kanë përmendur informimin e qytetarëve mbi qasjen në dokumente zyrtare.

## 17. Komuna e Vushtrrisë

Sa i përket **kornizës ligjore dhe rregullative** në nivelin komunal, është e qartë, përmbajtja e dispozitave të Statutit të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Kjo Komunë gjithashtu ka miratuar Rregulloren Komunale për Transparencë, e cila parasheh mbajtjen e takimeve publike dhe informimin me kohë të qytetarëve për këto takime, Konsultimin e qytetarëve para miratimit të vendimeve, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera, publikimin e akteve komunale, si dhe të drejtën dhe mënyrën e qasjes në dokumente publike. Kjo rregullore gjithashtu ka paraparë themelimin e Zyrës për Komunikim me Publikun (ZKP), në kuadër të së cilës janë të punësuar tre zyrtarë (njëri nga të cilët merret ekskluzivisht me administrimin e kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare), si dhe gjithashtu ka raporte tremujore MAPL-s mbi qasjen në dokumente publike të Komunës. Megjithatë, përtej dispozitave formale të kësaj rregulloreje, nuk është plotësisht e qartë strukturash e resursesh specifike brenda strukturave komunale përcakton me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese e ligjore. Në anën tjetër, sipas të dhënave të ofruara, çështja e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive është e rregulluar përmes një vendimi të Kryetarit të Komunës, por nuk është e qartë përmbajtja e saj e as mekanizmat e masat zbatuese.

Më tej, çështja e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim është e rregulluar nga Statuti dhe Rregullorja Komunale për Përdorimin e Gjuhëve, por megjithatë përtej dispozitave ligjore formale, nuk është plotësisht e qartë çfarë mekanizma dhe masa zbatuese janë në përdorim. Në kuadër të **organogramit** të kësaj Komune është paraparë funksionimi i Zyrës për Komunikim me Publikun (ZKP), në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës (e përbërë nga tre zyrtarë), dhe e cila i raporton drejtpërsëdrejti këtij të fundit. ZKP ka Termat e Referencës dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) së zyrtarëve të saj (të përcaktuara në kuadër të Rregullores Komunale mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematzimitin e Vendeve të Punës), por megjithatë nuk është e qartë përmbajtja e tyre dhe se si zbatohen ato. Kur jemi te **korniza dhe kapacitetet institucionale** për komunikim dhe informim publik, të dhënat për resurset njerëzore tregojnë kualifikime formale të mesme, përvoja pune prej 14 deri në 27 vjet dhe

pjesëmarrje në trajnime prej 1 deri në 9 javë (por nuk është e plotësisht e qartë se sa relevante për të tre komponentët). Në anën tjetër, shumica e buxhetit nuk për vitin që mbulon ky vlerësim nuk ka qenë e qartë, kurse për periudhën njëvjeçare në vijim ka qenë gjithsej €15,000 (e cila shërben edhe për zbatimin e politikave për komunikim dhe informim publik), kurse kjo zyrë është gjithashtu e pajisur me pajisje teknike si kompjuterë e teknologji për video-incizime. Së fundmi në lidhje me kornizën dhe kapacitetet institucionale, është e qartë se ka vlerësim periodik, bazuar në legjislacionin kornizë për Shërbimin Civil të Kosovës, por jo plotësisht e qartë se si kryhet vlerësimi i punës së zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik, e as çfarë standardesh bazohet kjo.

Në nivelin e **kornizës së politikave dhe planeve zbatuese** për komunikim dhe informim publik, Komuna e Vushtrrisë ka miratuar një Strategji Komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve, hartimi i së cilës është paraprirë nga një hulumtim i opinionit lidhur me informimin dhe komunikimin në komunë. Përveç përmirësimit në fushën e komunikimit, ky dokument i politikave parashihet edhe ndërtimin e partneritetit me qytetarët si shkalla më e lartë e pjesëmarrjes së qytetarëve. Ajo ka tri objektiva: avancimin e ofrimit të informatave publike qytetarëve, krijimin e mundësive të reja për komunikim me qytetarët, dhe krijimin e mjedisit për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në jetën publike. Në anën tjetër, nuk është plotësisht e qartë çfarë aktiviteteve konkrete ka paraparë ky dokument gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim (përveç përmendjes në përgjithësi të qasjes në dokumente zyrtare dhe publikimit të tyre në ueb-faqe). E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin që mbulon ky vlerësim dhe mekanizmeve e masave për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre.

Kur jemi të **çështjet e zbatimit**, kjo Komunë ka deklaruar se gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim ka pasur komunikim ditor, javor dhe mujor me mbi 10 media lokale dhe qendrore, kryesisht me qëllim të informimit të qytetarëve mbi punën e Komunës dhe fushata për vetëdijesimin e qytetarëve. Në anën tjetër, 3 OShC lokale dhe qendrore janë përfshirë në punën e saj gjatë kësaj periudhe, kryesisht në formë të bashkëpunimit dhe partneritetit në hulumtimin e opinionit, secila OShC me kohëzgjatje prej rreth 3 muajsh gjatë vitit 2012, por megjithatë nuk është plotësisht e qartë fokusi i përfshirjes së njërës prej tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave, kurse 1 prej tyre në monitorimin e vlerësimit dhe zbatimit të tyre, asnjë akter i tillë nuk është përfshirë gjatë periudhës që mbulon ky vlerësim. Së fundmi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet zyrtare të saj (përfshirë informata mbi strukturat institucionale dhe personelin e Komunës, vendime, rregullore, plane e raporte të ndryshme, etj.). Në anën tjetër, sa u përket aktiviteteve shpesh për komunikim dhe informim publik kanë përmendur një fushatë vetëdijesimi të publikut, të zbatuar në bashkëpunim me një radiostacion lokal.

## Përfundime dhe rekomandime:

Siç tregojnë gjetjet e këtij vlerësimi, nga viti i kaluar Komunat kanë shënuar përparime të dukshme në të gjitha aspektet e politikave të komunikimit dhe informimit publik. Shumica e tyre kanë miratuar akte nënligjore për komunikim dhe informim publik, e disa prej tyre edhe dokumente politikash që përcaktojnë synime e aktivitete të qarta në këtë fushë. Megjithatë, siç tregon ky raport më hollësisht, ka akoma mospërputhje, si brenda vetë Komunave të veçanta, ashtu edhe në mes të Komunave të ndryshme, në përkufizimin e koncepteve, përkufizimin e tyre dhe të fushëveprimit të kornizës ligjore, si dhe në lidhje me obligimet, strukturat institucionale dhe mekanizmat e masat zbatuese që ato përcaktojnë me qëllim të zbatimit dhe respektimit të detyrimeve kushtetuese e ligjore për komunikim dhe informim publik. Kjo përfshin edhe mungesën e përcaktimit të saktë të kompetencave dhe përgjegjësive të zyrave përgjegjëse për komunikim dhe informim publik.

Në anën tjetër, ngjashëm me të gjeturat në nivelin qendror, edhe në nivelin komunal vihet re mungesa, më e theksuar se në nivelin qendror, e qartësisë rreth asaj se çfarë masash e mekanizmash konkrete të zbatimit janë përcaktuar përmes legjislacionit kornizë (të nivelit nacional) dhe atij zbatues (të nivelit komunal). Edhe në këtë rast, paqartësitë janë në masë të madhe pasojë e të kuptuarit të ndryshëm të natyrës dhe fushëveprimit të legjislacionit dhe të politikave për komunikim dhe informim publik, si dhe interpretimit të ndryshëm të tyre nga ana e strukturave komunale përgjegjëse për komunikim dhe informim publik. Më tej, në lidhje me fushëveprimin të politikave për komunikim dhe informim publik në kuadër të secilës Komune, shumicës dërrmuese të strukturave të tyre përgjegjëse për komunikim dhe informim publik u mungon një qasje horizontale dhe e ndërthurur, e bazuar në sektorë. Rrjedhimisht, fusha e komunikimit dhe informimit publik në kuadër të tyre vazhdon të konceptohet thjesht si një fushë politikash e kufizuar në mundësimin e qasjes së qytetarëve në dokumente publike. Më konkretisht, këto politika, të cilat janë në shumicën e Komunave, në fillim të zhvillimit të tyre, nuk kanë si pjesë të tyre përfshirjen e akterëve të ndryshëm në zhvillimin, zbatimin, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit dhe të politikave lokale në të gjithë sektorët dhe fushat.

Bazuar në këto dhe mangësi të tjera të identifikuara në kuadër të këtij vlerësimi të zbatimit të politikave të komunikimit dhe informimit publik, ky raport jep disa rekomandime për Komunat dhe akterët e tjerë relevantë.

Së pari, rekomandohet që Komunat (të ndihmuara edhe nga institucionet qendrore, në veçanti MAPL), të ndërmarrin përpjekje të përbashkëta në përkufizimin e saktë dhe uniform të natyrës dhe fushëveprimit të politikave për komunikim dhe informim publik në nivelin lokal. Ky përkufizim duhet të marrë parasysh jo thjesht qasjen e qytetarëve në dokumente publike, por edhe aspekte të nevojshme për përfshirjen efektive të akterëve jashtë-qeveritarë në tërë ciklin e politikave publike, monitorimin e performancës së Komunave, informimin mbi resurseve që u alokohen e shpenzohen, e kështu me radhë).

Së dyti, bazuar në këtë përkufizim uniform, secila Komunë duhet të qartësojë, në nivel operativ, grupet kryesore të synuara të qytetarëve të cilëve është i obliguar t'u ofrojë shërbime dhe të mira të tjera në secilin sektor.

Së treti, bazuar në një vlerësim të përafërt të nevojave të grupeve të synuara dhe nivelit të zhvillimit të politikave në të gjithë sektorët dhe fushat që bien në kuadër të fushëveprimit të institucionit përkatës, secila strukturë në kuadër të Komunave që është përgjegjëse për komunikim dhe informim publik duhet të zhvillojë misionin, vizionin dhe objektivat e saj.

Së katërti, bazuar në nevojat dhe interesat e grupeve të synuara, si dhe në misionin, vizionin dhe objektivat kyçe të komunikimit dhe informimit publik, si dhe në legjislacionin kornizë dhe atë zbatues, secila Komunë duhet të përshtatë Termat e Referencës dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës së strukturave dhe zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik, në mënyrë që të jenë në harmoni dhe të ndihmojnë në realizimin e vizionit, misionit dhe objektivave kyçe të identifikuar nga secili institucion për komunikim dhe informim publik. Në këtë kontekst, gjithashtu nevojitet harmonizimi (dhe plotësimi, në ato Komuna ku ka nevojë), i dispozitave ligjore për komunikim dhe informim publik, për të siguruar reflektimin në mënyrë më precize dhe uniforme të obligimeve që dalin nga ligjet dhe aktet nënligjore në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të strukturave komunale përgjegjëse për komunikim dhe informim me publikun.

Së pesti, duhet të kryhet një analizë e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse e legjislacionit komunal në fuqi për komunikim dhe informim publik dhe e zbatimit të tij. Një analizë e tillë duhet të fokusohet edhe në zbatimin e deritanishëm të këtij legjislacioni dhe zbatueshmërinë e tij, por gjithashtu në identifikimin e mospërputhjeve të mundshme, përmirësimin e cilësisë së legjislacionit zbatues dhe të politikave lokale për komunikim dhe informim publik, si dhe përmes këtij procesi të përmirësohet të kuptuarit dhe kapacitetet e zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik.

Së gjashti, ka nevojë të kryhet një analizë e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse e politikave lokale në fuqi për komunikim dhe informim publik dhe e zbatimit të tyre. Një analizë e tillë duhet të përfshijë të gjitha dokumentet ekzistuese të politikave të miratuara nga të gjitha Komunat. Edhe kjo do të ndihmonte në identifikimin e vështirësive në zbatimin e këtyre politikave dhe të mospërputhjeve e duplikimeve të mundshme, përmirësimin e cilësisë së politikave e mekanizmave e masave zbatuese për komunikim dhe informim publik dhe përmirësimin e të kuptuarit dhe ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës që merren me këtë fushë politikash.

Së shtati, edhe për Komunat do të ishte me ndihmesë të rëndësishme zhvillimi i një baze të dhënash të legjislacionit dhe politikave lokale relevante për komunikim dhe informim publik, me qëllim të pasqyrit të logjikshëm dhe ndërlihdhjes funksionale në mes të legjislacionit dhe politikave të të gjitha niveleve dhe fushave të ndryshme sektoriale në kuadër të fushëveprimit të Komunave. Edhe në këtë rast, një instrument i tillë do të ndihmonte në qartësimin e fushëveprimit të legjislacionit e politikave lokale për komunikim dhe informim publik, identifikimin e masave dhe mekanizmave zbatues, si dhe

përmirësimin e të kuptuarit dhe ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës që merren me këtë fushë politikash.

Së teti, rekomandohet që Komunat të vazhdojnë me ngritjen e kapaciteteve humane të zyrtarëve të tyre përgjegjës për komunikim dhe informim publik, për të përmirësuar njohjen e dispozitave ligjore e politikave që kërkohet të zbatohen, si dhe kapacitetet për zbatimin e tyre. Kjo gjithashtu kërkon që ata të jenë të përfshirë dhe të përmirësojnë dukshëm njohuritë mbi çështjet sektoriale në kuadër të fushëveprimit të Komunës. Kjo është e domosdoshme në mënyrë që të sigurohet që rregullativa komunale dhe dokumentet e politikave për fusha specifike sektoriale të reflektojnë përmasat e komunikimit dhe informimit publik. Kjo pastaj do t'u mundësonte strukturave përgjegjëse për komunikim dhe informim publik që të monitorojnë dhe të vlerësojnë më mirë zbatimin e politikave për komunikim dhe informim publik, dhe që kështu të jenë në gjendje të vlerësojnë përparimin e përgjithshëm të Komunave në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut.

Së nënti, nevojiten përmirësime të dukshme në cilësinë e politikave dhe planeve lokale për komunikim dhe informim publik, në të gjitha përmasat e tyre, duke filluar nga përcaktimi i objektivave e aktiviteteve të qarta, përfshirë buxhetimin dhe ndarjen e përgjegjësisë, e deri të monitorimi e vlerësimi sistematik i zbatimit të tyre.

Së fundmi, por jo me më pak rëndësi, në përgjithësi duhet që Komunat të fillojnë të luajnë rol dukshëm më proaktive në komunikim, bashkëpunim dhe përfshirjen e aktorëve jashtë-qeveritarë të nivelit lokal (në veçanti mediave dhe organizatave të shoqërisë civile), në zhvillimin e politikave lokale, përkrahjen e zbatimit të tyre dhe në veçanti monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të tyre.